


Një ndër sprovat e para lidhur me historinë e letërsisë është një libër i vogël në format xhepi ku përmenden shkrimtarët dhe dukuritë letrare shqiptare, që nga fillimi me “Mesharin”, deri në ato bashkëkohorët me vetë autorin. Mbetet interesante të lexohet se si shihet para 101 vjetësh letërsia, kur sikurse autori thotë, akoma nuk ishte koha për të shkruar një tekst për letërsinë shqipe në kuptimin e plotë të fjalës, pasi shkrimtarët e gjallë atëbotë “ishte akoma heret me folë”.

Histori e letërsisë shqipe e botuar në vitin 1922 nga Pashuk Ndokillia

Përgatiti Andreas Dushi



DEBATI PËR PËRKTHIMIN E POEZISË: PËRKTHYESI - SI POET I FSHEHUR?

Nga Agron Tufa

(fq. 4)

SHËNIME MBI LIBRAT

Pasthënia e vëllimit të ri poetik
të Entela Tabakut, “Qeramikiana”

NJË RISI E BUKUR POETIKE NË HARTËN E LETËRSISË SHQIPE

Nga Ndue Ukaj

(fq. 19)

Vëllimi “e njëjta hënë” e Dan Ibrahim

POETIKA E NJË REBELIMI TË PËRKORË

Nga Mirela Robo

(fq. 14)

Poema “Sytë e heshtjes” të Anton Nikë Berishës

ZBULESA POETIKE E HESHTJES

Nga Prend Buzhala

(fq. 8)

Botimi në spanjisht i “Vajzat e mjegullës”

NJË MBRËMJE ME SHKRIMTARIN NAMIK DOKLE

Nga Pedro Delgado Fernandez

(fq. 10)

Vëllimet “Mërzi me Këpucë Letre” dhe
“Skulpturë Ujore” të poetit Ruzhdi Gole

POETI NA FTON TË UDHËTOJMË PA QENË UDHËRRËFYES I POEZIVE

Nga Fatbardh Amursi

(fq. 11)

Rreth veprës “Erërat që trazojnë mjegullën” të Ervin Nezhës

ANKTHI HERMENEUTIK I NJË PROZE ALEGORIZUESE

Nga Alisa Velaj

(fq. 12)



“Digitalb”, “Dixhitalb” - SI PO TRONDITEN THEMELET E SHQIPES

Prof. dr. Rami Memushaj

(fq. 13)

E shohim dhjetëra herë në ditë këtë fjalë, të shkruar a të shqiptuar me **g** ose me **xh**. Trajta me **xh** ka marrë aq të përhapur, saqë e japin si normative edhe korrektorët e tekstit të celularëve e të tabletëve. Këto trajta të gabuara të kësaj fjale hasen jo vetëm te folësit e thjeshtë, po edhe në shtypin e shkruar e të folur, veçanërisht në ligjërimitin e gazetarëve televizivë e radiofonikë, të cilët pritet të jenë model i shqiptimit letrar...

PSE JEMI ENDE KAO TË MARROSUR PAS MUZIKËS SË MOZARTIT? ÇFARË KA MOZARTI?

Nga Doug Thomas

Përktheu Jola Tasellari



(fq. 16)

BIBLIOTEKË

Zija Çela

(fq. 20)

Dorëheqja

Ylljet Aliçka

(fq. 17)

*Përpjekjet e mundimshme të hyrjes
pa ftesë në pritjet mondane në Paris*

Roland Gjoza

(fq. 18)

Grataçiela të Nju Jorkut

J.M.G. Le Clézio

(fq. 22)

Kujtimi yt, Orija

(Përktheu Feride Papleka)

Marguerite Duras

(fq. 23)

*Lavirja në bregdetin
e Normandisë*

(Përktheu Qerim Raqi)

Arben Meksi

(fq. 24)

Karikatura e së shtunës

Pjesë e librit në botim “Njeriu si një tjetër”

TREMB DHE TRONDIT

Nga Natasha Lako

MBI KOMEDITË E ZHDUKURA TË SANTORIT

Nga Prof. Dr. Klara Kodra

Të gjithë komet e kërkojnë rânjën e tyre prej kohësh ma vjetike qi munden; e mbassi ndër kohna të para shkrimi ka qenë pak i njoitun, nuk dim për ato kohna, veç çka na ka ardhë gojë nepër gojë. Të parët e kishin zakon me i amshue ngjarjet, pikllimet e zembres me kângë populllore, me folë me shemelltyrna a përralla, me caktue një mësim të math me një diftim a fiale; m'u defrye për një herit, dhe me ushtrue menden për miet kashë e lashvet, prandaj sa mâ të bukura, sa mâ të thiellda, aq mâ i qytetnuem provohet qi ishte populli qi i përngojote; e kështu mbas dishminavet të litrarvet të botës, provohet se Shqiptarët në ket pikpamie, s'ja lanë dalë popuivet mâ të qytetnuem

Shum janë shkrimtarët e huej qi janë tokue ndër shkrime të veta në levizie të literatyrës s'onë, e nonsë-un do të bazohem mbi ta, për hir të shkurtimit s'do t'i përmendi veç për rrqitas.

Nonsë-e di qi literatyrën e përbainë krye veprat qi na s'i kena, prap se prap me duket punë e pamiradishme me kalue ne heshtje emnat e sa shkrimtarvet si të huej, si vendës, qi janë mundue me vue themelin e ndërtesës literare qi na iena tu'e mkâmbë. Mandej guximi, ndienjat, qëllimi e shkasi qi i dhan literatyrës Shqipe Bogdani, De Rrada, Ndokillia e Frashëri me detyrojnë t'i kushtoj pak fiale vepres se tyre veçanerisht.

Literatyra është përshkrimi i vepravet mâ të çmueshme të një gjuhe, e përshin leviziën mësimore të një komi, tue përparue kamba kambë me levizien politike të ti.

Me asi dokumentash qi provohet se na rriedhim prej Albanvet të Kaukazit, gjeimë edhe se ata përdorëshin një Alfabet të trilluem prej një Armeni me emën Misrop; ashtu Pelazgjët përdorëshin një Alfabet të pruem prej Finikut Kadmo e këto Alfabeta te cilt i përmende Diodori, kuiton se i ka gjetë Dr. Hahn i cili edhe s'ka frikë të na çfaqë në libër të ti. Edhe Malte Brunn e Krispi flasin për një Alfabet dy mi vieçar. Dihet se Kanuni i Lekdukagjinit është shkruar shqip, edhe qi Skanderbegu i është përgjegjë shqip Sulltan Muhametit; ashtu dihet se me 1493 ishle një shtypshkronj në Obot, edhe pak mâ vonë në Voskopoja; por të parat fjalë Shqipe, të hiedhuna kot ndër vepra të tyre i gjejmë në një fialuer të një germanit e në libër t'Em. Ejllit në kohë të Skaderbegut të shkrueme me gërma latinisht. Një dokument asht vetun në 1555 qi një farë Buzukut paska shkruar meshorin Shqip me do gërma të përzieme; kështu kena edhe një kangë shumë të bukur prej 1572, e quitun "Zani i Kasnecavet," e në 1577 Dimiter Frengu na përshkruen fialën e L. Dukagjinit "E me ta". Mandej në 1600 shkruene Em. Budi, Bardhi; në 1700 Pouquevilli, De Lecce, e me themelim të Kolegjës të Shën Damianit u punue rregullisht gjuha Shqipe; e mbassi mâ të shumë e shkrimtarvet klerikal përdorëshin alfabetat e kishvet tyre

LITERATYRA SHQIPE

Prej Pashuk Ndokillës

Përgatiti Andreas Dushi

Historia e mëposhtme e letërsisë shqipe u botua vetëm një herë në vitin 1922 nga autori Pashuk Ndokillia i cili përveçse arsimtar, ishte edhe themelues i skautizmit në Shqipëri, sikurse na e tregon libri i tij i dytë ku flet pikërisht për të. I lindur në Shkodër në vitin 1888, ai punoi si mësues, ndër të tjera edhe në Gjirokastër pranë Liceut të qytetit.

Është shumë interesant një tekst i tij i botuar më 1931 në Gazeta Shqipëtare me titull "Rëndësia e filozofisë morale", një ndër tekstet e para – në mos i pari – që e trajton gjerësisht nga pikëpamje të mendimtarëve të ndryshëm këtë degëzim të mendimit.

Teksti në vijim është një ndër sprovat e para lidhur me historinë e letërsisë, një libër i vogël në format xhepi ku përmenden shkrimtarët dhe dukuritë letrare shqiptare, që nga fillimi me "Mesharin", deri në ato bashkëkohorët, duke përfshirë vetë autorin. Mbetet interesante të lexohet se si shihet para 101 vjetësh letërsia, kur sikurse autori thotë, akoma nuk ishte koha për të shkruar një tekst për letërsinë shqipe në kuptimin e plotë të fjalës, pasi shkrimtarët e gjallë atëbotë "ishte akoma heret me folë".

Këtu shtrohet edhe një tjetër hipotezë. Autori ia kushton librin Zef Ndokillisë dhe në përshkrimin e tij ndalet jo pak, duke na thënë madje se një alfabet latin për shkrimin e shqipes e ka krijuar pikërisht ungji i tij. Në shkrimin "Kush e hartoi alfabetin e gjuhës shqipe" (ExLibris, 106, 21 nëntor 2020) ku ribotohet debati mes "Hyllit të Dritës" dhe "Kumbonës të së Diellës", emri i Ndokillës si hartues i mundshëm i tij nuk del asnjëherë.

etë rrallë trilloshin vetë një Alfabet si Kopitar në1829 e Vithkuqi. Për hir të shkurtimit tue hieke kësulën, vetun do të përmendi Emnat e Varibobes, Camardes, Mitkos, Kristoforidhit, Nesim Përmetit, Vaso Pashës, Serembes, Xarishit, De Martinos, Theodorit, Naum Veqilharxhit, Taksin Çami, Anastas Koluriotit, Boçarit, Santorit, Grigorit, për me nderue mendien e naltë të tyre tue urue qi një tjetër mâ i zoti; e mâ i ngaeshëm se un, ti rreshtoinë në një vepër të ti.

Me mposhtië të Shqipnis prej Turkut kishte fillue m'u përlye gjuha, dhe me hupe ndienjat. Ket gjâ s'mund e durote shpija fisnike e Bogdajvet, prandaj ungj e nip shkruene një fialuer, një gramatikë, dhe Veprën e çmueshme "E Vërteta" qi na mbetet edhe, se tierat i tretne Em. Pietrit, kur po ikte prej Shkupit për me ardhë e m'u-ndrye në shpellë qi edhe sot quhet me emën të tië në Riollë, prej ku iku mfshehtas në Rragushë e në Venedik ku botoj librin e ti. Ky liber u botue në vietë 1691; alfabeti i ti është latinisht me 5 gërma të ndryshme; gjuha është shumë e kulluet; shtilli i rriedhshëm.


Libri asht në format të math; përbahet prej dy vellimesh njani 182 faqesh veç kushtimit; tietri 162 faq. veç mësallës edhe shtocës. Em. Pietri ishte Doktor Filosofijet, dhë dinte tet gjuhë, prandaj ne libër të ti, gjinden tet alfabeta, dhe piesa "Cuneus Prophetarum" e përkëthyeme në tet gjuhë.

Nji qi shkruen gja e jetë; qi terhoq mâ fort vërejtjen e botës së qytetnueme, aq sa fitoi levdimet mâ të mëdhajat prej njerzvet të çquem të kohës, qe De Rrada. Ky shkrimtar i pa lodhshëm 73 viet i përdori vetun për Shqipni tue pase filluem në 1833. Mlodhi kangët populllore dhe i përkëthej; botoj dy të përkohshme "Il Giovine Albanese" dhe "Fla- muri i Arbârit" shkroj Skanderbegun, Milosaun, Topija etj, etj. Dy herë mlodhi Shqiptarët e Italis në Kongres, ku themeluene shoqin "La Nazione Albanese" prej të cilës mandej u botuene shumë libra me alfabet të De Radës; Detyroj Qeverin Italiane të themelonte katedrat e gjuhës Shqipe në Shën Mitër e në Napul; por gabimi i ti qe, se nuk u kudes me nxanë gjuhen, por u kënaqte vetun me dhialekt të vet.

De Rada shkroj mâ shumë se çdo Shqiptar; u njoit e u nderue çmos kushi, por ky nieri do madhnue mâ fort si Apostull, se sa si litrar.

Jo vetëm se më lidhë gjaku, por edhe për me nderue egoizmen e shugurueme te Shqiptarvet vendes, e veçanerisht Shkodranë të cilt si në gojë. ashtu në kangë e ndër fletore e kan amshue emnin e ti, aq sa i kan kushtue një udhë mu në mes të qytetit prej kopshtit Populluer në Konak, më detyron me bân fialë për Zefin e Ndokillis, i quitun dhe Jubani prej katundit, prej Lagjes së Kishës së cilit si quhet sot, a Mileta-Illija-Palokaj si u-quete atëherë, ka ra në Shkodër.

I ati i ti, trim dhe bujar e dërgoi Zefin ne Malltë qi të nxente shkollë, ku



mësoj jo vetëm dituni, por edhe ushqe mendien me ndienja komtare, se aty vlote kryengritia për vetqeverim Italian, dhe me Shqiptarë t’Italis, të Greqis, dhe t’Austris e vendës u orvat për levizie komtare, e cila levizie pieku Lidhjen e Prizrendit.

Zefi ne part i marrun vesht me udhheqësit e kohës nen mproitie të Francës ku shërbente si kancelar me bashkpunim të Bibdodes themeloj Shoqnin Shqiptare, krijoj një alfabet; mlodhi kangët popullore; shkroj Vierrsha; pëkëthej kanunin e tregtis të Turqis; por mâ fort u-muer me konferenca, dhe korrispondenca nder qytete e fletë të para të Francës, t’Italis e t’Austris. I pari katolik qi krijoj alfabet si thotë “Zani i Shna Ndout,” Viershâtori i math si thotë A. Loriku; i madhi atdhetar si e quen “Populli” e shkrimtar i madhë si e njeh “Agimi,”; qe sharë e kritikju, qe mproitë prej Pr. Marchiano; qe dashtë prej Camardës e Dorës d’Istria; qe adhurue prej popullit; qe ndiekë prej qeveris, e rroj i vetun por me idheal, pse në 1870 ishte zor me pase shokë Shqiptar, e vdiq tue na lanë trashigim alfabetin latinisht qi sot Shqiptarët mburren të ken.

Në Kongres të Berlinit ne viet 1878 Europa kishte përfundue coptimin e Shqipnis; dhe Shqiptarët qi kishin në dorë qeverin e Turqis s’mund e praroshin ket gjâ; prandej ja mbushne menden Turkut qi t’i lente të punoishin për Shqipni. E para e punës qe, themelimi i shoqnis së shkronjavet Shqipe dhe botune shum libra, për vepër sidomos të Naim Frashërit.

I lindun në qytetin Frashër; nxuni në Janinë dhe mori nëpunsina të mëdha në Turki. Nene i vogël vierrshonte; sa ju dha rasti, kethej vierrshimin prej Greqishtes në gjuhë Shqipe, dhe u-bâm i përmendun. Ky veç një zellit të math me begatë literatyren Shqipe me libra, aq sa shkroj po thuei se të gjith librat qi u-doishin për shkollë filiore; por shkroj edhe disa vierrsha të çmueshme si b. f. “Bagti e Buiqesi”, “Parraisa”, “Skanderbegu”, “Lulet e Verës”, e tj. e tj.

Gjuhën qi përdorë e ka të kulluet; shtillin e rriedshëm; mendimet janë të nalta prej kui do t’i ket marrë; e nonse s’ka përdorun masat e vierrshësis, të tana, prap se prap me vepra të tija, vjerrshesija Shqipe, hiedh një çap të math para. Naimi ishte i fort në prozë; ishte Shqiptar i flakët; as një nder shkrimtar Shqiptar nuk âsht i njoitun në popull sa ky. Dhe literatyra do të përpaponte shum; po masat e rrebta qi muer Qeverija kundra Shqiptarvet shkrimtar e pënguene fort.

Shqiptarët ku në vende të lira si n’Itali, Misir, Austri, Rumani, Bullgarie e Amerikë kishin formue shoqnina literare; ku edhe mefshetas në Shqypni si ajo e Bashkimit dhe e Agimit por aq me alfabetat të ndryshëm sa s’u kuptoshin njani me tjetrin. Kur qe u dha Lirija në Turki me 1908 e Shqiptarët pa humbun kohë vrapuene, e mbas niasativës të Klubit “Bashkimi” të Monastirit, nën

kryesin e Z. Z. Zavalani e Qirias, u mlodhne në një Kongres të përgjithshëm të marrë piesë të gjith viset e Shqipnis e të gjith entet literare. Mbas shum përpjekjesh u-përfundue alfabeti i Stamollit i cili në pak kohë vdiq; dhe alfabeti Itinisht qi kena sot zyrtar.

Mbassi gërmat Itinisht nuk miaftoshin për me dhanë të gjitha zânët Shqipe, u detyruene të bashkoine dy gërma për një zâ; e në bashkim të tyne u-mbaitne për bashkim të natyrshëm, por ku nuk ju eci, përdoruene bashkimin arbitrar, tue u-bazue mbas shembullit të gjuhvet tiera. Shqiptarët deshne të mldihen dhe një herë tieter për me caktue Orthografin, por trazimet qi ngjane në Shqipni e botë marë i ndaluene; deri sa me 1917 u mlodhne në Shkodër e tue formue Komisin letrare, themeluene edhe Ortografin Shqipe, të bazueme në fonetikë. Sa për libra gjuhsije, këshilluene dhe etimologjin; për me shugurue bashkimin e dhialektevet, porositne ate të Elbasanit e për çap të parë urdhnuene qi a me hundore, të këndohet e pazâne tosknisht, dhe me zâ të hundët gegnisht.

Me 1920 u-mlodhne në Lushnje e caktuene fialët teknike qi do të përdorin ndër libra Shkolle, dhe me kaq literatyra hyn në radhë me literatyra të përbotshme.


Literatyra e jonë njehë përkëthime e vepra originale të miafshme; Gramatika Shqipe dhe nder gjuhë mâ të përparueme

të botës; ashtu fialor; libra shkollash e ditunish të ndryshme; Rromanxa e vepra të ndryshme theatrash; libra të miaft për fena të ndryshme; dhe përkëthimet e Kristoforidhit, të Xarishit Nolit, Çajupt, etj., ashtu shkrimet e Konicës, Sqirohit, Miedës Zanonit, Xhuvanit, Gurakuqit etj; mund tq përkrahen me vepra të çmueshme të botës së qytetnueme; sa për Vierrsha nepër miet të Fishtës e të Prendushit mund t-ja kalojnë shum literatyravet tiera.

Dhe të Përkohshme e gazeta nuk i mungojnë gjuhës Shqipe, dhe sot gjuha e jonë asht e studiume prej shum nierzësh të ditun, dhe e detyrueme ndër shum shkolle t’Europës, veçanerisht ndër ato qi merren me tregti; dhe me karrierë konsulare.

Sot qi Shqipnia âsht plotsisht e lir, gjuha Shqipe asht gjuhe zyrtare, dhe ndër gjitha degët e administratës asht e detyrueme: Shum Shqiptarë i kan kushtue jetën e vet lavrimit të gjuhës dhe shum te pasun baine testamend gjân e tyne përparimit të gjuhës s’onë

Sot âsht heret qi të shkruim një Literatyrë Shqipe në veshtrim të plotë të fialës, pse për vepra të vdekunvet së kem çka thoimë pse s’ja vin mendi, dhe për vepra të gjallvet âsht shpeit qi t’i ftoime në gjukatore të kritikës, pse veprat e tyne s’kan nxâne ene vendin e qindrueshëm; me gjith kete shkrova sa kënduet, e po të doni më shani, por me i nxanë ju lutem t’i nxeni



BOTIM I RI NGA MINERVA



KONFUCI

Analektet

Minerva

ANALEKTET
Nga Konfuci

përktheu Arben Shehu

Analektet janë një përmbledhje e thënieve të Konfucit e hartuar nga nxënësit e tij pak pas vdekjes së tij më 497 p.e.s. Së bashku ato shprehin një filozofi, ose një kod moral, që sipas Konfucit, një prej mendimtarëve më humanistë të të gjitha kohërave, duhet të jetë fanari ndriçues për jetën e çdo njeriu. Duke ngritur lart idealet e urtësisë, të njohjes së vetes, kurajës dhe dashurisë për njerëzimin, Konfuci argumentonte se ndjekja e virtutësisë duhet të jetë objektivi suprem i çdo individi. Dhe ndonëse ndjekja e Udhës, ose së vërtetës, mund të mos sjellë përfitime të menjëhershme ose të mira materiale, Konfuci tregoi se, pavarësisht kësaj, ajo mund të sillte shpërblimet e saj të fuqishme dhe të përgjithshme.

“Lun Yu”, që në përgjithësi njihet si *Analektet*, është lexuar aq gjerësisht në Kinë sa është lexuar Bibla në Perëndim dhe është i vetmi dokument i besueshëm i mësimave të Konfucit.

Një nga bijtë e perandorit Ching u caktua si mbret i Lu-së (vendlindja e Konfucit) në vitin 154 p.e.s. Pas njëfarë kohe, duke dashur që të zgjeronte pallatin e tij, ai nisi të shkatërrojë shtëpinë e familjes Kung, ku dihet se kishte jetuar vetë Konfuci.

Gjatë këtij procesi, në muret e shtëpisë u gjetën kopje të *Shu-ching*, *Chun Chiu*, *Hsiao-ching* dhe *Lun Yu* ose *Analektet*, që ishin fshehur atje kur kishte dalë urdhri për djegien e librave. Gjithë kopjet, gjithsesi, ishin shkruar në formën më të lashtë të alfabetit kinez, që kishte dalë nga përdorimi, dhe mbreti ia ktheu ato familjes Kung, kreu i së cilës, Kung An-kwo, iu dedikua studimit të tyre dhe, pas njëfarë kohe, në pajtim me një urdhër perandorak, publikoi një vepër të titulluar “Lun Yu, me shpjegimin e germave dhe paraqitjen e kuptimit”.

NJË DEBAT PËR PËRKTHIMIN E POEZISË: PËRKTHYESI- SI POET I FSHEHUR?

Nga Agron Tufa



Çfarë është përkthimi i Poezisë?

A. T.: Pyetjes se ç'është përkthimi i poezisë, mund t'i përgjigjemi, si regull metodologjik, kur të kemi përkufizuar se ç'është vetë poezia. Pa hyrë në varreza përkufizimesh, po zgjedh njërin, më të parapëlqyerin, atë të Bertold Brehtit: "Poezia është ajo se çfarë bënë ndërtuesit e Murit të Madh kinez ditën tjetër, pasi u mbarua muri". Thelbi i poezisë ka të bëjë me ontologjinë e së padukshmes, së parrokshmes, habinë dhe delikatesën e të cilës mundohen ta shprehin poetët duke rravguar t'i gjejnë një gjuhë gjegjëse për ta aktualizuar.

Së këndejmi mund të përfyryjmë shkallën e vështirësisë së përkthyesit në gjakimin e tij për të rishprehur të pashprehshmen. Këtë ka pasur parasysh Salvatore Quasimodo, poet, por edhe përkthyes e lavdishëm i lirikës antike greke, kur qe shprehur me pesimizëm rreth mundësisë së përkthimit të poezisë: "Aq sa mund të përkthehet shiu me tërë kompleksitetin e tingujve dhe aromave, aq mund të përkthehet dhe poezia". Flas, para së gjithash, për idenë time mbi poezinë, duke pasë parasysh jo poezinë që mbizotëron sot në të gjitha kulturat, me komponenten e saj narrative, me gjuhën e njëtrajtshme drejtvizore, e gjitha vers-libres, pa organizim metrik, pa strukturë ritmike, aliteracionesh e muzikalitete rimash. Shumë lirika antike, klasike e moderne, madje ndër më të bukurat, mbeten të pamundshme për t'u përkthyer. Kam parë disa modele të kësaj lirike, në rastin e Lasgush Poradecit, për shembull, që janë përkthyer në gjuhët e tjera në atë farë feje, që më mirë të mos ishin përkthyer fare. Pse ndodh kjo? Sepse materiali ndërtues i letërsisë është fjala, materiali më njerëzor midis gjithë të gjitha arteve; por fjala, përkundër ideve dhe ndjesive, ka një cak material të kufizuar, është më pak e ephsme, më pak e zotërueshme se ngjyra apo tingulli. Prandaj artet e tjera të mëdha, artet plastike dhe muzika, nuk njohin kufij gjuhësorë e nacionalë, ndërsa arti më i lashtë dhe, ndoshta më i fuqishmi – poezia, bëhet memec jashtë kufijve gjuhësorë të një populli. Këtu qëndron dhe tragjika e përkthimit të poezisë, përderisa poezia është arti i vetëm, i përmbyllur në kufijtë gjuhësorë.

Përkthimet plakën, sikundër plaken dhe veprat origjinale letrare, sikundër plaken

edhe veprat e arteve të tjera; por të gjitha plaken sipas mënyrës së vet. Përkthimet plaken më shpejt se origjinali. Prandaj lind nevoja për përkthime të reja. Origjinalin nuk mund ta nxjerrësh nga përdorimi letrar, ngase ai është unik; përkthimi gjithmonë mund të zëvendësohet me një përkthim të ri, ngase ai potencialisht është i shumëfishtë. Por përkthimi fiton një jetëgjatësi mjaft të madhe, nëse ai pushon së konsideruari si përkthim, si për shembull "Mbreti i Tulës" së Mjedës përkthim nga Gëtja; "Korbi" i Poes nga Noli, "Meri Morrison" dhe "Ylli" të Lasgush Poradecit, të përkthyer përkatesisht nga Robert Bërsi dhe Mihai Eminesku. Padyshim ka shumë shumbuj të tillë. Ka pasur dhe më vonë përpjekje për t'i përkthyer, por nuk e kanë arritur dot nivelin mjeshtëror të Mjedës, Nolit dhe Poradecit. Për mua këto modele nuk janë më përkthime: me kohë, ato treten e përthithen në sistemin e vlerave të poezisë kombëtare, shndërrohen në krijimtari origjinale.

Përkthimi është krijimtari, ngado që ta kthesh (pavarësisht nëse përkthyesi është poet ose jo): krijimtaria përkthimore është gjithmonë kundërtë e vetë natyrën e saj, sepse ajo duhet ta bëjë veprën e gjuhës së huaj fakt të letërsisë amtare, duke e dalluar atë si krijesë të një populli tjetër. Nëse përkthimi nuk shndërrohet në fakt të letërsisë amtare, ai nuk do të receptohet si vepër arti. Nëse ai nuk mbetet krijesë e një populli tjetër, ai pushon së qeni përkthim. Përkthyesi vazhdimisht duhet të zgjidhë detyra që përjashtojnë njëra-tjetrën dhe të përfshijë të papërfshishmen. Ai është krijues dhe është i lidhur me tekstin e huaj; ai duhet ta bëjë monumentin e artit të së shkuarës të gjallë për receptimin bashkëkohor (poezia anntike greko-romake) dhe të japë njëkohësisht gjurmën e kohës që prehet në të; ta bëjë tekstin e huaj të tijin, për lexuesin, ta ruajë dallimin e të qenit i huaj; të riprodhojë të gjitha simptomat e një jetë tjetër dhe të mos e ngarkojë përkthimin me detaje të pakuptueshme.

Por përkthimi i poezisë ka bërë më shumë pesimizëm, madje në kampin e poetëve më të mëdhenj botërorë, duke u nisur që nga Rilindja, me Danten, në traktatin e të cilit "Simpoziumi" gjenden këto fjalë: "Le ta dijë gjithkushi, që asgjëja, e burgosur brenda qëllimeve të harmonisë

në bazën muzikale të vargut, nuk mund të jetë e përkthyeshme nga njëra gjuhë në tjetrën, pa prishjen e gjithë harmonisë dhe hijeshisë së saj". Teoricienët e përkthimit të poezisë, që u përmbahen pozicioneve të "përkthyeshmërisë", shpesh nuk dinë ç'të bëjnë me ithtarët e papërkthyeshmërisë, ndaj thjesht i injorojnë pozicionet e tyre. Nga ana tjetër, mospërfillja e tyre nuk është krejt e përligjur, pasi shpesh kjo përbën një kërcënim serioz për përkthimin e poezisë, duke e paraqitur fenomenin e përkthimit në mos një art të lehtë, atëherë të mundshëm. Duhet thënë, se mundësitë e përkthimit lidhen, më së shpeshti, me vetëdijen mbi shkallën e vështirësisë së tij dhe aspak jo me pamundësinë. Sepse për fat, siç e dimë, është përkthyer e vazhdon të përkthehet. Le të kujtojmë sentencën, që Servantesi vë në gojën e Don Kishotit: "Të përkthesh nga njëra gjuhë në tjetrën... – është një lloj sikur të shikosh qylymat flamadë së prapthi: edhe pse i dallon figurat, ata gjithësesi janë të mjegulluara nga fijet që i mbulojnë, çka bën t'u humbasë gjithë ngjyra e shkëlqimit dhe lëmimi i faqes së përparme".

A duhet që veç poetët ta përkthejnë poezinë?

A.T.: Kjo varet nga shkalla dhe niveli i poetëve, nga prirja dhe afërsia që ka poeti-përkthyes ndaj një poeti të huaj. Poeti i vërtetë kurrë nuk do të vihet të përkthejë një shpirt të largët e të huaj në gjuhën amtare. Por kur poeti njeh "shpirtin e vet binjak", pushtohet nga mrekullimi i njohjes, këtë mahni ai kërkon ta bashkpjesëtojë me të tjerë të ngjashëm në gjuhën e vet. Epërsia e mjeteve shprehëse, intonacionit, fjalëformave dhe përftesave leksikore, ritmit, muzikalitetit të brendshëm, por dhe thelbit filozofik të vegimit, imagjinatës, metaforizmit dhe gjetjeve të tjera, nuk kanë të krahassuar me korrektesën dhe besnikërinë e instrumentarit filologjik të përkthimit besnik të poezisë. Përkthimi filologjik me shënime, apo përmbushja e përkthimit besnik të kuptimit që zakonisht bëhet në prozë, sado i saktë të jetë, në rastin e poezisë ndriçon vetëm një aspekt të saj. Poeti e rikrijon organikisht dhe harmonishëm thelbin e poezisë, të pandarë nga muzika dhe imazhi origjinal, sepse gjendet në të njëjtin intensitet të valës emocionale. Këtu e shoh

dhe epërsinë e përkthimit të poezisë nga një poet. Po përsëri, edhe midis poetëve ka shkallë të ndryshme pilotazhi. Nga tradita e përkthimeve tona të poezisë antike e moderne, personalisht më ka shijuar qasja e gërshetuar poetike dhe filologjike e poetit Arshi Pipa në librat "Lyrika latine" dhe "Lyrika europiane moderne" (botime të "Plejad"). Në "Lyrika latine", simbioza e poeti me filologun i paraprin përkthimeve të poetëve augustinë me një përimëtim të krijimtarisë së secilit, mandej harton për çdo poezi një skemë të saktë metrike të originalit, të cilën e përmbush, sipas traditës së poezisë shqipe, në dy dialekte letrare: në gegnisht dhe toskërisht. Pipa arsyeton se poezitë e përkthyer në toskërisht janë ato lloje të lirikës erotike që kanë modele më të zhvilluar në poezinë tonë orale e të kultivuar, një gjuhë gjegjëse të përpunuar, ndërkaq që elegjitë dhe metamorfozat e Ovidit apo poemën filozofike të Lukrecit "De rerum natura" i ka përkthyer në gegnisht, si gjuhë gjegjësisht më me peshë në solemnitetin e mendimit.

Përkthyesi i poezisë, aq më tepër kur është poet, kushtëzohet nga shumë faktorë, ndër të cilët rol të fuqishëm ka tradita e caktuar me koniukturat gjithfarëshe (politike, religjioze, mondane apo dhe kanuni i fortë estetik). Përkthimi ka vulën e kohës kur është përmbushur dhe jashtë koniukturës së saj nuk abstragon dot. Përfytyroni përkthimin e poemave të Homerit përgjatë Renesancës deri në shek. XVIII, ku ndryshe nga origjinali grek, personazhet i drejtohen njëri-tjetrit me vetën respektuese "ju", madje në piskun e përlëshjeve. Prandaj ripërkthimet kanë synim përditësimin e gjallë të poetit, duke e shpërngulur diskursivitetin e dikurshëm në një plan krejt të ri artistik, shoqëror e filozofik. Nga ana tjetër vetë poeti-përkthyes duke qenë produkt i traditës, lë në përkthim vulën e traditës që ka pas shpine. Për mua, shumica e përkthyesve të viteve '50-'60 e lënë dukshëm këtë gjurmë në përkthime, pasi tradita më e fortë që ata kanë pas shpine është tetëvargshi popullor. Kësisoj poezia e përkthyer "rrëkëllehet", përkundër skemës metrike origjinale, në një folk të pashmangshëm vallëzues.

Në traditën e përkthimeve tona shembujt e qëlluar të përkthimit të poezisë janë kryesisht nga poetët. Por niveli i abuzimeve me nocionin "poet", ka sjellë edhe një amulli të madhe në repertorin tonë të përkthimeve të shumta e të këqija. Askush nuk e ka në dorë të shpallë dikë "poet" apo "jo poet", pavarësisht faktit që dikush boton poezi dhe vëllime poetike. Përkthimi i poezisë së huaj në shqip me liberalizimin e botimeve është bërë një sëmundje banale kronike: shumë grafomanë që kanë botuar nga një karikator me libra në vargje dhe i janë ngjitur si bisht kërriçi letërsisë, i japin vetes të drejtë të shëmtojnë mjeshttrat me fjalën e tyre gungaçe. Këta kokëshkretë mendojnë se duke iu qepur poetëve të mëdhenj, do të fitojnë ndopak lavdi dhe vetë.

Me gjithë këto avantazhe të poetëve përkthyes, a mund ta pranojë përkthimin e poezisë vetëm nga Poetët?

A.T.: Pothuajse të gjithë përkthyesit e poezisë shkruajnë vetë poezi, por jo të gjithë besojnë në vlerat origjinale të poezive të tyre. Jo të gjithë botojnë. Mendoj se nga ky sort krijuesisht (se përkthimi është lloj rikrijimi) na vijnë përkthyes, shpesh të mirë, ndonëse "zyrtarisht" nuk janë poetë të shpallur. Poeti dhe përkthyesi Rudolf Marku në anketën e javës së kaluar ka sjell një radhë emrash të ndritur "jo poetë" në repertorin e përkthimeve tona, të cilët, gjithësesi, krijimtarinë e tyre origjinale e kanë mjaft të zbehtë përballë poetëve që kanë përkthyer. Përkthimi i poezisë nga një "jo poet", shmang një prirje "korruptimi" të originalit, që e ka në përgjithësi poeti, tek i cili ngre krye personaliteti i tij poetik. Kështu, për shembull, të gjithë poetët rusë të "shekullit të argjenditë" të përkthyer nga

Sergej ESENIN (1895-1925)

* * *

Mos u shani! Ç'dreq ju nguc?!
Unë s'po bëj pazar me fjalë.
M'u rëndua, krejt m'u kërrus
Koka ime me krela të artë.
S'kam dashni për qytet, as për fshat,
Si e bora pa dhimbje kështu?
Do lë mjekërr! Çdo gjë do ta flak,
Do marr rrugët Rusisë, kuturu.
Do harroj dhe librat, poemat
Do hedh trastën kurrizit për udhë,
Se shtegtarit ndër fusha ernat
I këndojnë më shumë se çdokujt.
Era rrepë, era qepë do më vijë
Dhe, tek paqen e muzgut truaq -
Qurret fort me dorë do t'i shfryj,
Për çdo gjë budallain do luaj.
Tjetër paqe nuk dua t'arrij,
Pos në shmang, tufanin të ndjek,
Sepse pa këto shtijaní
Nuk u shtyka mbi dhé kjo jetë.
1922

I zbrazi fjalët koría e artë

I zbrazi fjalët korija e artë
Me gjuhën e mështeknave gaztare.
Dhe krillat duke ikur pikëllimthi
S'patën për askënd grimë keqardhje.
Keqardhje? Çdokush s'është pos shtegtar
Që ikën, vjen e rish e lë shtëpinë.
Për ta ëndërron veç kërp' i kopshtit
Me hënëzën që mbi gjol të kaltër ndrin.
Fillikat jam mes fushës së shkretë,
Po krillat era larg zharg i tërheq.
Mendoj veç për rininë - gaz e jetë,
Po për asgjë të shkuar s'më vjen keq.
S'më dhimbsen vitet që i shkova kot,
S'më dhimbset shpirti bojë jargavan.
Rjabinë e kuqe digjet zjarr në kopsht,
Por ngrohtë zjarr' i saj askënd nuk mban.
Degët e rjabinave s'kanë të djegur,
Në të verdhë firas bari dalngadalë,
Ashtu si pema gjethet lëshon heshtur,
I lëshoj dhe unë të trishtat fjalë.
Dhe nëse koha, me erën duke ngarë,
Mbledh gjithçka në një pirg të ngjeshur...
Ju thoni thjesht... ja, korija e artë
I zbrazi fjalët me gjuhë të dhembshur.
1924

BORIS PASTERNAK (1890 - 1960)

Shkurt

Shkurt. Të nxjerrësh bojë dhe të qash!
Shkurtin ta shkruash me ngashërimë,
gjersa të rëndën llohë të trashë
si serm të zi ta djegë kjo stinë.

Të marrç pajtonin. Për gjashtë grosh,
nën jeh kambanash, vizgë rrotash,
ku rreh rrebeshi të mëtosh
më fort se boja edhe lotët.

Ku porsi dardhat shkrumbur pemësh,
njëmijë mëllenja ngrihen qiejve
tek turren dhe shkapetin pellgjesh
trishtim të thatë në fund të syve.

Nxin toka mes borës së shkrirë,
era – e grirë në ulërimë,
dhe sa më rastësisht, më mirë
dalin vargjet - ngashërimë.

Në shtëpi s'do jetë askush...

Në shtëpi s'do jetë askush
Përveç muzgjeve. E vetme
Dritë e dimërt dhomën mbush
prej të çarave të perdeve.

Veç të lagta, t'bardha fjolla
Pushatake frullojnë shpejt.
Veç çati, borë e, përpos
Çati, borë e asgjësend.

Dhë sërishmi shtrohet bryma,
Dhe sërishmi kaplon egër
Pikëllim' i tjetër dimri
Edhe breng' e dimrit tjetër.

Vjen dhe sot sërish më mbyt
Faji, si një komb në grykë,
Dhe dritaren trajtë-kryq
I drunjti thëllim e shtyp.

Vrapon perdesh me të katra
Drithma që të hyn në mish.
Heshtjen tek e mat me hapa,
Si e ardhmja ti do hysh.

Ti do shfaqesh në prag porte
Me të bardha, pa manierë,
Me diç drejt prej asaj cope,
Nga flokboret janë prerë.

1931

Josif BRODSKIJ (1940-1996)

Elegji e madhe për Xhon Donin

Xhon Doni fjeti. Qark fjeti gjithçka.
Fjetën muret, shtresat, dyshemeja,
Fjetën pikturat, llozat, ganxhat e mëdha,
Kristali, qirinjtë, perdet, bufeja.
Gjithçka tash fle. Shishet, gotat, legenët,
Buka, thika dhe ora mbi komó,
Kandili, ndërresat, xhamat, enët,
Këmbët e shkallëve, dyert. Natë ngado,
Ngado natë: shtresash, qoshesh, në syrin
Mes fletësh, në ligjëratën e gatitur,
Në fjalë, në mashë, në dru, në qymyrin
E vatrës që si gjithçka fle fikur.
Në hijet pas pasqyrës, në corapë,
Në kundra, shpinore, krevat, jelekë,
Në Krishtin e kryquar, legen, çarçafë,
në fshesë, këpucë. Çdo gjë ka fjetë.
Fjeti gjithçka. Dritares bora ndrin.
Si sofrabez zbardh çati e pjerrtë
E fqinjit. Dhe lagjja gjumit s'pipëtin
Gua suazë e frëngjisë për vdekje prerë.
Fjeten muret, harqet, gjithçka në botë.
Ballmarët, grilat, lehet, sokaqet.
Nuk feks asnjë dritë, s'kërcet asnjë rrotë...
Ojnat, zinxhirët, komotë, parmaqet.
Flenë dyert, unazat, ganxhat shqim.
Bravat, llozat, kyçat, shulet varg,
Asnjë pipëtimë, trokitje, zhurmim.
Gjumë. Bora kërcet. Agsholi është larg.
Flenë burgjet, kështjellat. Flenë kandarët
Në dyqane peshku, derrat e rrjepur,
Shtëpia, kopshtet, zinxhirët, zagarët.
Tavernës fle macja veshëngrehur.
Flenë minjtë, njerëzit. Londra rëndë flen.
Në port gjemia fle. Në kuvertë të saj
Uji me borën njësh flen edhe gërhen
Tek derdhet qiejsh-fjetur të paskaj.
Xhon Doni tashmë fle. Dhe deti me të.
Fjeti përmbi det dhe breg' i tebeshirtë,
Gjumit kredhur i gjithë ishulli flë.
Mbyllur ka çdo kopsht me lloz të trefishtë.
Flenë panjat, pishat, shkozat, arnriu.
Flenë shpatet, currilat, dhiarët,
Dhelpira, ujku. Ra të flerë ariu.
E ngrënë buzë zgavre pirg dëborën
shqarthët.
Dhe zogjtë flenë. Me këngën unike.
Klithm' e korbit s'ndihet. Natë. Gazet
E hutit s'gjegjen. Fle hapësira britanike.
Yjet ndrijnë. Miu lyp falje për mëkatet.
Gjithçka fle. Në varre të veta ngjitaz
Vdektarët flenë. Urtë. Në krevate
Flenë të gjallët në det këmishash.
Tek e tek. Thellë. Flenë përqafe.
Gjithçka fle. Fle lumi, mali, pylli.
Bishat, zogjtë, bota tjetër dhe e jona.
Natësorja borë flokon nga qielli.
Por flenë dhe atje lart mbi kokat tona.
Flenë engjëjt. Botë e shkretë harruar
Në gjumë shenjtorësh - për turp të tyre
t'shenjtë.
Ferri fle, fle parajsë e amshuar.
Askush kësaj nate jashta s'del.
Fle Zoti. Tash toka është e huaj.
Veshi nuk ndjen më, syri nuk kap rreze.
Dhe djalli fle. Mënia u qetua,-
Fjeti nën dëborë ndër fushat angleze.
Flenë kalorësit. Bash-engjëlli me bori,
Gjumi këput kokën pahitëse të kalit.
Kryeengjëjt, ngrykas, mizëri,
Flenë nën kubënë e kishës së Shën Palit.
Xhon Doni fle. Vargjet e tij flenë.
Gjithë imazhet, gjithë rimat. Të mprehta,-

Të dobëta s'gjen dot. Mëkat, ves e brengë
Në silabe shtrirë njësoj të heshtura.
Çdo varg me tjetrin është si vlla binjak
Ani pse sho-shokut: lëviz pak, i thotë.
Nga portat e parajsës janë aq larg,
Të pastër, mjeranë, si një e vetme botë.
Gjitha strofat flenë. Të rreptët kode, jambet,
Koret majtas-djathtas si karakollë të qetë.
I ujërave të Letës vegim' i thellë endet,
Pas tyre fle thellë – lavdia vetë.
Mjerimet flenë. Ves-e-breng-e-thellë.
Ngrykas flenë e mira dhe e keqja.
Orakujt flenë. Flokim-i-bardhemë
Kërkon hapësisë do pak lara t'zeza.
Gjithçka fle. Të librave pirgjet
Flenë. Faktet në ligjërata.
Lumenj fjalësh nëkull harrimi dergjen-
Zinxhirë-kumbim – dobët ndër hallka.
Fle gjithçka: shenjtët, djalli, Zoti,
Shërbyesit e tyre të ligj, miq, fëmijë.
Rrugëve të errëta bora derdhet koti,
Dhe tinguj më nuk ka në lëmsh të dheut t'zi.

Por shshsh! N'errësi të ftohtë, ti ndjen
dikë që qan atje, pëshpërin me tmerr.
Dikë braktisur dimrit aty gjen
Dhe qan ky dikush dergjur në terr.
Aq i hollë ai zë. Mu si një gjilpërë,
veç fill nuk ka... Vetmitar, i qartë
pluskon në borë. Ftohtë e terr është bërë...
Tek natën qep me agun... ah, sa lart!
Kush pra qan atje? Ti vallë, engjëlli im?
Si pret vera nën borë kthimin përsëri
O dashnia ime... shpisë, territ në kthim,
S'je ti që po klith?... Nuk gjegjet njeri.
S'je ti, o kryeengjell? Kor' i trishtë
Këta lotë kumbues m'i shtiu në mendje.
S'vendose ti, që të fjeturën kishë
ta lësh befas? S'je ti, pra? S'je ti? - Heshtje.
“S'je vallë ti, Pal? Vërtet, zëri yt
I trenuar tmerr është ndër fjali.
Territ, thinjur, s'e vare vallë kryet
Dhe qan atje?” - Flatron heshtja karshi.
Territ vallë, s'është ajo dorë vështrimi
Që gjithkund dallohet që larg?
“S'je vallë ti, o Zot? I egër mendimi.
Porse fort po qan njaj zë i lartë”.
Heshtje. Qetësi. Nuk qe ti, Gabriel,
tek sekush lehu fort kur borisë i fryve?
Vetëm unë hapa sytë nën qiell:
thinjeshin kalorësit mbi kuajt e tyre.
Gjithçka rëndë fle. “Qafuar në terr
Ti vrap yshte turmën nga qiejt tëhu,
Mes dimrit, s'qe ti, o Gabriel
që me bori mes territ fill dënes këtu?”
“Jo, Xhon Don, jam unë, shpirti yt, ndër re
të qiellta, vetëm me pikëllimet.
Për çka me mundin tënd ti dhe -
Të rënda-zinxhirë, ndjenjat, mendimet.
Me këtë barrë, flatrimin mund ta kryeje
mes pasionesh, mëkatesh, lartësish.
Ti si zog popullin tënd e këqyre
Kudo, cullak, tek ngjiteshe shkëmbinjsh.
Gjitha detet pe, viset e largëta,
Dhe ferrin e pe, më pas në vetvete.
Ti e pe si përshkëndit parajsa
Më e trishta gjë ndër pasione t'vedekshme.
Ti e pe: Jeta është si ujdhesa jote.
Dhe mes oqeanit këtë gjë takove:
Vetëm terr e klithma kudo kësaj bote.
Ti ktheve - dhe tek Zoti fluturove.
Të ngjitesh lart - kjo barrë ty s'të lë
Prej nga kjo botë ca qindra kulla vjen
Me fjongo lumenjsh, ku prej pamjes në të
Ai gjyq i tmerrshëm, - i tillë s'rrefën.
Klima nuk lëviz mëtë anë fare.
Andej si gjumë i keq gjithçka moliset.
Atje zoti është një dritë në dritare
Të një shpie n'mjegull terratisur.
Rastisin fusha. Ata plug s'i lëron.
Me vite s'i lëron. Me shekuj fare.
Veç pylli përreth mureve qëndron,
veç shiu barërash hedh vallen e madhe.
I pari druvar, i të cilit kalë-
turret vërdallë gjithë tmerr në korijë,
Ngjitet në një pishë, befas dallon zjarr
Larg tek digjet tej luginës tij.
Vis i marrtë këtu. Larg gjithçka, gjithçka.
Vështrim-qetë shket ndër t'largëtat çati.
Kaq ndritshëm këtu. Lehje qeni s'ka.
Dhe tinguj kambane s'ndjehen në ajri.
Dhe kupton që gjithçka është larg. Në pyje
me një gjest e kthen ai kalin vrik.
Sakaq, freri, saja, nata që po bie
dhe kali thatan kthehen - gjumë biblik.

Oh, jo, unë qaj, qaj, nuk ka rrugë.
Në këta gurë i thënë jam të kthej.
Andej nuk vij dot veçse me trup
Vdektar m'është thënë të vij andej.
Po, po. Duke të harruar ty drita ime.
Në të freskëtën tokë që vuan përjetë.
Të lundroj pas dëshirave t'pangime
Vetmitar me trup ndarjen time t'qep.
Nuk jam unë që qaj – ti ngashëren Xhon
Don.

Si enët në raft-ti fillthi je shtrirë.
Ndërsa n'shpi të vjetër bora fërfëllon
Flatron që andej territ përpirë.

Si zogjtë ai po fle në fole të vet.
I etur për një tjetër jetë më të mirë.
Të pastrën rrugë ia besoi përjetë
Yllit që ndër rreze tash është ndryrë.
Shpirti i tij si zogjtë është i ndritshëm.
Laikja udhë mbase qe mëkatare,
Një kafaz korbi i natyrshëm
Ndër të hirtat bosh kafaze t'gargujve.
Ditën zgjohet si zogjtë zhurmëshumë.
Tash shtrirë po rri shtresash të ngrira
Përsa me borë është qepur dhe me gjumë
Mes shpirt-e trupi t'fjetur hapësira.
Porse pret në fund dhe pse gjithçka fjeti,
Vargu që skërmit t'padhëmbën gojë surrati.
Dashnia laike - veç një peng poeti.
Dashnia shpirtnore - veç një kurm abati.
Në çfarëdo mulliri uji po të bjerë
Një miell do blaujë, çoje ku ta çosh.
Nëse jetën tënde e ndan me të tjerë
Vdekjen me kë vallë do mund ta pjesëtosh?
Kush të dojë e gris vrimën në pëlhurë.
Copë-copë. Ikën. Dhe sërish e gris
Sa herë kthen. Veç qielli kur e kur
Merr në terr gjilpërën e terzisë.
Fli Xhon Don, fli. Veten mos e mundo.
Kaftani vrima-vrima varet, vajmedet!
Atë vështro, yllin ndër re dallo
që botën tënde ruajti tash sa vjet.

1963

* * *

M. B.

E dashur, sonte dola nga shtëpia natën
vonë
të thith pak ajër të freskët që frynte nga
oqeani. si erashkë kineze qe djegur
perëndimi në dhomë,
dhe retë qenë mbledhur, si kapaku mbi
fortepiano.

Çerek shekulli më parë ti kishe pasion
njerëzit dhe hurmarabitë,
vizatoje me tush në bllok, këndoje nga pak,
dëfresheshe me mua; mandej krise me një
inxhinier-kimist
dhe, gjykuar nga letrat, u marrose
rrumbullak.

Tash ty të shohin në kisha provincave dhe
në metropol
në funerale me miqtë e rrethit tënd, që po
ikin rresht
njëri pas tjetrit; që në botë ka largësi, më
vjen mirë boll,
madje edhe më të parrokshme, se sa
ndërmjet nesh.

Mos më keqkupto. Me zërin tënd, trupin,
hiret e tua
asgjë s'më lidh tashmë; ato askush s'i ka
asgjësuar,
por të harrosh një jetë - më e pakta - njeriut
i duhet
edhe një jetë tjetër. E unë një të tillë e kam
kaluar.

Edhe ty të eci: ku tjetër vallë, përveçse në
fotografi,
ti prore pa rrudha do jesh, e re, gastare,
pikëvrer?
Se koha, nësa ndesh kujtesën, njeh të vetën
padrejtësi.
Unë tymos në errësirë dhe kalbësirë zbatice
nxjerr.
1989

**Çesllav MILLOSH
(1911-2004)**

Elegji për N.N

Menjëmend t’u dukka kaq larg?
Mjafton të ngarendësh mbi valëzat e
Baltikut
dhe pas rrafshultës daneze, tej pyjeve me
ahishta
kah oqeani të kthesh, dhe aty, fill dy hapa
ma ke
Labradorin – lëbardhur kësaj stine të vitit.
Dhe nëse për ty që andrron gjiun e shkretë
të detit,
që kaq tmerr i ke marrë qytetet dhe ta
shpifin autostradat,
do të gjendet makar një dhiare – përmidis
pyjesh të shurdhër,
përsipri kaltërsive poshtë borës së shkrirë të
liqenjve përplot gjurmë egërsirash, -
drejt e tek minierat e braktisura të arit
rrëzë maleve të Sierrës.
Mandej – merr teposhtë rrjedhës së
Sakramentos,
ndërmjet kodrash, harlisur me lisa
gjembaçë,
mandej – shpeshtina halore ekualiptesh,
përmbas cilit
më takon mua.

E di, shpesh, kur lulëzon mancanita
dhe gjiri kaltërohet mëngjesesh pranverore,
ndërmend padashje shtëpinë buzë liqenit,
rrjetat që thahen nën qiellin e ulët lituanez.
Ajo pishinë ku ti zhveshe fundin
ka ngrirë përjetësisht në kristal të kulluar.
Terri u mpiks mjaltë përqark verandës.
Kukuvajkat rrahin krahët, dhe kundërmon
lëkurë.

Si kemi mundur t’ia dalim gjallë, as vetë
nuk e di.
stilet, radhët shtillen mjegullishtë me
masën e zbërdhylët,
Shndërrohen në fosile.
S’ke si ia qëllon këtu thelbit.
Koha që ikën lyen me rrëshirë doriun
çil, dhe kolonadën vendase
të tregut, dhe parukën e madam Figeltaub.
Vetë e di, kemi mësuar shumë gjëra,
si të shkasin dore prajshëm ato
që s’mund duarsh të dalin: njerëzit, viset,
dhe si rreh zemra atëherë kur duhet të
plasë katërsh.
Buzëqeshim; çaji në trapezë, po ashtu
biskotat.
Vetëm dyshimi na ther herdokur, se hiri i
furrave
në Zaksenhauzen do të na kish qenë paksa
më i shtrenjtë.
Ani, kurmi nuk mund të dashurohet me hirin.

Ti u mësove me dimrat e rinj ndër shira.
Me muret e shtëpisë, prej nga është larë
përjetësisht
gjaku i padronit gjerman. Gjithashtu dhe
unë
mora prej jetës ç’munda: qytete dhe shtete.
Në të njëjtin liqen nuk mund të hysh dy
herë;
sall rrezja diellore përkitazi gjethes së
verriut,
cek, teksa përthyhet në fundin e tij dhe
bredhërin.

Jo, jo pse është larg
ti nuk m’u shfaqe as ditën, as natën.
Vit pas viti, duke u bërë gjithë e më i madh,
piqet në ne fruti i përbashkët: shpërfillja.

**Zbigniew HERBERT
(1924 - 1998)**

Raport nga qyteti i rrethuar

Jam tepër plak që të ngjesh pushkën dhe të
luftoj si të tjerët –
më ngarkuan për mëshirë rolin modest të
kronikanit
shënoj – një zot e di për kë – historinë e
rrethimit
lypset me qenë i saktë por nuk di kur nisi
sulmi

dyqind vjet më parë në dhjetor shtator
a ndoshta mbrëmbë ndaj të gdhirë
këtu të gjithë janë të sëmurë me humbjen e
ndjenjës së kohës
mbetur na ka sall vendi i lidhjes me vendin
ende s’i kemi lëshuar rrënojat e tempujve
fantazmat e kopshtieve e shtëpive
nëse i humbim rrënojat asgjë nuk na
mbetet
shkruaj si mundem në ritmin e javëve
patësosur
e hënë: depot janë bosh njësi e këmbimit u
bë miu
e martë: burgomistrin e vranë dofarë të
panjohurish
e mërkurë: flitet për pajtime kundërshtari
internoi ambasadorët
nuk i dimë vendndodhjet e tyre d.m.th.
vendet e ekzekutimit
e enjte: pas një mbledhje të furtunshme me
shumicë votash hodhën poshtë
propozimin e tregëtarëve të manifakturave
për kapitullim pa kushte
e premte: fillimi i murtajës e shtunë: i dha
fund me vetëvrasje
N.N. një mbrojtës i palëkundshëm e diel:
s’ka ujë thyem
sulmin e portave lindore të quajtura Portat
e Testamentit
këto të gjitha i kuptoj njëtrajtshëm askënd
s’e shqetëson
u shmangem komentarëve përmbaj
emocionet shkruaj për faktet
më duket se vetëm ato vlerësojnë në tregjet
jashtë shtetit
por me një krenari të madhe qejfi ma kish
t’i rrëfej botës
se falë luftës kemi edukuar një varietet të ri
fëmijësh
fëmijët tanë nuk i duan përrallat luajnë
veçse në vrasje
në ëndërr dhe zhgjëndër ëndrojnë për
supë bukë dhe kocka
krejt si qentë dhe macet
mbrëmjeve ma ka ënda të bares kufinjve të
Qytetit
përgjatë sinoreve të pasigurta të lirisë sonë
së larti sodis si një fole gjigande thneglash
ushtarët dhe zjarrthet e tyre
dëgjoj gjëmimet e daulleve vigmën e
barbarëve
dhe vërtet s’e kuptoj qysh ende mbahet
Qyteti
rrethimi vazhdon aq gjatë armiqhtë si duket
ndërrohen
asgjë të përbashkët nuk kanë përpos
babëzisë për vdekjen tonë
gotët tatarët suedezët ushtarët e Perandorit
divizionet e Shndërrimit të Perëndisë
s’kanë të numëruar
ngjyra e flamujve të tyre ndërrohet si pylli
në horizont –
verdhëzi delikate zogthi n’prag pranvere
jeshilishte purpurake llurbe dimërake
ndajnatë çliruar prej faktesh mund të vras
mendjen
për punë të ra të qëkurit përshembull për
aleatët tanë
përtej detit e di singërisht na kanë pikë në
zemër
na çojnë miell e thasë rrumbull me dhjamë
dhe këshilla të urta
madje as nuk e dinë që ne na tradhëtuan
etërit e tyre
aleatët tanë të kohës së Apokalipsisit të
dytë
bijtë e tyre s’janë fajtorë meritojnë
mirënjohje
dhe u jemi mirënjohës
ata s’e kanë përjetuar rrethimin e gjatë sa
përjetësia
ata që i ka pllakosur kobi janë prore të
vetmuar
mbrojtësit e dalaj-lama-s kurdët malësorët
afganë
njitash kur po shkruaj këto rradhë ithtarët e
kompromisit
morën capak të përpjetë mbi partinë e të
patundurve
paqëndrueshmëria e rëndomtë e gjendjes
shpirtërore zgjidhet ende prej fatit
gjithë e më tepër varre mbrojtës gjithë e më
pakë
por barrikada s’është shembur dhe gjer në
fund do qëndrojmë

dhe nëse Qyteti bie dhe dikush do shpëtojë
ai do ta bart në vetvete Qytetin udhëve të
syrgjynit
ai do të jetë Qyteti
e shohim në fytyrë zjarrin dhe urinë dhe
vdekjen
dhe atë mënxyrën e mënxyrave – fytyrën e
tradhëtisë
Dhe sall ëndrrat tona janë të pamorta.

**Wislawa SZYMBORSKA
(1923 - 2012)**

Fotografia e parë e Hitlerit

Po kush është ky kolopuç kaq i lezeçëm?
Ky është vogëlushi Adolf, pinjoli i
bashkëshortëve Hitler!
Ndoshta doktor do të bëhet në
jurisprudencë?
Apo ndoshta tenor në operën vjeneze?
Kujt i ngjan me këtë doçkë, qafëz, syçka,
veshëza, hundëz?
E kujt do të jetë kjo mullëz? Është herët ta
dimë:
E tipografit, komersantit, mjekut, priftit?
Ku vallë, këto këmbka të dashura, ku do të
mbërrijnë?
Në kopsht, në shkollë, në zyrë, në dasëm,
Mundet, mbase, me të bijën e burgomistrit?

Rrapatushi, engjëlushi, o diell, o shpirti i
logël,
Kur lindi e doli në dritë një vit më parë,
Kjo ngjarje në qiell s’kaloi pa shenja:
Dielli pranveror dhe elbaroza në dritare
Dhe muzika e instrumentëve në oborr,
Planeti i lumtur prej letre të trëndafiltë,
Ndërsa para lindjes – ëndrra profetike e së
ëmës:
Nëse të shtiret një pëllumb – merr haber të
gëzueshëm,
Nëse e kap – do vijë mysafiri që e ke pritur
gjatë.
Tak-tak, kësh është? Troket Dolfi i
ardhshëm.

Pelenat, grykësja, biberoni, raketakja,
Vogëlushi, marshallah, pt’hu-pt’hu, kokërr
molle,
Nana e baba gjallë, maçok në kanistër,
Si gjithë ferrishtet e tjera në albumet
familjare.
Epo, nuk do të qajmë, o xhaxhi fotografi,
Ky lëshon mushamanë e zezë dhe bën
shkrepen: çkrrak!

Ateljeja Klinger, Grabenshtaus, Braunau,
E Braunau është një qytetth i vogël, por
dinjitoz, -
Komshinj të nderuar, firma solide,
Kundërmon farë buke dhe sapuni të lirë.
Nuk ndihen as angullimat e qenve, as hapat
e fatit.
Mësuesi i historisë shkopsit jakën dimërore
dhe gogësin.

**Adam Zagajewski
(1945 - 2021)**

Nëse Rusia...

Nëse Rusia do që themeluar nga Annna
Ahmatova, nëse ligjvënës i saj
di të ishte Mandelshtami, ndërsa Stalini –
të ishte veç një pesonazh dytësor
i eposit të humbur gjeorgjian,
nëse Rusia do ta hiqte befas
lëkurën me qime të irrituara ariu,
nëse ajo do të jetonte me fjalën,e jo me
grushtin, nëse Rusia, nëse Rusia...

Flaka

Na jep një frymëmarrje të gjatë dimri
dhe qetësinë fashitëse të muzikës, dhe
buzhtë,
të gatshme për faljen, dhe një pikë,
veç një pikë krenarie sa jemi gjallë.
Na jep mahninë dhe flakën,
të lartë dhe të qartë, o Zot.

Ajo muzikë, të cilën ne bashkë...

Ajo muzikë, të cilën ne bashkë
e dëgjonim dikur, ka qenë
jo thjesht muzikë... dhe gjaku që na
vraponte
në vena, ka qenë jo thjesht gjak,
por diç më shumë, dhe vetëm lumturia
brenda nesh qe thjesht lumturi, dhe për
këtë
dikujt duhet t’i jem mirënjohës e duhet
t’ia shpreh këtë pikërisht tani:
derisa ende nuk është bërë fashë e plotë.

Paul CELAN (1920 – 1970)

Flokëboret e zeza

Ra borë, trishtueshëm. Tash një muaj
a dy që vjeshta në raso murgu
më çoi dhe mua haber - një gjeth nga
shpatet ukrainase:

“Përfytyro: tash dimri, për të mijtën herë
po hyn
dhe këtu,
në visin ku rrjedh një përrua i gjerë:
gjaku qiellor i Jakovit, bekuar me sakica...
Për akullin e një bukurie jashtëtokësore -
hetmani i tyre bredh
me kazakët nën diej të marrtë... Fëmijë, ah,
shami,
të më mbështjellësh kur tarogzat
shkëndrijnë,
kur ky krep i trëndafiltë të krisë, kur me
pluhur të dëbortë të stërpiket skeleti
i babait tënd, rraposur nën kopitat
e këngëve për kedrat...
Shami, shamizë, ja veç një të ngushtë po
ruaj
tash kur ti të mësohesh të qash ngushtësinë
e botës përbri meje, e cila kurrë s’do
gjethnojë,
o fëmija im, për fëmijën tënd!”

Mama, vjeshta rrodhi gjak prej meje, bora
më përvëloi:
kërkova unë zemrën time që me të të qaj,
dhe gjeta
frymëmarrjen, ah, të asaj vere.

Ishte ajo, si ti.
Loti çatisi rrëmbimthi. Unë qëndisja
shaminë.

Plepi i egër

Ti në terr, u zbardhe, plep i egër,
Nënë time s’e kam parë të thinjur.

Luleshurdhë në fushat e Ukrainës!
Nëna ime bjonde shkoi e s’u kthye.

Vjerrë mbi pus, ti ishe, re e zezë?
Mbi të gjithë nëna dënes qetë.

Ti, o yll, të artin lak e ende.
Nënë time plumbi shpoi në zemër.

Kush çivishë ju nxorri, o porta lisi?
E ëmbla nëna ime s’kthehet kurrë.

Nën dritën e qiririt

Murgu me gishta leshtakë hap librin:
shtator...
Si një dorë borë bie Jasoni mbi fushën e
harlisur.
Ty një gjerdan perlash të dhuron korija e
dremitur, si të vdekurës,
me blunë e zezë të flokëve, dhe aherë do
marr të flas për dashurinë:

për karavidhet dhe retë, për varkën që u
qull nën rrebesh,
për një kalë të vockël që kërceu nga libri i
hapur, -
pas derës - terri, dhe era dot s’e përplas:
Si kemi jetuar këtu?

I përktheu nga origjinali: Agron TUFA

Përsiatjet për heshtjen ngërthejnë thellësi të peshuar zbërthimesh e brendi të pasur shpirtërore në poemën “Sytë e heshtjes”¹ të Anton Nikë Berishës. “Në heshtje shpirti flet me zë të lartë”, do të thoshte pedagogia gjermane Helga Schäferling. Këtë vepër mund ta lexojmë si një rendje të folësit lirik, rendje herë e qetë e herë dramatike nëpër rrathët e meditimeve. Është një shkarkim i vetvetes që nga rrethi i parë e deri tek ai i tridhjetetreti, aq pjesë sa ka libri. Ta krijon mbresën e ngjasimit me atë shtegtimin imagjinar shtatë ditësh tek tri pjesët e tridhjetetre këngëve të poemave danteske të “Komedisë hyjnore”.

1. Simbolika e numrit dhe paradigma tekstuale e heshtjes

Le ta lexojmë këtë poemë, pra, si një shtegtim meditimesh që ndërthur përvojën jetësore e krijuese të autorit në fushë të artit e në mbretërinë e heshtjes. Një krijim poetik i Nënës Tereze mban titullin “Ta dëgjojmë heshtjen” e që autori e vë si korrespondencë lirike edhe në kuadër të këtij kompleti veprash ku përfshihet kjo poemë. Të tridhjetetri përsiatjet poetike shënojnë ato momente të mendimit të thellë, kur secili prej nesh takohet, ndeshet dhe ballafaqohet me vetveten në mikrokozmosin e pakufi të heshtjes... Ligjërimi poetik i ngjason të folurit të Hyjit; ai na drejtohet përmes heshtjes së maleve, ujërave, blerimit të fushave, apo përmes një drithërime gjithi... Nëna Tereze thoshte:

“*Kontemplativët dhe asketët e të gjitha periudhave dhe të të gjitha religjioneve, e kanë kërkuar Zotin në heshtje e në vetmi të shkretëtirës, të pyllit, të maleve, edhe Krishti i ka kaluar dyzet ditë në shkretëtirë dhe në male, duke hyrë me orë të tëra, në bashkësi me Atin në qetësinë e natës. Edhe në jemi të grishur të tërhiqemi, herë mbas here, në një heshtje të thellë dhe në vetmi me Zotin, për të qenë vetëm me të, jo me librat tanë, me mendimet e me kujtimet tona, po të shkëputur krejtësisht nga çdo gjë, për të banuar me dashuri me praninë e tij: të heshtur, zë zbrazët, në pritje, të qëndrueshëm.*”²

ose:

“*Pastaj e kemi heshtjen e syve, e cila gjithmonë do të na ndihmojë ta shohim Hyjin. Sytë tanë janë si dy dritare nëpërmjet të cilave Krishti ose bota hyn në zemrën tonë. Shpesh na duhet shumë guxim që t’i mbajmë të mbyllur. Sa shpesh themi: “Dëshiroj të mos e kisha parë atë”, por nuk lodhemi shumë që ta mundim dëshirën të shohim çdo gjë.*”³

Në disa vëllime shqip të Nënës Tereze, gjejmë dhe tekste të tëra e meditime mbi heshtjen.⁴

Duke u marrë, nëpër shumë tekste, me lutjen, autori Berisha përsiat edhe për heshtjen:

“*Në uratë dhe përsiatje secili e provon thelbin e qetësisë dhe të paqes shpirtërore; aty e njeh veten më mirë, depërton më thellë në shpirtin e vet dhe në vlerën që ka. Duke hyrë, përmes lutjes, në të fshehtat e vetvetes, duke e njohur më mirë veten, secili bëhet më shumë i vetvetes. Kur bëhet mirëfilli i vetvetes, bëhet më shumë edhe i Hyjit.*”⁵

Heshtja dhe lutja te Nëna Tereze janë

¹ Anton Nikë Berisha, *Sytë e heshtjes*. Përsiatje poetike. Argeta LMG, Tiranë 2018. Me disa ndryshme botohet te kompleti “Nëna Tereze në shtatë shpalime”, 1 – 7. Botoi “Faik Konica” Prishtinë dhe Kuvendi Françeskan, Gjakovë, 2019.

² Shih Anton Nikë Berisha, *Nëna Tereze në shtatë shpalime*. Vëllimi i katërt: “I desha njerëzit me dashurinë e hyjit” (Doracak për Nënë Tereze.), botoi “Faik Konica” Prishtinë dhe Kuvendi Françeskan, Gjakovë, 2019, f. 264.

³ Shih: http://www.misioni-aarau.ch/nene_tereza_meditime_janar.php

⁴ Nënë Tereza, *Në zemër të botës: Meditime, rrëfime dhe lutje*, DEON – AB, Prishtinë 2014. përktheu Alfred Beka, f. 17-23. Nënë Tereza, mërmërimë shenjtoreje. Përzgjedhi dhe poetizoi Visar Zhiti, botimet OMSCA 1, Tiranë 2003, f. 106.

⁵ Shih Anton N. Berisha, *Thelbësorja e besimit dhe e lutjeve të Nënës Tereze*. Studim, Fjala Hyjnore, Prishtinë 2005, f. 61.

Poema “Sytë e heshtjes” të Anton Nikë Berishës

ZBULESA POETIKE E HESHTJES

Nga Prend Buzhala

pothuajse një, identifikohen si universe përsphirtërie. Ajo e shqipton, e ligjëron me fjalë e në heshtjen e shenjtë Lutjen si zgjim shpirtëror, nga e cila burojnë forcat dhe energjitë e brendshme shpirtërore, mu në situatat më të rënda të jetës e të historisë. Lutjen për të hapur udhë shpirtërore, për të krijuar ndjesi shpirtërore, për t’i manifestuar dhuntitë e shërbimit e të bamirësisë:

*Fryt i heshtjes është lutja,
fryt i lutjes është besimi,
fryt i besimit është dashuria,
fryt i dashurisë është shërbimi,
fryt i shërbimit është paqja.*

Nëna s’ka mundur ta kuptojë ndryshe as misionin e saj përveçse si heshtje të shenjtë, si lutje, besim, dashuri, shërbim dhe paqe. Për të ecur me butësi e guxim. Për ta mundur të keqen që nuk ndalet në shkatërrimin e veprave njerëzore. Nëpërmjet lutjes ajo njësohej me Hyjin; lutja ishte epistemologjia e saj e qenies dhe universi i saj i njohjes; nëpërmjet saj i kthehej identitetit shpirtëror të vetvetes, kuvendimeve të mistershme, krijimit të energjive shpirtërore për ta vënë në vepër dashurinë ndaj Hyjit e ndaj të tjerëve; i kthehej krye-kodit të saj ekzistencial, jetësor e qenieplotë - bashkëjetesës me dashurinë ndaj Hyjit e ndaj të tjerëve...

Mos të harrojmë se i gjithë projekti i saj jetësor-shpirtëror, është Dashuria, si ai URDHRI I PARË biblik i dekalogut të Hyjit për Dashurinë (“*Duajeni njëri - tjetrin! Sikurse unë ju desha juve*” (Gjn 13, 34) dhe “*Duaje të afërmin tënd porsì vetveten!*” (Mt 22, 39).

Ky zë i shqiptuar i heshtjes poetike, vjen i përsëritur tridhjetë e tri herë, në krye të secilit varg fillestar të tridhjetë e tri pjesëve të kësaj poeme, me thënien: “Heshtja është ...”. Ndërkaq, secila pjesë është një sonet më vete. Autori përfill strukturën sonetike prej katërmëdhjetë vargjeshe, në këtë rast, pa e ndarë sipas skemës strofike, me rimë të bardhë. Soneti (a tingëllima) sugjeron harmoninë e përsosur. Rimariumi i bardhë sugjeron harmoninë e brendshme të kuptimit të fjalëve... deri te leximet a kuptimet alternative. Kështu, numerologjia simbolike biblike, mistike apo letrare, vjen këtu me numrin 33, me harmoninë kumbuese të të gjitha pjesëve si në një orkestrim simfonik që na dhuron universin e heshtjes, na dhuron një hapësirë përsiatjesh të intelektit krijues. Ky numër është dhe një arketip, sipas numerologjisë simbolike, me atributet që përmban. Sipas Steve Desrosiers⁶, numri 33 “*në planin shpirtëror, përfaqëson vetëdijen shpirtërore, zhvillimin nëpërmjet përvojës dhe një dëshirë për të arritur një plan më të lartë të shërbimit... Krishti në Ungjijtë realizon 33 mrekulli, nga të cilat 24 janë shërime... Davidi mbretëroi 33 vjet në Jeruzalem. (1 Gjonit,3,4). Jakobi kishte 33 fëmijë nga gruaja e tij e parë Lea, duke përfshirë bijën e tij, bijtë e tij dhe nipërit*

⁶ Steve Desrosiers, *Les nombres: symbolisme et propriétés*, Përfunduar për t’u shtypur në shtator 2005 në Quebec City. Libër elektronik, f. 142.

e mbesat e tij. (Gjn 46,15)... Ka 33 mjekë të Kishës, ose teologë, të cilëve Kisha katolike njeh një autoritet të veçantë si dëshmitarë të doktrinës... Tridhjetë e treta e një personi është moshë e përsosur, ajo e plotë zhvillim... Në këtë epokë Jezu Krishti u kryqëzua, kur i kishte 33 vjeç. Shën Jozefi ishte edhe 33 vjeç kur u martua me Virgjëren Mari... Bazilika e Shën Pjetrit në Romë ka 33 kisha... “ e të tjera, ku ky autor paraqet një listë të gjerë përdorimesh referenciale e semantike të këtij numri në traditat indase, hebraike, kineze e tek popujt e tjerë. Përmendet, te rruzarja e lutjeve... Përgjithësisht, e konsideron si numër që përfaqëson përsosmërinë dhe veprimtarinë e vullnetshme të ekzistencës e të organizimit të botës; përfaqëson krijimin e lirë të planit të Hyjit nëpërmes dashurisë dhe drejtësisë.

Kësaj radhe, këtë ndarje në tridhjetë e tri njësi poetike përsiatjesh, le ta lexojmë si kërkim evokues autorial të harmonisë, dashurisë, përsosmërisë dhe kuvendimit të mistershëm me heshtjen. Në harmoni me përqsjet e mësipërme, do lexuar ato që i thotë teksti jashtë tekstit, nëntekstet, apo heshtjet e brendshme të tekstit, si do të thoshte Roland Barthes.

2. Përsiatjet poetike dhe metaforika e syrit të heshtjes

Edhe zhanri ngërthen paradigmen e vet semantike. Shëmbëlllyeshëm zhanrit të lutjeve dhe teksteve të Nënës Tereze, e cila shpesh i quan përsiatje⁷, edhe A. N. Berisha i quan *përsiatje poetike*, ashtu sikundër e përkufizon si të tillë edhe veprën e tij poetike “Prushi i bukurisë”.⁸

Përsiatja poetike është akt krijues, akt përkushtimi që e përgatit njeriun të hyjë në shtegtimet shpirtërore nëpër situatat e jetës së përditshme, nga njëra anë; një depërtim në mikrokozmosin e mistershëm të botës së brendshme dhe në makrokozmosin e hirit të perëndishëm:

*Heshtja është hiri i Hyjit,
ngrohtësi e pashuar dashurie
e ngjeshur me misteret e Tij,
që nëpër qiell e në tokë
përhapet me shkëlqimin e yjeve
të qëndisur me bardhësi resh*


Kështu e nis rrugëtimin e përsiatjeve të autori Berisha. Meditimi është i vazhdueshëm, i pandërprerë, si një zbrazje e përkushtimit dhe e shenjtërimit të qenies.

Dhe sa e sa poetë e poetesha e ndiejnë këtë mister ligjërimi!

Kësisoj, heshtja ndeshet me atë të universit, a me heshtjen e SUBJEKSTIT tjetër, prandaj dy heshtje shkaktojnë PLASARITJE! Drama e plasaritjes njerëzore ndodh në heshtje, me dy protagonistë-antagonistë

⁷ Nënë Tereza (Gonxhe Bojaxhiu), *Takohemi nëpër lutje*. Poezi. Zgjidhji e përktheu: Visar Zhiti, shtëpia botuese “Çabej”, 1997.

⁸ Anton Nikë Berisha, *Il fulgore della bellezza. Riflessioni poetiche sull’ arte della parola*. Traduzione a cura di Albana Alia. Luigi Pellegrini Editore. Cosenza 2014. Botimi i dytë Shtëpia botuese “Beqir Musliu”, Prishtinë 2015.



që përbëjnë AGON-in e heshtjes dramatike! Heshtja është periudhë e ndërtimit të urtisë. Ata zëra urtakë, prandaj, na thonë në HESHTJE: DËGJO! Atëherë vjen Paqja e Mendjes. Me anë të durimit...

Dhe praktika e tillë urtake, ta dhuron një jetë të re.

Sa e sa zbulime njerëzore janë bërë në heshtje. Sa e sa ndjesi ka ajo!

Heshtja ka zbulësën e saj sa poetike aq edhe hyjnore:

*Heshtja është ndriçimi hyjnor
që të mbështjellë me paanësinë e vet*

Përsiatja e tillë i kërkon përgjigjet dhe i jep nëpërmes një tipi të figurës retorike të epanaforës: “Heshtja është”, për t’i kërkuar përgjigjet dhe zgjidhjet. Përgjigjet shumëzohen nga heshtja. Kërkimet zhyten në thellësi drejt pafundësisë; thellësia përjetohet si madhësi e madhështi hapësinore, pafundësie; ajo thellësi mund të na mrekullojë me bukuri të mahnitshme; vetëm poeti arrin t’i shquajë thellësitë e shpirtit njerëzor përtej pamjes së dukshme të njerëzve e të ngjarjeve:

*është joshje që nuk resht,
kërkim i skajeve të thellësive
që të robërojnë me prirje të pafundësisë;
ujëvarë ndriçuese e vrushkujve
ngjizur dhe me penjtë e errësirës:
dallgëzim i vijueshëm i shpirtit –
përshkuar nga drithërima rrëzëllitëse.*

Ky akt përsiatjeje mbi heshtjen e në heshtje, shndërrohet në simbol të thellësisë për ta shënuar të vërtetën; e vërteta nuk është sipërfaqësore, as e lartë, por e thellë. Përtej një kundrimi të së dallueshmes, të dukshmes, ka një zhytje në thellësi. Madje, edhe kur kundrohet e sipërfaqshmja, ajo që shihet, poeti sheh diçka tjetër përmes këtij akti: “*ujëvarë ndriçuese e vrushkujve / ngjizur dhe me penjtë e errësirës: / dallgëzim i vijueshëm i shpirtit*”.

Poeti ka farkëtuar dhe një metaforë shumëkuptimore që në titullin e veprës: “sytë e heshtjes”. Heshtja ka sy! Heshtja antropomorfizohet, kundrohet si një qenie e gjallë, e madhërishtme. Platoni, si duket, i pari ka përdorur shprehjen “syri i shpirtit” (Republika 533d;cf527e). Dante shkruan për “dy sytë e qiellit” ku kanë lindur Apollo e Artemisa, Diana, Dielli dhe Hëna... Flitet dhe për “Syrin e Tretë” të mbi-mendjes, ashtu sikundër dhe për Sytë e Perëndisë që shënojnë hyjnoren, apo për Sytë heterotopikë etj. Shekspiri thoshte se sytë janë dritare të shpirtit. Dhe, sa herë e kemi dëgjuar shprehjen e tillë: “Sytë janë pasqyrë e shpirtit.” Patosi romantik i thënies i ka joshur edhe psikologët, edhe shkencëtarët, dhe, gjithsesi, edhe teologët e poetët. Sytë nuk dëshirojnë të gënjejnë, kur ne nuk duam ta themi të vërtetën. Nuk e fshehin ndriçimin e shpirtit, pastërtinë dhe ndershmërinë e brendshme. Leonardo da Vinçi (piktor italian, piktor, skulptor, arkitekt dhe inxhinier 1452-1519) theksonte: “Syri e sheh një gjë në mënyrë më të qartë në ëndrra se me anë të imagjinatës, kur je zgjuar.” Të tjerët e ndërlidhin shqisën e shikimit me intelektin dhe mendjen: “Syri

sheh vetëm atë që mendja është e përgatitur për ta kuptuar” (Henri Bergson). Mandej, identifikimi me qenien e Tjetrit, mishërohet nëpërmes shikimit dhe syrit, mu ashtu siç është heshtja e mishëruar:

*është vështrimi yt në sytë e tjetrit,
prushësi e dashurisë së pakursyer
që përhapet si puhizë në shpirtin tënd*

Njerëzit janë të prirë ta kenë dhe KUNDRIMIN E BRENDSHËM, si vlerë vetë vëzhgimi, ri-zbulimi, apo meditimi, aty ku ka mistere e të fshehta:

*ku visaret e shpirtit fshihen
si në sy lotët e dashurisë –*

“Hapni sytë, shikoni brenda. A jeni të kënaqur me jetën që jeni duke jetuar?” (Bob Marley). Kjo do të thotë, se vështrimi ynë i drejtohet emocionit dhe mendjes, ashtu sikundër drejtohet edhe kah thellësitë e qenies, me anë të reflektimit të thellë. Drejtohet kah universi i pa skaj, e ku bukuria e hapësirës përjetohet vetëm nëpërmes këtij shikimi njerëzor: “Qielli është buka e përditshme e syve” (Ralph Waldo Emerson).

Dhe, vërtet, jeta ka shumë ngjyra, ka kontrastimet e saj... dhe këto nuanca i dallojmë nëpërmes pamjes... Secili e sheh jetën dhe botën përreth, sipas vështrimit të tij unik... Dikush e ka thënë se krejt çka shkruhet në jetë, e shkruajnë sytë, është e shkruar në sy... aty ku e gjejnë strehën e tyre mendimet, ndjenjat, dëshirat, shpresat, por edhe frika apo makthet, apo dhe gjendja psikike, e brendshme, e njeriut...

Dashuria vjen në qenien tonë nëpërmes syve.

Poetët krijojnë aq shumë vargje për sytë, duke i shndërruar në metaforë të zbukurimit më të epërm të qenies sonë, aty ku e ka vatrën e vet kategoria estetike e të madhërishtes, e erosit apo emocionit të bukur të dashurisë. Ndërkaq, në jetën e përditshme, i pari kontakt që e përjetojmë, janë shikimet ballë për ballë. I lexojmë sytë e njeriut të shqetësuar që bredhin sa andej-kënde, pa një përqendrim. Apo shikimin e turpshëm, ku tjetri nuk dëshiron “të na zhgënjejë”. Sytë dëftojnë dëshpërimin, lodhjen, gjallërinë...sikletin apo mërzinë, mungesën e interesimit apo kureshtjen. Shikimi i dikujt është ftohtë, i tjetrit është i zemëruar...

Mirëpo, ky sy heshtjeje është aq miqësor e meditativ, sa sikur na duket se po na merr përdore atyre thellësive. Ekziston, pra, edhe shikimi, që tregon njeriun e hapur, njeriun miqësor, dhe pikërisht të tjerët e vlerësojnë këtë virtut të miqësisë...

3. Heshtja, rezonancat e referencave kuptimore

Muza e heshtjes bredh nëpër paste vuajtjesh, nëpër hovet shekspiriane të mesazheve lirike (“kur pikëllimi e mbulon si re e dendur / e mëdyshja i shtrinë rrënjët, helmim shllige”), është ajo besëlidhja krijuese me aktin estetik si akt i heshtur shpëtimi me Fjalën, kundruall kaq kontrastimeve në jetë:

*Heshtja është fryma e bukurisë,
hir i amëzimit të pafund të etjes,
ngrohtësi e ujëvartë që e mbroth shpirtin
të dallgëzuar nga e liga, nga shëmtia [...] është frymësi jetike, mishërim i mistershëm
i të madhërishtes, ngadhënjim mbi kohët,
që kudo ndodhet rrezaton tek ti e unë*

Pothuajse, secila pjesë bart një strukturë të caktuar tekstore mesazhesh, vrojtimesh, thëniesh meditative. Shtrirja e kësaj heshtjeje në hapësirën makrokozmiqe, vjen sikur një ilaç për shpirtin, për ta zbutur atë në thellësitë e tij. Është ai kërkimi shërues i paqes së brendshme e të thellë; ajo situatë e

posaçme e kësaj brendie heshtake, ku njeriu merr e jep, ku qenia njerëzore vepron në një tjetër rrafsh, në atë të qetësisë absolute, të ndryshëm nga qenësia dhe vetëdija e së përditshmes, sikundër këto na i jep poeti të sintetizuara te pjesa e pestë:

*Heshtja është paqja brenda nesh
shkëlqim i çiltër që duhet mbëltuar,
edhe në djepin e shtrëngatës së egër
ose kur deti tundet nga tallaze të trishtë
që stuhia pa mëshirë i përplas
thuajse duan ta përpijë njëri – tjetrin;
është bardhësia që e mban ndezur
qiriun e prehjes dhe të qetësisë,
të rrahurit e zemrës, njomësinë e shpirtit
për diçka më të vlerët, më njerëzore,
se paqja jonë i takon dhe tjetrit
dhe e ngjall dashurinë e ndërsjellë–
e cila fuqishëm lartësohet e ngadhënjën
mbi të papriturën, mbi çdo ligësi.*

Folësi lirik i përsiatjeve, pothuajse, shndërrohet në një qenie magjike, siç do të thoshte shkrimtari Karlos Kastaneda: “Qetësia e brendshme e heshtjes, si gjithçka tjetër në botën e qenieve magjike, zbulohet kur ndodh diçka e jashtëzakonshme dhe e rëndësishme, diçka që na trondit.”⁹

Ka një grishje zërash të vazhdueshëm, të brendshëm, që folësi lirik i shqipton nëpërmes përjetimeve, ku folësi ligjëron nga një distancë objektive e vetes së tretë, për t’u njëjtësuar me Tjetrin (“paqja jonë i takon dhe tjetrit./ dhe e ngjall dashurinë e ndërsjellë”).

Kompleksiteti i këtyre ligjërimeve, ndjek një rrugë unike këndimi e përsiatjesh, nëpër tërthore e pesha të rënda; është ajo ndërlikueshmëria e jetës sonë brenda nesh, brenda kulturës sonë të shpirtit, aty ku gjëllin lufta e vështirë për ta ndërtuar një vetëdije njerëzore e shoqërore, aq e shkaktuar nga situatat postmoderne të

⁹ Carlos Castaneda, *Put u Ixtlan: pouke don Juana*, prevela Marina Horkić, Zagreb : V.B.Z., 1997, f. 318.

ndryshimeve; ku nuk maten fjalët, as nuk peshohen mendimet, ku e keqja kanoset vazhdimisht (pjesa e 11-të):

Heshtje është vetëpërmbajtja [...] është vatra ku gjen burimin e fuqisë, e ngadhënjimit edhe mbi vetveten edhe kur në ty rëndon pikëllimi, më i rëndë se pesha e Pashtrikut tonë, ose vuajtjet palë – palë rriten brenda teje si shtresat e borës në Bjeshkët e Nemuna që nuk shkrihen as në vapën e gushtit.

E çka dhe si duhet heshtur, aty ku plagët ende nuk shërohen, kur ato mbesin të shushatura, të fshehura; a nuk qenka, në këso çastesh, një pëlçitje e brendshme mes pëlqimit a mospajtimit, mu si në ato situatat shekspiriane (“Heshtja është veprimi hamletian, / shushunjë që nuk shkoqet nga lëkura, nga mishi”), është sfida e hedhur e dikotomisë së sflitjeve të brendshme dhe dilemave, e shtypjes së fjalës së pathënë, të shtypur egërsisht nga rrethana të jashtme (pjesët 21 dhe 22), është diçka më shumë se mungesë e fjalës së shqiptuar (Heshtja është të folurit pa zë” pjesa e 3-të), në paradoksin e saj kur ajo thyhet, mes ngurrimeve dhe mësymjeve, për të qenë ose jo vetvetja:

Heshtja është krymbi i dyshimit që të vë në peshojën e ndërgjegjes: të mbesësh ai që je e duhet të jesh apo të luash hijen e vetes sate; të fundosesh në rrjetën e mëdyshjeve që i japin jetë plimit të vegimeve

e mandej ajo e rimerr vetveten, me tone shpirtërore, mu si qenia njerëzore. Ka dhe ajo retorikën e saj (në të mosfolurit karshi tjetrit a mes pauzash të të folurit), ka dhe ritin e saj spiritual, ka rezonancat e referencave kuptimore, paska dhe fuqinë a dobësinë e saj! Ka dhe aso situatash, kur hierarkia ideologjike përdor heshtjen si mjet shtypës:

*për pasojat që e kanë tronditur tokën,
qiellin
që të shpojnë në ndërgjegje, të zhbëjnë
ose të japin kurajë të mësosh nga pësimet
e të ecësh më tej e jetën ta gëzosh.*

(kujto heshtjen e qëllimshme të veprave të Fishtës etj. në kohët e diktaturave shqiptaro-jugosllave; kujto dhe heshtjet e dhunshme të intelektualit karshi diktatit të dhunshëm politik).

Ka, pra, shumë tipa heshtjesh! Është dhe shtegu për të vënë dialog me Tjetrin, për ta kapërcyer situatën e dhunës. Luce Irigaray thotë: “Duke u takuar me Tjetrin, ne duhet të flasim me njëri-tjetrin dhe ky është kapaciteti ynë ose pranimi i heshtjes... Heshtja është fjala, ose fjala e pragut - një hapësirë prej takimit të mundshëm, për mikpritjen e mundshme me njëri-tjetrin... nuk mund ta kuptojmë heshtjen pa e kuptuar fjalën e shqiptuar në proceset e komunikimit.”¹⁰

Fjala, heshtja, urtia - një trinom vlerash supreme, që e gjejnë dinjitetshëm shqiptimin e tyre në poezi, përmes një PORTRETI KOLEKTIV të urtakëve, qendrestarëve, njerëzve të fjalës...

Ka heshtje të shenjtë në tempujt fetarë, aty ku njerëzit luten në heshtje. “Kohët e heshtjes janë kohë me dhe për Perëndinë. Kështu që dikush vjen në Perëndinë, ndjen diçka nga heshtja e përjetësisë.” (Afschin Kamrani). Ka një heshtje edhe aktive.

Edhe fjala, edhe heshtja, i kanë kohët e veta, kur duhet të përdoren.

Mirëpo, fjala, të folurit dhe shkrimi komunikojnë me heshtjen. Me heshtjen aktive, mu si është një akt i tillë edhe shkrimi i përsiatjeve poetike. Një dijetar thotë se Fjala është fuqia e parë në botë, kurse Heshtja është Fuqia e dytë.

Në heshtje njeriu është vetvetja: me ngazëllimet, me qetësinë shpirtërore a me përjetimet dhe pësimet.


“Mos lejoni që të përdoreni si një mjet i thyeshhtë, mos u bëni skllav i mendimeve dhe i modës. Merrni pak heshtje për hir të shpirtit tuaj. Zhurma nuk sjell të mira, e mira nuk bën zhurmë”, thotë Papa Gjon Pali I. Dhe, në thellësitë e heshtjes, folësi lirik i përsiatjeve zhytet i tëri, për ta rizbuluar shpirtin e vet. Komunikimi me kohën nuk është i lehtë... sepse dalin detyrime të forta shpirti, mendjeje, krijimi, etike e estetike... dhe kërkohen fuqi të pashtershme reflektimi, lutjeje e krijimi.

4. Trajtat e diskursit lirik dhe të përvojave krijuese

Në këtë mënyrë, edhe trajtat e diskursit lirik vijnë të nduarnduarta: aty lexojmë heshtjen e shenjtë, ashtu sikundër e përjetojmë dhe reflektojmë për përsiatjet dhe mendimet poetike mbi heshtjen; e ndiejmë atë ritëm të heshtjes së Nënës Tereze që i shqiptonte luajtjet në heshtjen hyjnore, ashtu sikundër ligjërimi i tillë na vjen si zgjim shpirtëror, ku burojnë energjitë dhe forca e brendshme; heshtja është dhe lutje, besim, paqe, dashuri, shërbim... me një të folur tjetërfare. Ligjërimi poetik e zëvendëson heshtjen, vijnë në gërshtet me njëra-tjetrën përvojat ligjërimore autoriale, me ato të jetës dhe të përsiatjeve. Është bota e bukur e vetmisë krijuese, aty ku te mediumi poetik pikëtakohen e shikohen vetvetja dhe bota përreth. Sy më sy pikëtakohen etika dhe estetika e këtij shpirti njerëzor.

Me një fjalë, ku takohen Fjala dhe Heshtja që i dhurojnë e marrin diçka njëra-tjetrës, siç ndodh në veprën “Sytë e heshtjes” të Anton Nikë Berishën.

Maj 2019



¹⁰ Luce Irigaray, *How Can We Meet the Other?’, Otherness. A Multilateral, Perspective*, eds. Maria Beville, et al. Oxford: Peter Lang, 2011, f. 114. Libër elektronik.

Një mbrëmje, në librarinë Ancora të Malagës, shkrimtari shqiptar Namik Dokle, po më tregonte se ekziston një fshat, fshehur mes mjegullës, ku lindin burra që thinjen qysh në fëmijëri dhe që shikojnë natën më mirë se ditën. Burra që nuk i lind nëna “nga barku”, por i lind mjegulla e Kallabakut. Në ato livadhe e bjeshkë të larta, ku kullosin delet, më thotë dhe na thotë të gjithëve që ishim në prezantimin e romanit të tij, jetojnë bijtë dhe bijat e mjegullës.

“Qëkur lindin dhe deri sa vdesin, janë fëmijë të mjegullës. Në pelena mjegulle i mbështjellin, kur lindin dhe në qefin mjegulle i fusin kur i përcjellin përtej Kodrës, për në varreza. Dhe e gjithë jeta mjegull u shkon nëpër botë, i rrëmbejnë ku të munden erërat e vjeshtës, përqafohen me shkëmbinjë në grykat e lumenjve, hanë bukë me natën dhe grinden me ditën...E vrasin shumë mendjen për këtë botë dhe për atë botë...”



“Vajzat e mjegullës” - një roman i shkëlqyer

Nga **ALFREDO VILLASVERDE GIL**, shkrimtar, kryetar i Shoqatës së shkrimtarëve të Kastija La Mançës-Spanjë

Letërsia shqipe, pak e njohur në Spanjë, u gjallërua në shekullin e XIX, si rezultat i Lringjalljes së frymës kombëtare dhe një nga qendrat e para letrare e pati në Shkodër. Në fillimet e shekullit të XX intensifikohet përhapja dhe studimi i gjuhës me ndihmën edhe të komuniteteve shqiptare të vendosura në Greqi, Turqi, Itali dhe Bullgari. Ky fragmentarizim mes autorëve që jetonin brenda vendit dhe të tjerëve në emigracion, vazhdoi deri në fund të Luftës së Dytë Botërore, pas së cilës, shumica e autorëve shqiptarë ndoqën rrugën e realizmit socialist. Aktualisht, midis të gjithëve, shquhet, me një ndriçim vetiak, Ismail Kadare, vepra e të cilit është e njohur botërisht. Mund të përmendim emra të tjerë shkrimtarësh të njohur si Petro Marko, Spiro Çomora, Dritëro Agolli, Ernest Koliqi, Martin Camaj etj.

Tanimë janë bërë të njohur edhe Ridvan Dibra, Ben Blushi, poetesha Luljeta Lleshanaku, të cilëve u bashkoj edhe figurën e Namik Dokles, hispanist i shquar, i cili, përmes karrierës së tij shumëplanshe si shtetar (kryetar parlamenti, zëvendëskryeministër), gazetar i mediave të njohura, përkthyes nga spanjishtja, por mbi të gjitha, si romancier i madh dhe dramaturg, zë një vend të privilegjuar mes nesh, duke e njohur veprën e tij në spanjisht, nëpërmjet përkthimit të kujdesshëm që Maria Rocés Gonzales i ka bërë romanit “Vajzat e mjegullës” - pjesa e parë e triologjisë së Gorës.

Gora, vendi i narrativës së autorit, është një tokë e ndarë mes tre kufijve shtetërorë, në vitet pesëdhjetë të shekullit të kaluar; Shqipëri, Maqedoni, Serbi (tashmë në kufi me Kosovën) në të cilën, nëpërmjet rrëfimit të një fëmije 13 vjeçar, me dhunti mençurie, vëzhgimi dhe guximi, na përshfaqet një afresk i historisë së një Shqipërie të zhytur në një regjim stalinist, të drejtuar nga Enver Hoxha. Nëpërmjet vështirimit dhe epopesë personale të një djali, para syve tanë shfaqen personazhe dhe rrëfimtari të tjerë si Majka, referencë magjike e pakohëshme e një plake që na tregon historinë qindra vjeçare të zakoneve dhe traditave të një krahine, ku dielli lind dy herë çdo ditë dhe hëna shfaqet dy herë çdo natë, në Bukojnën e kufirit, të hedhur mes bjeshkëve dhe mjegullës, përmes të cilave enden goranët, me torbë në krahë, si migrantë të përjetëshëm, në kërkim të një jete më të mirë e të lumtur

Në këtë suazë të një vendi të varfëruar e pa mundësi jetese, personazhe të tjerë përbëjnë contrapuntin e rrëfimit. Shquan figura e Mësuesit, referues intelektual i historisë së Gorës në roman, njëherësh edhe mbrojtës i vlerave dhe të vërtetës, për të cilat, më në fund shkon drejt pushkatimit. Figura e tij përballet me parimet e rendit të ri, të vendosura mbi dogmat e Stalinit, mentor i qeveritarëve të rinj, të cilët, nëpërmjet komiteteve të tyre partiake, të bodrumeve të errëta e torturuese, të shkeljeve mbi pronat e komunitetit, e zhytin fshatin në terror e shkatërrim.

Vajzat e mjegullës janë adoleshentet e Bukojnës që i japin gëzim jetës me këngët e tyre, çdo mbrëmje, përpara të shtatë portave të fshatit, duke hedhur kështu farën e të ardhmes ndryshe, me takimet e tyre me djemtë që frymojnë për to dhe ëndërrojnë dashurinë në ditët e festës së Shëngjergjit. Rrëmbimi i të gjitha vajzave nga regjimi stalinist, ndalimi i tyre për të ardhur në ditët e festës, për arsye absurde, vjen e bëhet nyja qendrore e romanit. Rreth kësaj ngjarjeje, prezantohen dhe zhvillohen personazhe dhe rrëfime që na përshfaqin pjesë të historisë, traditave dhe mënyrës së jetesës të asaj Shqipërie që jetoi në errësirën represive deri në fundin e shekullit të kaluar dhe, tani, rilind e ndriçuar dhe tërheqëse përpara botës me gjithë forcën shpirtërore dhe dëshirën e saj për t'u integruar në Europë, si anëtare e një globaliteti të nevojshëm, por që nuk harron vlerat autentike, aq shumë të gdhendura në historinë dhe kulturën e saj. Romani i Namik Dokles është një portë e madhe hyrëse për njohjen e një vendi që shfaqet mikpritës dhe i dëshiruar që ta njohim më mirë historinë dhe trashëgiminë e tij. Dhe kësaj i kotribuon, pa dyshim, leximi i këtij romani të shkëlqyer, të cilin ua rekomandojmë me entuziazëm dhe admirim.

Shënim: Artikulli është botuar në revistën “El curioso impertinente”, organ i Shoqatës së shkrimtarëve të Kastija La Mançës- Spanjë.

NJË MBRËMJE ME SHKRIMTARIN NAMIK DOKLE

Nga PEDRO DELGADO FERNANDEZ, shkrimtar

Është fshati Bukojna, i përket krahinës së Gorës, ku flitet “gorançe”, ose, siç thonë atje, “nashke”, që në të folmen e tyre do të thotë “gjuha jonë”. Gora shtrihet në të dy anët e kufirit të vjetër shqiptaro-jugosllav, por që edhe sot është e ndarë në tre shtete:

Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni. Dhe, për më tepër, e llogarisin si të tyren edhe serbët e bullgarët. E kësaj pyetjeje, vetë ata i përgjigjen thjeshtë dhe spontanisht: “jemi tanët”, “jemi goranë”.

“Në kufi, në drejtim të Shqipërisë, si në një lloj bedeni midis dy shteteve, në 18 fshatra të vetmuar të Malësisë së Sharrit, jetojnë goranët, për të cilët pretendojnë katër kombe dhe një kombësi, e ata nuk dinë të kujt janë dhe jetojnë në mjegull dhe varfëri të madhe, si jetimë. E vendosur në një luginë dhe si e turpshme, posta kufitare fshihet nga degët e rralla të pemëve. Si shenjë që në të ka ushtarë, është tymi i hollë që ngrihet mbi çatinë e ulët. Në anën shqiptare, gjatë gjithë gjerësisë së luginës së ngushtë, ngjitur me kufirin, gjarpëron një brez i gjërë toke, i spastruar nga pemët, madje edhe nga bari. Në të është punuar çdo pëllëmbë tokë dhe ushtari nga pika kufitare mund të shohë nga larg edhe miun e arës, kur kalon me shpejtësi në shtetin fqinj.

Lart, në mjegull, në një lirishtë të bukur, me germa të mëdha prej guri, është shkruar: “Parti- Enver”. Ndërsa në fshatin Orçushë, në anën tjetër të kufirit, me tuba të mëdha hekuri, me germa të shndritshme shkruhet “Tito”. Enver andej, Tito kënde, mjegulla në mes...Të dy fshatrat përbëhen nga shtëpi të vetmuara, një pjesë zhgadhina të mbuluara me rrasa guri. Kur vdes dikush këtu, askush nuk pyet nga se vdiq, por, o Zot, me çfarë ka jetuar?”

Romani fillon me një arushë të vrarë, të vendosur mbi një farë skelerie të bërë me listela, në qendër të fshatit. Arushën e shkretë e kanë vrarë ushtarët, tre ditë më parë, vetëm pse kaloi kufirin mes dy shteteve. (Në fund të romanit, te ajo skeleri do të pushkatohet Mësuesi- poet, njeri nga personazhet kryesor të librit) Dhe piskama e arushave të vogla, të mbetura pa nënë, e ndajnë natën mëdys. Shumë nga banorët mendojnë se vdekja e arushës do të sjellë fatkeqësi të tjera për Bukojnën. Dhe të nesërmen, kur protagonist i romanit, një djalë 13 vjeçar, shkon në mulli për të bluar tërshërë për bukë (“me këtë miell do të hingëllini të gjithë”, i thotë mullixhiu), dëgjon për herë të parë një fjalë të çuditshme: aksion. Madje, “aksioni do të marrë Vajzat e fshatit tuaj...”

NAMIK DOKLE

Las hijas de la niebla



Padre e hijas en Obs, en el valle de Shala, Giuseppe Massini (1940)

TRADUCCIÓN: María Rocés González
TÍTULO ORIGINAL: *Vajzat e mjegullës* (2015)
EDITADO POR: 23idulius Reims Editorial y Botimier Toena
ISBN: 978-84-125482-0-4
D.L.: AL. 3196-2022
THEMA: FBA



“Çfarë është ky aksioni vallë? Nuk e kisha dëgjuar kurrë atë fjalë. Të jetë ndonjë burrë që do të martohet me to? A mos është ndonjë stuhi e egër vetëm për Vajzat tona? Apo është ndonjë sëmundje e keqe si tifoja e morrit, që do të zerë vetëm ato dhe në fshatra të tjerë nuk do të përhapet?” Mushka ecte ngadalë në të përpjetën e madhe dhe unë mezi prisja të arrija në fshat për të pyetur për këtë aksion që do të merrte Vajzat tona.”

“Aksioni” ishte një lloj fushate ose mobilizimi, gjoja vullnetar, i të rinjve, punëtorëve, intelektualëve etj. për të realizuar punë të ndryshme, apo për të ndërtuar vepra publike, për interesa shtetërore apo rajonale. Dhe vendimet për këto lloj aksionesh dhe punësh të pa paguara i merrte organizata e Partisë së Punës (komuniste) “Vetëm atë ditë, kujton rrëfimtari i vogël i romanit, kuptova përse njerëzit, të hutuar apo të frikësuar, thoshin: “Më thirrën në organizatë”, “Vendosi organizata”, “organizata do të ndajë racionin e drithit”, “e dënuan në organizatë”.

Dhe nis prej këtej e shpërhapet narrativa, vargëzojnë ngjarjet e romanit, me një tonalitë balladash që më kujton shumë tregime popullore lindore, me faqe që sikur burojnë nga folklori dhe tradita gojore ballkanike dhe të cilat na bëjnë të ecim dhe të qëndrojmë të menduar në këtë rrëfim. Por, vini re, nën këtë dukje të fabulës, ajo çfarë na tregon Namik Dokle është diçka krejt reale.

“Kisha arritur te sheshi i vogël i çezmës. Arusha e vrarë ishte ende aty, askush nuk e kishte më mendjen tek ajo. Edhe mua më dukej se një arushë tjetër, e gjallë dhe hijerëndë, po hidhte putrat e saj mbi fshat. Vetëm uji i çezmës vazhdonte të rridhte më të njëjtën shushurimë, si qindra vjet më parë, kur tri gra e gjetën aty dhe lagën buzët e rreshkura.”

Dhe më pas, autori na hedhe në krahët e një legjende, të legjendës ekzistenciale të Gorës...Kur tri gratë u ngjiten në pyjet dhe brinjat që të kërkonin ujin, për herë të parë në jetën e tyre panë malet dhe bjeshkët që rrethonin fshatin e tyre e që, nga ajo gropë buzë lumit ku i kishin shtëpitë, nuk dukeshin.

“Paska edhe një botë tjetër”, tha njera prej tyre.

“Të ngulemi këtu, të paktën të shohim me sy këtë botë”, tha tjetra.

“Dhe paska shumë gurë”, tha e treta. Atëherë u ra ndërmend legjenda që tregohej për Gorën dhe Goranin që nga kohët kur gjyshstërgjyshit e tyre ende nuk kishin lindur. Thuhej se kur erdhi lajmi që Zoti do të mblidhte gjithë krahinat për të ndarë të mirat që kishte, u nis edhe gorani, udhëtoi nëntë ditë e netë pa ndaluar, derisa mbërriti te Shtëpia e Zotit. Por e gjeti sofrën të ngritur.

“Nga vjen?”, e pyeti Zoti.

“Nga fundi i botës”, i tha ai.

“Erdhe vonë, unë i ndava të gjitha të mirat që kisha.”

“O Zot, unë bëra nëntë ditë e nëntë net rrugë deri tek oborri yt, mos më kthe duarbosh.” Zoti hodhi sytë nëpër oborr, mori një gur dhe ia dha. “Këtë kam dhe po ta jap me gjithë zemër, ndoshta ju pak gjëra do të keni në jetë, por gurët e maleve tuaja do t'i doni shumë.”

“Eh, psherëtiu njera nga tri gratë, nuk na la të donim ndonjë gjë tjetër...”

Këtë legjendë të stërlashtë të takimit të Zotit me goranin, na e tregoi Namik Dokle, në prezantimin e librit të tij në Malaga, në shoqërinë e botuesit Antonio Ruiz, të Vicente Fernandez, profesorit të greqishtes moderne në Universitetin e Malagës, përkthyes i shquar në spanjisht i veprave emblematike të letërsisë greke dhe në praninë e Maria Roces Gonzales, përkthyesja e romanit të Dokles, e cila, sigurisht, pas vdekjes së Ramon Sanchez Lizarralde, është përkthyesja e vetme nga shqipja në spanjisht. Unë e kam shetitur Shqipërinë në vitin 2017, me çantën plot libra të Ismail Kadaresë, të përkthyer nga Ramon Sanchez (Gjenerali I ushtrisë së vdekur, Prilli i thyer, Kronikë në gur, Tre këngë zie për Kosovën etj.) Prandaj dëgjoj me shumë interes gjithçka që tregohet për ato vende: Tirana, Shkodra, Kukësi, Durrësi, Prizreni, Peshkopia, Korabi...

Namik Dokle, që banon në Tiranë, na tregon se ka lindur në qytetin bregdetar të Durrësit, krejt rastësisht, por shumë shpejt prindërit e tij u kthyen në vendlindje, në Gorë, ku ai kaloi gjithë fëmijërinë e tij. Që i vogël ka dëgjuar nga goja e familjarëve dhe banorëve të tjerë legjenda dhe histori që kanë mbetur të pashlyera. Ai na shpjegon se filloi ta shkruante këtë roman para shumë vitesh, qëkur ishte gazetar. Megjithatë iu desh ta ndërpriste pas rënies së komunizmit dhe përfshirjes së tij në politikë. Nuk e di nëse Majka magjike e romanit, që kishte dyqind apo treqind vjet në këtë botë dhe të cilën vdekja e kishte harruar, është ajo që nuk doli kurrë nga mendimet e tij dhe i kërkoi ngulshëm që t'i rikthehej asaj bote të ashpër dhe të rrezikuar, por të mbushur me dinjitet, veç është e sigurt që një ditë prej ditësh, Namik Dokle vendosi të braktisë dafinat e politikës dhe të rimarrë dorëshkrimin e dikurshëm, për të na dhënë “Vajzat e mjegullës”, që realisht është romani i parë i triologjisë për Gorën, pas të cilit erdhën edhe dy të tjerë: “Lulet e skajbotës” dhe “Ditët e lakuriqëve të natës”.

Në romanin e parë Dokle ka një ndërthurje të pushtetit të natyrës, të traditave dhe gjuhës, me jetën dhe rezistencën shpirtërore të një galerie të pasur personazhesh: Majka, Murseli i Orgostës, Mësuesi nga Shkodra, Salko flokëkuqi (i vetëquajturi Stalini i fshatit), tellallët Craple dhe Çinarçe, Olloman Amerika, i cili kurrë nuk ka qenë në Amerikë, por mban një kapele të modës së Al Kapones dhe kur i kërkojnë llogari, përgjigjet “çfarë llogarie; unë kam vetëm bajga”, shtatë Vajzat e Shundit të parë, çifuti Isak, Gjek Gjeloshi i Malësisë që vrau për nder, kaçaku i Kolloshtrezës pa të drejtë tymi, mulla Isufi, njeriu me më shumë libra në fshat, Sinan Pasha me mallkimin e tij, Nefka, të cilës ia kishin harruar emrin dhe të gjithë, edhe i shoqi, e thërrisnin “Ajo”, dervishi i Kolshit, mbreti Zog në ekzil, rreshter Hatja, më i frikshmi në fshat, Anadollja e ardhur nga Turqia, që tregon përrallat e Shehrezades, Ajnurka që urren magjitë dhe shumë personazhe të tjerë që presin vetëm një dritë: kthimin e vajzave të mjegullës nga aksioni për të festuar Shëngjergjin. Por mbi të gjithë ata, mbi fatet e tyre, mbi varfërinë dhe braktisjen, qëndron hija e rëndë e diktaturës së Enver Hoxhës që iu imponua gjithë vendit me dorë të hekurt.

Sapo u ktheva në shtëpi, pas prezantimit të romanit, fillova menjëherë ta lexoj dhe që në faqet e para zbuloj që brenda tij kemi një film. Dhe kur e mbaroj së lexuari, imagjinoj se do të ishte diçka si ajo që tregohet në imazhet e filmave të realizuar nga një Tarkovski apo një Parajanov.

Boshllëkun e shumë viteve midis shokësh studentë, poeti Ruzhdi Gole, e pa të udhës ta mbushte me dy librat e tij poetikë: “Mërzi me Këpucë Letre” dhe “Skulpturë Ujore”. Tituj të çuditshëm, rreth 450 faqe mbushur me metafora kapriçioze, që të kujtojnë kërcimet e peshqëve në det. E kishim lënë të takoheshim, ku do t`më dhuronte edhe librat në fjalë, por, meqë kthimi im po zgjste, m`i nisi në inbox. S`kish si të ndodhte ndryshe: padurim poetësh. (Librat më së shumti dhurohen se sa shiten.) S`je mik, nëse më sheh nga të metat, thotë një i urtë, duke më kujtuar një pasazh nga romani “Doni i qetë” i Shollohovit. (Në eset e mija unë udhëhiqem nga ky parim. Ndërsa, Shën Pjetrin me kamzhik, e lë në raste polemikash.) T`i kthehem episodit. I ati i Grigor Melehovit, për të larguar të birin nga Akcinja problematike, i gjen për nuse bukuroshen Natalia. Grigori, krejt i befasuar nga zgjedhja e të atit, nuk po ia ndante sytë së resë, duke e gjesdisur vështrimin sa nga trupi, tiparet, ndërkohë i shqetësuar se mos po rrëmbehej nga bukuria e saj dhe do e humbiste Akcinjën. Për fat, syri i dalloi një nishan. U kap aty, duke e amplifikuar me vete si e si ta kthente nishanin në një njollë pakënaqësie. Në këtë lojë ndodh të përfshihen shpesh dashakqinjtë, ku tek nishani shohin njollën. Nga mënyra se si reagojmë shpesh vëmë në provë dhe karakterin. Shpesh, në libra dhe autorë marr indicje frymëzuese për të artikuluar mesazhe, për të vënë në dukje rrezatime poetike apo kumte, që ia vlen të bëhen publike. Më pëlqen të zgjojë gjëra të fjetura se sa të vë në gjumë mediokritete. (Ngaqë rrobat i dilnin shpejt nga qejfi, ajo i dhuronte, por, kur i shihte ato veshur tek dikush tjetër që i shkonte, pendohej që ia kishte falur.) Të njëjtën pardsy kishte dhe shefja me Marianën, por nga që vajzës i shkonte, e mjaftueshme ta urrente, duke e luftuar në emër të parimeve. Kujtoni novelën e Kadaresë “Natë me hënë”.


Nëse Ruzhdi Gole do t`i gjeja një poet të ngjashëm, padyshim që ky do të ishte: Moikom Zeqo, i cili i bën cirk metaforës, njëherësh duke u ankuar prej tyre: “Dhe metaforat i kam/Shpesh dezertorë/Të kuptimeve universale,/Të vërteta!” Kur merr përsipër të gjykos poet “Të kuptimeve universale”, rruga për tek e vërteta të duket, sikur nuk do ta shkelësh kurrë. Në këtë dilemë është dhe Hiqmet Meçaj, i cili shoqëron librin e R. Gole me një parathënie nga më interesantet, që kam lexuar: “Poeti nuk na bën të udhëtojmë, ai vetë udhëton atje ku do, tek një realitet tjetër që e ndjen vetëm ai në një çast të papërsëritshëm krijues. Pra, ai ndodhet në realitetin e tij, kurse ne themi se ka krijuar një realitet tjetër të ndryshëm nga yni. Të gjithë këtë e krijon me gjuhën e vet poetike, me semantikën dhe semiotikën e vet. Nëse na tërheq ta ndjekim në këtë udhëtim, është poeti ynë i dëshiruar, në të kundërt e lëmë të udhëtojmë në vetminë e tij.”-Shkruan bregdetari nga Vlora për sivëllaun e tij nga Durrësi, duke lënë një hije dyshimi: mos Ruzhdiu i është futur detit në këmbë? E lexova me kujdes parathënien për të kuptuar: poeti Meçaj e ka Golen poet të dëshiruar apo e lë të udhëtojë në vetminë e tij? E gjitha kjo dilemë nuk është gjë tjetër, veçse drama e poetit Ruzhdi Gole në raport me lexuesin, të cilën ai pranon ta vuaj këtë mëdyshje, pa u tërhequr nga e tija. E ka ndarë mendjen me kohë, të tjerët si ta kenë qejfin. Nuk mund të mos tërhiqesha nga kjo sfidë. “Pas kuptimit parësor të fjalëve, fsheh dhe na fton të zbulojmë kuptimet e tjera, që mund të jenë edhe më të rëndësishme se ato parësore, por ka edhe semiotikën e saj, gjuhën e simboleve, të cilët krijohen nga poeti në çastin kur shkruan poezinë dhe që nuk kemi rënë njëmendje më parë t`i pranojmë ose jo. Gole “nuk shqetësohet fare” në komunikon a jo me lexuesin e vet. Me një individualitet të spikatur vetjak Gole udhëton atje ku do, tek një realitet tjetër, që e ndjen vetëm ai e mundohet të krijojë një model tjetër. Në udhëtimin e tij, mëse të

Vëllimet “Mërzi me Këpucë Letre” dhe “Skulpturë Ujore” të poetit Ruzhdi Gole

Poeti na fton të udhëtojmë pa qenë udhërrëfyes i poezive

Nga Fatbardh Amursi

veçantë, do të ketë lexues që do ta ndjekin.”-e përmbyll Hiqmet Meçaj vlerësimin e tij, duke pranuar “individualitetin e spikatur të Gole”, njëherësh duke besuar se në udhëtimin e tij do të ketë lexues, që do ta ndjekin. (Që lexuesi të të vihet pas, nuk është vetëm problem i R. Gole, por, edhe i Dantes.) Me sa duket llogaritë nuk bëhen me lexuesin e sotëm, por, me lexuesin e së nesërmes. “Sintaksa e saj, sot, janë andrrallat, hutimi, tortura, jetimët, rrjollat./ Gjys` morfologji banderolat puliten-copëza gazi, guaku./Ligjëratave: stema republike, helika grindjesh zënë-memece gjaku./ Trualli-leksik i cunguar jetimi, sot po digjet turfullima, tortura.../Fonetika: gulçe dhe krisje, ankth dhe amëz për ca Arte?” Sikurse shihet si: sintaksa, morfologjia, fonetika, leksiku, ligjeratat krijojnë atë “realitetin tjetër” të autorit, ku ai ecën në rrugën e tij, duke na ftuar në udhëtimin poetik, që, del nga e zakonshmja e frazave, perceptimeve, sinjalistikës figurative. Autori, edhe qortimet i ka të lodhura, përderisa: vetmia është lodhja e tij, duke mos i duruar pozantët, të cilët: “Hamë një darkë të qelbur me borxhe e brumbuj duke mburrur veten se veç ne jemi alter ego.” (Ka prej tyre që i bjen daullës dhe kujtojnë se po luajnë muzikë xhaz.) Mërzinë e krahason “me një këmishë dal` tejboje/ dinake bukur, qendistare e furishme”, ku: “Uria, përlan duart e veta.” Por, nuk dorëzohet, përkundër profetëve që mbyllen në shpellë: “Nesër, vetëm, do të shkoj në Himalaje, vetëm. ../Sot, jetoj në Himalajë, n`Atdheun tim, fillikat ... me të tjerë...”, edhe pse “Frika rritej tek Frika”. Edhe pse lodhja dhe vetmia përmenden shpesh, shfaq energjitë e një eksploruesi, gjithnjë brenda vetes. (Një mbret i Spanjës, zhvilloi flotën e vendit të tij, edhe pse nuk hipi njëherë në një anije.) “Vreshta u lodh s`lodhuri,/ amëlt pikoi helmëza helm,/shtriqi gjunjtë kjo drenushe e shumë parafytyrimeve,/më shumë e dremitjeve.”, me sa duket nuk e lodh prodhimi, por ata që hedhin gurë në pemën



me kokërra, ata që helmojnë gëzimin e tjetrit, se: “Ndonjëherë, e pabesë dhe besa.” Vetëm: “Ujrat nuk ngrejne kurthe”. Poeti nuk është nga ata që vegjeton, edhe pse lë përshtypjen e njeriut në prehje. “Gjithë varkat asnjëherë s`hoqën dorë nga moli./as rrjetat për të zënë aty ndonjë peshk të pangrir`./ as mesnata për të zënë brekë e guacka, xixëllonja e brirë kaprolli.” Shkencëtarët thonë se poshtë sipërfaqeve të ngrira të detit të veriut, poleve, ka specie, gjallesa, më shumë se kudo gjetkë. “Bota, mendohet më gjatë,/ më shumë sesa shprehet,/ më shumë shprehet se mban mend të larat,/ të palarat, të përllarat, pëgërë noj`shkamb.” Pëgërja, ndotja e ambientit me sa duket del fillimisht nga shpirti dhe më pas ndot natyrën. “Njeriu dhe bisha darkojnë së bashku:/Njeriu bishës ia ka rrjepur lëkurën,/ bisha njeriun e ka lanë zathur./Thundrat e njeri-tjetrit shkelin,/ theqafin zekthin dhe zverkun.” Dhe të gjitha këto ndodhin, ngaqë: “Dashnia ankon për arnat, arnimet e trupit”, apo: “Dashuritë me faje, me gjyqe, bubureza kryqesh,/Bronket e trotuareve, prej sheqerit e prej helmit të tepërt japin shpirt.” Vargje të natyrës meditative, që dalin nga parzmozja e heshtjes, duke u kthyer tek shqetësimet e natyrës sociale: “Në tokë me kë të rrih të flasësh./ku të prehesh./ ku ta pëlçasësh,/ ku ta gremisësh syrin e keq?/Thellë, në det, sot peshkaqenët sillen më butë se njerëzit.” Dhe shpëtimi duhet kërkuar tek: “Dashuria erdhi shpejt nga tallazitja e mbrëmjes,/kur zemërimi u ul në gjunjë,/u mpak thellë e u përtha,/t`u lexue gjithçka, tek ajo nga përroi i saj dhe pylli.” Zemërimi ulet në gjunjë vetëm nga dashuria, si i vetmi air-beg, kur, më së shumti preferohet kacegu i Eolit, perëndisë që i mbante erërat të ndryra në kacek, i cili shpërthen në rastin më të parë, ngaqë u duket vetja Poseidon. Shikimi, njerin sy e mban mbyllur, vetëm kur i ka parë të gjitha, shkruan poeti. Është ai sy, që hilañjosi e shkel, sa herë i duhet të thurë një intrigë. Dhe në këtë zeje: “Çdo injorat në punë intrigazh ia hedh gjithë të mençurve”, thotë Tolstoi. Poeti na fton të udhëtojmë në të fshehtat e poezisë së tij, pa qenë udhërrëfyes i tyre. Kështu që na duhet të çajmë vetë nëpër labirinthe e metaforave, pa qenë asnjëherë të sigurtë se do ia dalim.



Një nga kufijtë më të brishtë në letërsi mbetet ai mes reales dhe trillit. Në fund të fundit, në një mënyrë apo një tjetër, është njëzëri e pranuar se rrëfimi letrar dhe rrëfyesi (apo narratori) merr përsipër ta rrëfejë një ngjarje në letërsi, duke e trilluar atë artistikisht sipas ligjësive letrare. Por përtej trillimit letrar, që e merr një ndodhi jetësore dhe e rikrijon përmes artit të fjalës në një krijim ose trillim artistik, ekziston një tjetër nivel të kuptuari i konceptit trillim. Bëhet fjalë për të kthjelluar çfarë është trill si element fantastik/magjik dhe çfarë është realitet në kufijtë e narracionit në gjininë e prozës. *Sipas V. Propp, fjala “përrallë” në shumicën e gjuhëve do të thotë një sinonim për fjalën “trillim”, “gënjeshtër” dhe karakterizohet nga themeli i saj mbi shpikjen artistike, e cila është një iluzion i realitetit.*¹ Përcaktimi i Propp-it i ngërthen të dyja kuptimet. Pra, edhe trillimin letrar si gjendje e rrëfimit, edhe trillin si iluzion i realitetit, apo kufirin që ndan fantastiken nga realia në një vepër.

Në letërsi ka shumë tekste, për të cilat mbetemi pak të mëdyshur për t’i klasifikuar në lloje apo nënloje letrare brenda gjinive letrare të përcaktuara qartazi nga klasifikimet tradicionale të teorisë së letërsisë. Kur mëdyshjen e krijojnë kufiri mes reales dhe fantastikes, gjykimi bëhet edhe më i vështirë. Në këtë kontekst, rast shumë specifik është përralltari danez Andersen, në krijimtarinë e të cilit, proza të tilla si “Mbreti lakuriq”, “Hija” etj, megjithëse shpesh etiketohen si përralla, në të vërtetë nuk janë përralla. Alegoria e këtyre rrëfimeve është shumë larg përrallës së mirëfilltë. Te tregimi-përrallë “Hija”, gjithë sekreti alegorik i tekstit qëndron në dy pika kyçe të tregimit. Së pari, kur dijetari i dëshpëruari i rrëfen Hijës se: “Shkruaj për të vërtetën, të bukurën dhe të mirën, po asnjëri nuk ma var. Jam i dëshpëruar për këtë”. Drama zë fill pikërisht me lodhjen e dijetarit në rrugën e së vërtetës dhe pranimit që ai i bën ftesës për udhëtimin e propozuar nga Hija. E vërteta nis kështu alegorikisht të mundet nga mashtrimi. Së dyti, në njohjen e Hijës me princeshën, e cila në çastet e njohjes me mbretin a ardhshëm vuante nga sëmundja e të parit qartë, tej masës. Më pas princesha do të verbohët nga dashuria dhe e vërteta e rreme. Drama që qëndron pas këtij verbimi është dramë shumëpërmasore. Hija (Mashtuesi) do të udhëheqë popullin dhe e vërtetë do të jetë larg turmës së verbuar; simbolikisht e shprehur me vrasjen e dijetarit. Elementi fantastik i vënë kryekëput në funksion të alegorisë e bën “Hijen” të jetë më tepër tregim sesa përrallë.

*Kritika e përdor termin alegori si interpretim arbitrar, ku diçka lexohet “si alegori” e diçkaje tjetër. Kjo mënyrë interpretimi e alegorisë, shpesh e quajtur alegorizuese, ku veprat joalegorike interpretohen sikur synohen të jenë alegori.*² Në letërsinë shqipe, rast i një vepre të tillë alegorizuese është romani “Erërat që trazojnë mjegullën” (Kronika të Naltinisë). Vetë Ervin Nezhë nuk e ka marrë përsipër përcaktimin e llojit letrar të prozës së tij. (Termi “roman” i referohet vetëm klasifikimit të kryer në katalogimin e veprës). Por nga ana tjetër, autori i veprës i quan “kronika” ndodhitë e romanit. A mund të jetë ky detaj një udhëzim për perceptimin e veprës si vepër alegorizuese dhe jo si përrallë? Kronikat në fund të fundit janë dëshmi objektive të ngjarjeve historike, ndaj dhe thelbi i tyre mëton të shkojë sa më pranë të vërtetës absolute që të jetë

¹ Propp, V. (1982). Morfologjia e përrallës. “Pika pa sipërfaqe”. Tiranë.

² Greene, Roland. Cushman, Stephen. Cavanagh, Clare. Ramazani, Jahan. Rouzer, Paul. Feinsod, Harris. Marno, David. Slessarev, Alexandra. (2012). *The Princeton Encyclopedia of Poetry and Poetics*. Princeton and Oxford: Princeton University Press.

Rreth veprës “Erërat që trazojnë mjegullën” të Ervin Nezhës

Ankthi hermeneutik i një proze alegorizuese

Nga Alisa Velaj

e mundur, edhe pse larghedhja kohore e ngjarjes shpesh është disashekullore.


*Një alegori ngjall ankth hermeneutik dhe jep udhëzime për lojën interpretuese. Duke u përfshirë në një lojë të tillë, lexuesi ndërton një strukturë koherente kuptimi që më pas imagjinohet se ka qenë e fshehur paraprakisht dhe se ka qenë thjesht zbuluar nga lexuesi.*³ Në leximin e parë, dallojmë qartazi se kemi të bëjmë me leximin ndryshe të legjendës së Gjergj Elez Alisë, ndësa zgjidhja e konfliktit të veprës vjen përmes “logjikës fantastike”. Leximet e tjera të veprës, përmes dekodifikimit të shenjuesve tekstorë, na zbulojnë pafundësi lojërash interpretuese. Gjithsesi ne do të ndalemi te alegoria që ngjall ankthin hermeneutik të tiranisë, pasi shenjuesit që shenjojnë këtë areal kuptimor, janë të lidhur me njëri-tjetrin në një strukturë aq solide, sa zor se do të anashkaloheshin, edhe sikur veprës t’i bëhej një lexim/interpretim i ndryshëm nga ky që po paraqesim.

Pesha kryesore e alegorisë në vepër ngjizet shkallë-shkallë me anë të detajeve përshkruese të karakterit dhe pamjes së jashtme të dy personazheve kryesorë, Gjergjit dhe Naisinës, zërit autorial të rrëfimtari të gjithëdjishëm që kamufllohet herë në zërat e personazheve dytësore e herë në aktin e rrëfimit dhe së fundi, në epilogun në fund të kronikave. Le të ndalemi në fillim te detajet e përshkrimit të personazhit të Gjergj Elez Alisë. Autori na dëshmon që në hapje të rrëfimit se “ky njeri i çuditshëm quhej Gjergj Elez Alia dhe qe prijës fisnor i këtyre territoreve”. Pas çudisë si element dallues i karakterit

3 Po aty.

të protagonistit, na jep të tjera të dhëna jo shumë të zakonata për territoret ku princi qeveris. Këto territore “qenë të izoluar nga pjesa tjetër e botës” dhe “në Naltininë ato që ndodhnin jashtë, pra në botën e madhe, nuk përbënin asnjë interes dhe nuk ndryshonin asgjë. Atje dukej sikur prej vitesh gjërat mbeteshin përherë njësoj: të zymta, të mjegullta dhe të heshtura”. Prejardhja e titullit princ është po kaq e çuditshme, për sa kohë nuk mbështetet në asnjë ligj politik apo kod zakonor të kohës. Narratori informon lexuesin se “këtë titull e pati sajuar vetë” dhe “ndaj thjesht qeveriste tokat e lëna nga babai, dhe që mendonte se qe në të drejtën e Zotit t’i qeveriste”. Pra princi i vetshpallur jo vetëm se jeton në një vend të mbyllur malor, çka e bën edhe më të tmerrshëm mënjanimin dhe të pamundur komunikimin me botën e madhe, por nuk njeh asnjë autoritet politik, veç politikave të egos së tij të sëmurë. Madje dhe të drejtën e Zotit e percepton sipas mënyrës së tij, gjë që del hapur në fjalët e priftit Nikifor drejtuar të huajve: “Zoti ynë i plotësoi lutjet tona dhe ju dërgoi ju, që të na shpëtoni nga rrënimi”.

Figurat e tiranit dhe të së motrës, Nasinës, e cila më tepër se bashkëprotagoniste është alteregoja që flet e personazhit të pagojë të Gjergjit në pjesën dërmuese të rrëfimit, ngjizen në përfytyrimin e lexuesit dhe përmes ndjesive të ngjallura te personazhet dytësorë. Kështu, ndërsa Gjergj Elez Alia perceptohet si “tirani me sy ujku” apo njeri “pa hije”, Nasina ngjall ndjenja të tmerrshme sepse “në sytë e saj kishte vetëm urrejtje dhe akull”. Ky zë i tjetrit në tekst për formësimin e tipareve të



dy protagonistëve nuk është tjetër veç zërit të kamufluar autorial. Epilogu “Nëntë vite më vonë...” i vë vulën e pakundërshtueshme kuptimit të fshehur alegorik të të gjithë veprës dhe mbështet fuqishëm idenë e hedhur prej fillimit, se jo vetëm nuk kemi të bëjmë me një përrallë, por ky rrëfim mjeshtëror i Ervin Nezhës është alegori e shkëlqyer e tranzicionit të pambarimtë shqiptar në Shqipërinë londineze. Fjalët e personazhit pa emër, i pagëzuar në tekst si “i panjohuri që printe” janë mesazhi më kuptimplotë i gjithë lojës alegorizuese.

“Sepse Gjergj Elez Alia është gjithsecili prej tyre. Këtë ne s’e kemi kuptuar kurrë. Dhe diçka që është gjithçka njëherazi, është dhe asgjë.

.....
.....
Do t’i lëmë vetëm dhe do t’u japim pështypjen se i kemi harruar. Dhe ata do t’i marrë malli për ne. Dhe kur ne të mos vijmë, ata do të hidhërohen, do t’i harrojnë të gjitha, do të harrojnë edhe veten dhe kur t’i harrojnë të gjitha, do të harrojnë edhe atë, sepse ai thjesht nuk do t’u duhet më”.

Nezha vë gishtin mbi plagën e tiranisë politike dhe shpirtërore. E para nuk është asgjë para së dytës. Me vdekjen e tiranit duket sikur zhduket tirania politike, por trashëgohet e shumëfishuar tirania shpirtërore, duke i bërë edhe më të pamundur barrierat për të dalë nga kufijtë e vetes, nga skutat e egoizmit tiranik që na lë të vetmuar, njësoj si tirani la të izoluar Shqipërinë për gjysmë shekulli. Sot pas tridhjetë vjetësh vuajmë diktaturat që secili i vë shpirtit të vet. Prandaj tranzicioni vetëm zgjatet dhe ringjallja kombëtare është kaq e vështirë.

Rrëfimi ka karakter universal dhe fare natyrshëm mund të lexohet si tranzicion i pambarimtë vlerash për çdo lloj shoqërie, që në vend të merret me kurimin e plagëve që lë tirania, e harxhon kohën duke u menduar për karakterin e çuditshëm që tirani kish. E gjitha kjo duket se merr formën e sindromës së Stokholmit, ku i rrëmbyeri (viktima) fillon të dashurojë xhelatin (tiranin). E në vend të shërohet nga viktimizimi merr dhe vet tiparet e tiranit.

Prandaj duhet harruar çdo gjë nga e kaluara. Ndaj duhet fshirë çdo mendim për tiranin. Për të rilindur veten, tjetrin e ngjashëm dhe kombin. Ai “i panjohuri që prin”, personazhi i paemër që na i kumton të gjitha këto gati një dekadë pas mbarimit të diktaturës, nuk është një ikanak. Është zëri i atij që zgjedh të rri duke përzënë nga vetja frymërat e tiranisë. Ai është mendimi që duhet të na prijë. Mendimi që duhet të guxojë të jetë ndryshe. Si është ndryshe mes shumë veprave të botuara pas viteve ‘90 dhe kjo vepër alegorizuese e Nezhës. Ndryshe për nga vlerat letrare dhe fryma që mbart.



Shohim dhjetëra herë në ditë këtë fjalë, të shkruar a të shqiptuar me **g** ose me **xh**. Trajta me **xh** ka marrë aq të përhapur, saqë e japin si normative edhe korrektorët e tekstit të celularëve e të tabletëve. Këto trajta të gabuara të kësaj fjale hasen jo vetëm te folësit e thjeshtë, po edhe në shtypin e shkruar e të folur, veçanërisht në ligjërimin e gazetarëve televizivë e radiofonikë, të cilët pritet të jenë model i shqiptimit letrar. Këta jo vetëm e shqiptojnë këtë fjalë me **xh**, po edhe me theks në rrokjen e parë, në vend që ta shqiptojnë me **gj** e me theks në rrokjen e fundit, siç e do shqipja; për më tepër, e shqiptojnë dhe e shkruajnë edhe pa mbaresa rasore.

Dikush mund të thotë: “Punë e madhe! Ç’është keqe ka këtu? Secili le t’i shkruajë e t’i shqiptojë fjalët si të dëshirojë!” Po gjuha përdoret për të komunikuar me të tjerët dhe, për t’u marrë vesh, fjalët dhe trajtat e tyre duhet të kenë gjithmonë formë të njëjtë në të folur e në të shkruar. Kjo është arsyeja pse gjuhët zyrtare e letrare kanë rregulla drejtshqiptimi, drejtshkrimi, morfologjike e sintaksore, të përmbledhura në kode, rregulla të cilat janë të detyrueshme për t’u zbatuar nga ata që përfshihen në ligjërimin publik: gazetarë, mësues, nëpunës, shtetarë etj.

Në këtë shkrim po merremi vetëm me përdorimet e gabuara të fjalës *digjitalb*, pasi nga analiza e tyre mund të kuptohen plagët që po i shkaktojmë gjuhës sonë në të gjitha rrafshet e saj.

Nga pikëpamja ortografike, shkrimi i kësaj fjale i nënshtrohet një rregulle sipas së cilës “fjalët që burojnë nga greqishtja, latinishtja e nga gjuhët romane”, të cilat kanë një **g** të ndjekur nga zanoret **e** ose **i**, në shqipe “shkruhen me **gj** e jo me **g**”: *agjenci, digjital, Egjipt, gjen, gjenetikë, gjips, gjibon, gjirafë* etj. Pra, shkrimi i këtyre fjalëve me **g** ose me **xh** përbën një shkelje të kësaj rregulle të drejtshkrimit të shqipes.

Shkrimi me gabime është dëshmi e formimit të mangët gjuhësor, që i ka rrënjët në punën e dobët të shkollës me gjuhën shqipe, por edhe e kulturës së mangët gjuhësore të atyre që përfshihen në ligjërimin publik, të cilët nuk e ndiejnë si detyrim përdorimin korrekt të gjuhës. Sepse sot janë të shumta mundësitë për të gjetur si duhet shkruar një fjalë. Edhe nëse doracakun “Drejtskrimi i gjuhës shqipe” nuk e kemi në letër, mund ta gjejmë në internet; si duhet shkruar një fjalë a një formë e saj, mund ta gjejmë në fjalorët shpjegues ose drejtshkrimorë, të cilët kushdo që shkruan duhet t’i ketë mbi tryezën e punës; janë edhe fjalorët elektronikë të shqipes, që mund t’i shkarkojmë në kompjuter a në celular, po dhe korrektorët elektronikë të programeve të përpunimit të tekstit. Pra, mundësitë për të shkruar pa gabime janë, duhet vetëm që kushdo që i drejtohet një publiku të gjerë, ta ndiejë përgjegjësinë që ka për të përdorur një gjuhë korrekte.

Sa i përket ortoepisë, theksimi i **digjitalb** në rrokjen e parë thyen dy rregulla të fonetikës së shqipes, sipas të cilave: (1) theksi i fjalës bie mbi zanoren e fundit të temës (të trajtës së fjalës që jepet si zë fjalori), por në rrokjen e parafundit kur zanorja e rrokjes së fundit është e paqëndrueshme (si tek émër – émri, lúle – lúlja etj. ose te fjalët me -ës, -ëz, -ël, -ëll, -ëm, -ër, -ërr, ull, -ur a te fjalët që mbarojnë e dy zanore: krýe, grúa, blúaj, bíe etj.); (2) në fjalët e përbëra theksi bie mbi temën e dytë. Pra, duhet digjitalb dhe jo dígjitalb. Këto rregulla nuk mësohen aq në shkollë (madje, në tekstet shkollore thuhet gabim se në gjuhën shqipe theksi i fjalës bie mbi rrokjen e parafundit të saj), sesa janë pjesë e njohjes intuitive të gjuhës nga folësi amtar.



“Digitalb”, “Dixhitalb” - SI PO TRONDITEN THEMELET E SHQIPES

Prof. dr. Rami Memushaj

Theksimet e gabuara të fjalëve i shohim si pasojë e tronditjes së ndjenjës gjuhësore te brezi i ri. Për shembull, nëse ju quajnë Mikél, në bankë apo në një zyrë ka shumë gjasa t’ju thërrasin Míkel, Avnúut t’i thërrasin Ávni, Thodhoríut – Thodhóri, Tekíut – Téki etj. Në emisionet e lajmeve do të dëgjoni Zëmblak e jo Zëmblák, Káarakas ose Karákas dhe jo Karakás, Láos dhe jo Laós, Bórusia dhe jo Borúsia, Pútín e jo Putín, Súnak e jo Sunák, Vúciç e jo Vuçiç etj. Ky shqiptim i fjalëve me theks në rrokjen e parë, si në anglishte, është bërë i modës në televizione dhe, nën ndikimin e tyre, kjo “modë” ka prekur edhe folësit e thjeshtë. Kështu, një nënë e re i thërret djalit të saj Gláuk dhe jo Glaúik, me theksin tek **u**-ja, siç e shqiptojnë shqiptarët me pak shkollë, por që ia ruajnë me besnikëri tiparet origjinale shqipes.

Duke i shqiptuar fjalët në këtë mënyrë, folësit televizivë, por edhe të tjerë që përfshihen në ligjërimin publik, japin një shembull të shëmtuar të përdorimit të gjuhës standarde. Nuk është fjala thjesht për anën estetike të ligjërimit. Ky shëmtim ka pasoja largvajtëse për vetë natyrën dhe originalitetin e gjuhës sonë. Sepse çdo gjuhë ka rregullat e veta fonetike e gramatikore, të cilat e bëjnë të veçantë e të dalluar nga gjuhët e tjera. Këto rregulla, që mund t’i quajmë parametra, trashëgohen brez pas brezi nga prindërit te fëmijët. Nëse këta parametra ndryshohen, për shembull, nëse prindërit do t’i shqiptojnë emrat me theks në rrokjen e parë të fjalës, si në anglishte, dhe jo në rrokjen e fundit, atëherë fëmija, që e fikson parametrin e theksit duke dëgjuar ligjërimin e të rriturve, do të ngulitë në trurin e vet një parametër theksor si të anglishtes dhe, për pasojë, do të vijë duke humbur një tipar bazë i fonetikës së shqipes.

Mirëpo, meqë gjuha është sistem, ndryshimi i një elementi të sistemit shoqërohet me ndryshime të elementeve të tjera të tij, si në një reaksion zinxhir. Kështu që ndërrimi i parametrin të theksit sjell me vete ndryshimin e parametrave të tjerë fonetikë. Kur flasim, rrokja e theksuar

e një fjale shqiptohet me forcë, rrokjet e tjera me forcë më të dobët ose pa forcë. Ky alternim i forcës së zërit krijon ritmin e frazës (që mund ta përfytyrojmë si kreshta me lartësi të ndryshme dhe qafa të një vargmali), i cili e bën rrjedhën e tingujve të pranueshme dhe të pëlqyeshme për veshin. Po duke i shqiptuar fjalët me theksin në rrokjen e parë dhe jo aty ku duhet, shtohet numri i rrokjeve të patheksuara midis rrokjeve të theksuara dhe prishet ritmi i frazës, pasi do të kemi theksa ritmikë që nuk janë në natyrën e shqipes. P.sh., shqiptimi i frazave “Dígitalb / është pranë teje”, “Díxhitalb / ofrón pakëtën e ré” ose “gjatë múajit korrírk / në Díxhitalb” me fjalën “digjitalb” të theksuar në rrokjen e parë është i papëlqyeshëm për veshin e shqiptarit. Ndërsa shqiptimi i këtyre frazave me këtë fjalë me theks mbi **a**-në është i pëlqyeshëm: “Digjitálbi / është pranë téje”, “Digjítálbi / ofrón pakëtën e ré”, “gjatë múajit korrírk / në Digjitálb”. Arsyeja e pëlqimit të këtyre shqiptimeve është se veshi e do që pjesët e secilës frazë t’i kenë theksat mbi rrokjen e fundit të secilit grup. Një shqiptim i tillë jep një skemë ritmike të natyrshme për shqipen. Kurse shqiptimi që i zhvendos theksat në rrokjen nistore të fjalëve, sikundër po ndodh me folësit televizivë e radiofonikë dhe përgjithësisht me brezin e ri të shkolluar, e zhvendos edhe theksin logjik të frazës (se edhe ky i mbishtresohet theksit të fjalës së fundit të frazës), prish ritmin dhe melodinë e saj, duke prodhuar një të folur artificial që të vret veshin dhe që s’është as shqip e as anglisht.

Meqë jemi te fonetika, nuk mund të lëmë pa përmendur edhe një parametër tjetër: tempin e të folurit. Gjuha shqipe dallohet për një temp shqiptimi përgjithësisht të baraspeshuar, as të shpejtë, as të ngadalshëm dhe kjo e bën të folurit të këndshëm për t’u dëgjuar. Por në televizione po bëhet modë shqiptimi i shpejtë. Në emisione e në biseda televizive dëgjon folëse që flasin si mitraloz, pa pauza për të marrë frymë e që të marrin frymën kur i dëgjon, ose reklama barnash ku

tempi është aq i shpejtë, sa detyrohesh të ndërrosh kanalin e televizorit. Shqiptimi i shpejtë i fjalëve, që i ngjan vërshimit të një përroi malor, jo vetëm që të vret veshin, po edhe errëson përmbajtjen e mesazhit, duke e bërë të paqartë për dëgjuesin. Kjo mani për të folur shpejt qoftë për të thënë sa më shumë gjëra në sa më pak kohë, qoftë për të treguar erudicionin, bën që të preket një tjetër veçori fonetike e shqipes që e dallon nga gjuhët e tjera.

Në analizë të fundit, ndryshimi i këtyre parametrave fonetikë prek atë që quhet «baza nyjetimore e shqipes», e cila duhet kuptuar si një tërësi parametrash të përpunuar gjatë një mijëvjeçari e gjysmë të jetës së gjuhës sonë e të trashëguar brez pas brezi. Janë pikërisht këta parametra fonetikë që e bëjnë shqipen të veçantë nga pikëpamja e intonacionit.

Theksimi i emrave në rrokjen e parë nuk është pa pasoja edhe për gramatikën e shqipes, pasi prek parametra morfologjikë e sintaksorë të saj. Kur fjalët theksohen në rrokjen e parë, si p.sh. fjalët Súnak, Shtóltenberg në frazat “Ráma takón Súnak”, “Rama takón Shtóltenberg”, jo vetëm prishet ritmi i frazës, po preket edhe morfologjia e emrave të fundit, që duhen përdorur me mbaresë: Súnak**un**, Shtóltenberg**un**. Nuk është se folës të tillë duan të mos i shqiptojnë mbaresat. Puna është se shqiptimi i dy rrokjeve të patheksuara pas rrokjes së theksuar është i vështirë, dhe për këtë arsye shqipja zakonisht e pret fjalën duke filluar nga rrokja e fundit e patheksuara dhe në raste të tilla e pësojnë mbaresat, që nuk shqiptohen. Zakonisht, kjo ndodh me emrat e përveçëm të huaj, po ky shqiptim pa mbaresa po vjen duke u shtrirë edhe në emrat e përgjithshëm të huazuar, madje dhe në fjalë të shqipes, p.sh.: “**Radio** e njohur u krijua 75 vjet më parë” (duhet *radioja*) etj.

Shqiptimi i fjalëve të huaja pa mbaresa nuk është pa pasoja edhe për sintaksën. Mungesa e mbaresave e vështirëson përkapjen e funksionit të fjalës në fjali dhe në raste të tilla kur nuk të ndihmon morfologjia, futet në punë përbërësi logjik i gramatikës, pra shtohet ngarkesa e trurit dhe harxhohet më shumë kohë për zbërthimin e përmbajtjes së mesazhit. Duke humbur lakimin, shqipja do të bëhet si gjuhët pa rasa, si p.sh. anglishtja, ku është e vështirë të rrokët funksioni sintaksor i fjalës pa e dëgjuar tërë fjalinë. Humbja e lakimit do të thotë humbje e një parametri tjetër themelor të shqipes, i cili e ka ruajtur gjuhën tonë nga trysnia asimiluese e gjuhëve të pushtuesve.

Tashmë është pranuar edhe shtetërisht se gjuha shqipe është e kërcënuar. Shtetet shqiptare e kanë detyrë kushtetuese mbrojtjen e gjuhës standarde, që është gjuha e tyre zyrtare. Po këtë detyrë shteti e kryen, së pari, me ndihmën e institucioneve të veta shkencore, akademisë, instituteve të gjuhësisë, departamenteve të gjuhës shqipe, të cilat janë përgjegjëse të drejtpërdrejta për mbrojtjen e gjuhës. Mirëpo është për të ardhur keq që këto institucione kanë tridhjetë vjet që po bëjnë gjumin e madh, në vend që të tërheqin vëmendjen e shoqërisë dhe të shtetit për të vënë në veprim mekanizma për mbrojtjen e gjuhës dhe të ofrojnë këshillim gjuhësor për përdoruesit e mëdhenj të gjuhës etj. Në gjumë është edhe AMA, e cila ka detyrimin ligjor të kërkojë nga operatorët e shërbimit audioviziv “respektimin e standardit letrar të gjuhës shqipe” (Neni 4, 2g). Nuk janë pa përgjegjësi as pronarët dhe drejtuesit e medieve të shkruara e radiotelevizive, të cilët zotërimin e gjuhës shqipe nuk e kanë ndër kriteret e punësimit dhe as e ndiejnë nevojën e kualifikimit gjuhësor të punonjësve të tyre.

Për kë e sheh për herë të parë ai mund të duket disi i shkëputur nga mjedisi ku gjendet, i përhumbur pas shtëllungave të duhanit që tymos vazhdimisht, ama miqtë e dinë se është vëzhgues i imët. Ai vrojton nga një distancë e shëndetshme për pavarësinë e mendimit dhe të shpirtit, gjë që e bën ironinë e tij të mos ketë nuanca prej kritizeri pedant. Në vjershën “matanë” e shohim si i qaset shqisa e tij e mprehtë poetike një realiteti shoqëror të stërkequr nga i cili të fituar dalin maskarenjtë, dallaveraxhinjtë, hasmi apo çdo lloj perversi narçizik.

*matanë
një lëndinë
njeri a kalë
tërheq një tokore
ngarkuar me fjalë
një shpend i zi
në pritje
han dhe vjell rrokje
një qiell me napë të vranët
vrugon sipër
matanë*

Ja, Dan është diku, në diell, sheh dhe na bën të shohim atë që i dhemb. Jo vetëm aq. Nga re puplore që s’lëshojnë hije mbi tokë, ne shohim si qielli mbulohet me re të ulta të cilave u plasim ujërat e pjellin trishtim. Kështu çelet vëllimi poetik “E njëjta hënë”, botuar më parë nga shtëpia botuese “Buzuku”, Prishtinë, e më pas nga shtëpia botuese “ Onufri”, Tiranë. Ai është përkthyer në rumanisht nga Kopi Kycyku dhe po përkthehet edhe në frëngjisht, punë të cilën autori ma ka besuar. Vetëm vargun e parë dhe të fundit, që janë të njëjtët mos më ndërro, - më tha, - të tjerat i di ti. Është fat të komunikosh me autorin që përkthen. Kjo të jep komoditetin e sigurinë që nuk je duke ecur qorrazi e as nuk po shpik.

Kur i lexon vjershat e këtij vëllimi mund të kesh si fillim ndjesinë se je në prani të diçkaje që lexohet lehtë. As gjuha dhe as sintaksa nuk njohin kapërdimje posaçërisht poetike. Dan mbështillet nga drita e së njëjtës hënë që feks mbi kryet tona, veç përkthyerja e asaj drite mbi poetin krijon një mjedis amniotik ku embrioni i poezisë gjen kushtet për t’u zhvilluar si një fetus i shëndetshëm. Në orën e tij të lindjes dhimbjet duhet të kenë kenë qenë të mëdha. Them “duhet” se askush nuk ka qenë aty për t’ia parë shtërzimet, vetëm se gjithë përgjakjen e lindjes mund ta shohim në dritën që e njëjta hënë, ajo e poetit që bëhet dhe e jona, hedh mbi fëmijën e ardhur në jetë.

*e njëjta hënë
më shikon sërish
si dikur
një ogur
koha ime e bjerrë
pengu i ringjallur
sa larg më paska shkuar
tej kullisë së botës*

Kështu shkruan autori në njërën prej dy vjershave me të njëjtin titull e na sjell një tablo përjetimi e cila lidh kujtimet me të përtejmen që na ka kapërdirë pjesë a gjymtyrë tonat. Këto “vete” shëtisin lëndinave të pambërritshme e jetojnë brenda nesh si jetë të pajetuara, si pengje.

Ky vëllim poetik përmban pesë blloqe poezish të cilat janë grupuar secila nën një titull e tematikë: koha si ikje (Tablotë i ka pirë koha në ecje), atdheu si dhimbje e përgjegjësi (Leshrat mbinë në diell), dashuria si gjakim (Plot zagushi), dashuria si idil (Mirina), përsëpirtje (Ah...).

Që prej titullit të veprës e në vijim me nëntitujt shohim qasjen postmoderniste të Dan Ibrahimit me subjektin poetik. Si e tillë, kjo vepër mbështetet në ironinë kritike, relativizimin, dyshimin pasi modeli i botës që na propozohet prej Dan, nuk është një model i mbyllur. Vepra ruan në gjithë shtrirjen e saj një ton ekuivok dhe bota e shpalosur në të vërtitet në një farë inkoherece të brendshme. Estetika e veprës së Dan është e shumëfishtë në paralel me realen në të e cila na paraqitet në gjithë larushinë e saj. Ajo nuk mbërrin në përfundime, nuk pretendon se ka cekur të vërtetën unike, por symbylltazi vazhdon rrugëtimin drejt njohjes me vetëdijen e plotë se ky rrugëtim është i gjatë. Në poetikën e tij, Dan rregullisht i jep vend të veçantë asaj çka mund të ketë qenë shpesh e marginalizuar, e pazë, larg qendrave të mëdha të interes, e quajtur e padenjë për t’u folur apo për t’u folur në mënyrën e qartë e të shtresëzuar njëherazi siç e bën ai.

Ndryshe nga çfarë shohim rëndom në poezi, sot, ku i mësohet kohës lineare me projektim në të ardhmen, Dan në korpusin e tij poetik merret me atë çka bulon nga imagjinaria, intimitja, nga leximi personal, madje nga përvetësimi i tij individual i botës ku jetojmë. Ndaj heroji,

Vëllimi “E njëjta hënë” e Dan Ibrahimimi

POETIKA E NJË REBELIMI TË PËRKORË

Nga Mirela Robo

subjekti poetik, ofron një kontur të lëvishëm, të papërcaktuar e shpesh shfaqen si mirazhe, si tek poezia

“ sonte”. Vargu “ Tablotë me kupë i ka pirë koha në ecje”, nuk shpreh tjetër veç mallit që ndjen poeti për çfarë shkoi e nuk kthehet më, në rrafshin kohor, në plan të pëgjithshëm por edhe konkret. Ndoshta nuk ekziston poet pa temën e mallit në indin e tij poetik. Por Dan e sjell këtë me një ekonomi mjeteshe efikase. Ajo ku ai “shpenzohet” është skeleti dhe organizimi i ndërtesës. Nuk shohim tepri as në fasadë e po ashtu e gjejmë këtë përkujdesje edhe në mjediset e brendshme ku ndien se mund të lëvizhësh lirisht pasi hapësira nuk është zaptuar e gjitha prej autorit.

*një lis
një qen
një mace me lara
një njeri...
ishin aty
shitjellë kujtimesh
syrit tim të përmalluar*

Dan është empatik. Fijet e empatisë e lidhin atë si krijues me të tjerë që, si ai, në të tjera kohë, ndoshta për të tjera motive janë ndier si ai.

Tek vjersha “si sot një ditë” shohim si autori imagjnon jetë e ngjarje që nuk i ka jetuar por që i përcjell me një natyrshmëri e vërtetësi plot ndjeshmëri. “Veçori e poezisë së Dan Ibrahimit është metaforika kontekstuale e shtrirë në tabloide e imazhe të gjera, thellësia e të cilave



shpërfaqet natyrshëm, sa ke përshtypjen sikur bëhen të pavërtetshme përmasat e tyre.” do të shprehet Shaip Beqiri për të.

*atje
ulërin një qen
si ujku
një njeri
i trentë
rrëfen kryeveprën e vet
rrenën*



Dan refuzon të konformohet me një botë me vlera në bjerrje. Nuk është e re kjo. Bota e ka nisur këtë numërim mbrapsht që në fillimet e saj, nëse ka pasur ndonjëherë fillim. Antikonformizmi nuk është më as në modë. Sidomos kur ke qenë luftëtar, kur i ke dhënë shoqërisë rininë, shëndetin, shpresat. Tani mund të jetosh fare mirë me kapitalin që i fal lufta njeriut të angazhuar. Por, Dan Ibrahimimi mendon se çdo kohë kërkon njeriun e saj. Të jetuarit e shkruarit si veteran nuk bën për të. Ndaj, ai shkruan pa barriera për krizën e bashkëkohësit “qen” a “ujk” për të cilin hipokrizia dhe manipulimi janë vesk në rritje:

*ai shënon rrenën
në biografi
qeni
harron çështje
beson në njeri
atje*

Nuk mund të mos lexosh shumëfytirësinë e njeriut brenda të cilit përplasen cmira, xhelozia edhe tek poezia “Ka-ka kr-ra-kr-ra” – “ku gjejmë përkthyerje të harmonishme të fjalës në marrëdhënie me timbrin, prani tingullore”, siç analizon Zejnepe Rexhepi poezinë e Danit. Gama e temave që trajtohen në vjershat e kësaj përmbledhjeje poetike është e gjerë. Ai ngallmon çdo element të puzzle-i duke krijuar një afresk ku parakalojnë mosmirënjohja (tek poezia “ ja arti”); pabesia

(“nuk e di përse”, “mor’ zot”); hipokrizia (“ti më pyet përse nuk erdha”), dashuria e shpërdoruar (“kot troket”); padituria (“kalo në page”); etja për pushtet, etj. Ndonjëherë, në poezinë e Dan kërkimi i kuptimit në një botë kaotike shmanget plot humor. Ai kujdeset thjesht të na përkthejë atë që sheh shqisa e tij poetike.

Vjershat e vëllimit poetik “E njëjta hënë” nuk janë si ca lule herake që çelin e vyshken shpejt. Ato kanë për lëndë të parë zhdërvjelltësinë e vargut, të mendimit, lojën e pandërprerë midis imazhit dhe ironisë, vënies në lojë dhe ndjeshmërisë së fshehur me kujdes si një prind që mbron me fanatizëm fëmijën e tij më të dobët, më të pambrojtur. Kjo e fundit është thembra e Akilit e Dan Ibrahimit. Ai nuk na e përplas vend e pavend ndjeshmërine duke na gjuajtur me fjalë që bubullojnë e shkreprijnë, por e lejon të shpaloset si vello nusërie në puhi dashurie. Madje, vet hapësira që zë vargu i tij në letër është dëshmi e kursimit, e përkorës për të mos e rrëfyer atë që ka brenda përmes arrogancës së bojës mbi letër. Poeti na vjen herë-herë si një fëmijë që mban në duar një kalë deti e teksa përpigjet ta ruajë aty na e tregon me pëllembën e shtrirë që i dridhet nga droja se e mbyt para se ta shohim. Dan nuk do të rëndet. Përmes poezisë së tij, na sygjeron që të lexojmë, të heqim aq shtresa sa duam, sa mundemi, sa mbajmë.

Tek pjesa e tretë, “leshrat mbinë në diell” ose ndryshe “në liri mbiu e keqja” na vë përballë rrugëtimit në një plan më të gjerë të poetit, atë përballë atdheut, idealeve të lirisë, gjakut të derdhur, rolit të tij, të bashkatdhetarëve të tij, udhëkryqit në të cilin gjenden ata që, si ai, nuk u është bjerrë ndërgjegjja dhe iluzioneve të humbura.

*atdheu
çfarë nuk pje
ferra lule fasule...*

Kështu e nis ai poezinë “atdheu” të cilën e përfundon në krejt tjetër ton:

*belbëzimi ynë
heu
atdheu*

Pasthirrmë apo klithmë që na çon tek fjalët e para të foshnjes është atdheu që për Homo Albanicus me kujtesë historike mbetet fjalë e parë. Por, e shoh këtu togfjalëshin “belbëzimi ynë” edhe si një dhimbje për artikulin e munguar të atij që nuk zotëron të folurën, që flet cungët. A na thotë Dan se shqiptari ndodhet në udhëkryqet e një historie që ai vetë e ndërton dyshimshëm për veten e vet? Midis leximit të parë dhe të dytë, edhe këtu zgjedhja është jona. Pak rëndësi ka se çfarë mendon autori në ato momente të epërme krijimi. Në leximin tonë, ai na lë të lirë.

Poezia “O udhëtar” (Epitaf eksodit 1999), na përball me dëbimin, ekzilin e një populli si ngjarje me reperkusione të padiskutueshme tek individi. Kështu e lartëson Dan Ibrahimimi gjëmen që prodhon urrejta kolektive, jo duke nëmur a shkrepëtirë mbi urryesit por duke u ndalur tek drama e individit. Kjo është mënyra e tij për t’i dhënë dinjitet luftës, vuajtjes. Duke e sublimuar ai mëton t’i veshë asaj rol katarsisi.

*o udhëtar
ndalo një çast
mbaj frymën dhe dëgjo
kronikën e një kohe të egër
.....
dhe harro po munde
jehonën e kohës farmak
që ruajnë këto udhë
ky tren e kjo luginë
o udhëtar*

Tek “Quhet liri” ai na pranëvë me zhgënjimin e njeriut që fiton luftën ndaj armikut por e humbet atë përballë vetes, përballë konjukturave. Zhgënjën edhe “Liria” për të cilën u derdh gjaku shekullor! A është njeriu viktimë e kohëve më pak idealiste apo e betejave më të mëdha se ai vetë? Këtë Dan na lë ta vendosim ne. Fjalori i tij, që herë-herë në vetvete nuk është poetik, assesi nuk transmeton përçmim. Ai dëshmon për një skanim të hollë të individit që e çon tek dhembshuria për të. Në gjithë verbin poetik të këtij vëllimi nuk shohim Danin, luftëtarin që e përdor luftën për të zënë një vend nderi, siç ndodh jo pak këtjpari. Ai shkruan me qartësinë e vetëdijes e atij që ka kryer detyrën ndaj vendit, vetes e të tjerëve, por se aspak me supremacinë që mund të rrjedhë nga kjo. Ai kupton më së miri se rolet e individit në shoqërinë moderne nuk janë statike. Pa kurrfarë petku heroizmi, poezia e tij dëshmon se kontributi i djeshëm nuk mund të legjitimojë abuzivizmin apo apatinë e sotme.

*s'merremi me të
e as në ëndrra nuk e shohim më
quhet liri*

Kjo antifrazë shpall ligështinë e humbjes, të çuarjes dëm të idealit që frymëzoi e mobilizoi një popull. Nën petkun e ironisë kritike, sarkazmës, vënies në lojë lexojmë edhe thirrje të tilla si tek poezia “tërmeti”.

*në pritje të ankthshme
stivojmë mungesë
dridhjes shkundjes rëniesh ngritjesh
dhe pyesim
kur do të ketë tërmet*

Duket se nënteksti nuk lë shumë vend për dyshime. Më mirë një tërmet sesa apatia që është një morfinë me rrezik të lartë për emancipimin, zgjimin, ndërgjegjësimin shoqëror. Poeti nuk gjen paqe. Tek poezia “a u gëzuan” ai na vë përballë tëhuajësimit të tij me bashkëluftëtarët, apo disa prej tyre. A fituan? – pyet ai. Një pyetje therrëse bashkangjitur asaj “A u rritën?”. Ai nuk e fsheh se i dhimbset ky popull foshnjë, i dhimbset atdheu i mbrojtur nga luftëtarë të parritur. Për të është fare e qartë se jo forca e muskujve, e pushkëve, e granatave por ajo e zemrës dhe e mendjes është sfida e njeriut të lulëzuar. Dhe tek vjersha “e shikon” lexojmë zgjimin, ndoshta pranimin se kanosja e përbashkët e nevoja për t'i bërë rezistencë saj mund të na vëllazërojë për një çast, ama liria na kthën në “shpellën” tonë:

*e shikon
si vdesin betejat
vdes përralla miti legjenda
vdes edhe heroi profeti zoti njeriu
e kaluara
e ardhmja
vetëm e tashmja të ngelet
dhe vetja në kuvli*

I flet vetes pasi tani nuk ka më dyshim që kështu ndodh në ekzistencën e njeriut, njeriu mbetet përballë vetes. Me vargjet “kujdes/ është kohë e njëtrajtshme” duket se ka bërë paqe me veten, jo pse ai është një prej atyre që konformohen, por ai e do dritën e diellit dhe e sheh jetën, njeriun, në sy. Dhe tani që edhe të gjitha këto i njeh më mirë, ka shtruar një rrugë tjetër, pa tatëpjeta e përplasje me veten. Është koha për paqe me veten.

Së fundi, dy fjalë për “Mirina” si idili dashuror që e mbart autorin tek gjuha e shpirtit dhe gurra. Elementët kozmogonikë të poezisë së traditës, dielli-diejt, hëna, yjet gjejnë aty shtratin e tyre. Po ashtu shtate palë male/ shtate palë diej/ shtate palë ëndrra/shtatë zana, etj. na çojne tek përsosuria e ndjenjës. A nuk ishin shtatë ditët në të cilat Zoti krijoi botën? E tash një zot po aq hyjnor ndërton një buronjë ku të lahet një tru, trup e shpirt i ngacmuar keqazi nga fanepsja e fantazmat e dashurisë.

*sa ra muzgu vetull hënë
tej retinës ç'm'u ngatërrua
një profil përngjasim zane
gjurmë e vjetër m'u hepua
si t'ia bëj i ziu unë
po i fola bie në gjumë*

Të njëjtin mjedis e nota që gjejmë tek rapsodi dhe tradita gojore na e jep edhe leksiku ku ndeshim fjalë apo togfjalësja si “*xhan/ mor aman/heq trurin/harkoi vetullën*”. Vargu “*të gjithë e panë e askush s'e njohu*” përmes antitezës na sjell ndërmend një tjetër varg nga “Martesa e Halilit” tek Eposi i Kreshnikëve “*fort po shndritë njaj diell e pak po xe*”

Po ashtu, ky cikël na ndërmend vargje ku Halili u përshkruan Tanushën agallarëve të Jutbinës: *Vetulla e saj ndrejt si fiskaja/Shteku i ballit si shteku i malit/Kur merr hana me pranue/ Syni i saj si kokrra e qershisë,/ E ka qerpikun si krahi dallndyshës,/Ftyra e saj si kuqet molla nidegë...*

Nga gjuha e kursyer, ironia, apo poetika e litotës që vihet re në katër ciklet e tjerë, tek “Mirina” gjuha poetike merr trajta të harlisura e të begata. Kjo vajzë e ka shuplakur krejt, por gojën nuk ia ka mbyllur, përkundrazi.

*a jam në ëndërr apo ëndrra vetë
nga cila botë më vjen kjo melodi
lirës kush i bie cili mbret
është sundues në këtë harmoni?*

Dashuria e ka rimodeluar botën për poetin. Madje, më mirë të themi që ai ndjen se u lind në atë çast fatal ku “*veza kozmike*” u ça. E kujtuam eposin me epiko-lirikën e vet grishëse për autorin, por vargje si këto më poshtë përforcojnë fillin përshkues të gjithë vëllimit. Zëri poetik i Dan Ibrahimit është i pangjashëm. Ai buron nga ekstaza krijuese kur autori ka arritur të dëgjojë e transfigurojë në art zërin e tij më të thellë. Kuptohet, ai nuk e gjëmon pas poezinë. Ai pret me durim dhe tek feks e rrëmben. Jo si cub, por si kavalier.

*befas shkrep plot madhësi
veza kozmike drita e fillesës
eurinoma diku në gjithësi
ia krihte flokët Mirinës mbesës
yjet përreth i këndonin pa pra*

Ai nuk di të dojë përgjysmë. Kur Kupidi i lëshon shigjetën, vendi ku ajo ngulet do të mbetet i shënuar përgjithmonë. Edhe këtu na shfaqet rebel. Në një botë ku konsumerizmi i ka gërryer çdo ind jetëgjatësie dashurisë ai duket modern bash për anën vintage të qasjes së dashurisë. Si qëmoti: O gjithçka, o asgjë! Por, përsëri lufta. Duket se me të nisin dhe mbarojnë shpresat e poetit, në planin shoqëror por dhe atë personal:

*të yshtur nga djalli me flamur të zi
erdhën dalë bese fise endacake
botën që rritej në harmoni
e ndoqën dhe e dogjën në ecejake*

Asgjë e mirë, që e përkundëm, mëkuam e rritëm me aq përkujdesje nuk ikën. Kur nuk është më ajo jeton si mungesë. Kështu ndodh për poetin:

*nga erdhe ti cila re të solli
kush të zgjoi nga gjumi mitik
të panë në Trojë si vorbulla të mori orakulli
tha: syri kozmik
mijëvjeçarët ikin mbesin vetëm numra ndërsa
ajo kthehet nga kohërat e përgjumura*

E megjithatë, dashuria e vërtetë nuk të mban peng. Ajo të fal liri, zgjim, shpengim. Kështu e shohim edhe Mirinën, heroinën lirike që endet si ëngjell mbrojtës në universin gri e të zhveshur, por jo të dëshpëruar të poetit.

*një zog më trokiti lehtas në dritare
thashë nga përralla në tokë rashë
hapa dritaren dhe... çfarë të dëgjoj
Mirina jam tha zogu dhe fluturoi*

Të gjitha vjershat janë shkruar më të vogla dhe pa shenja pikësimi. Siç ka emancipuar veten në rrugëtimin e tij si njeri, poet e ish luftëtar, po ashtu ai i shpërthen konvencionet gjuhësore për të mbërritur tek kuintesenca. Në këtë rrugëtim ai na bën bashkëudhëtarë. Gjatë leximit secili mund të rishkruajë një tekst pa imponime shenjash pikësimi duke i veshur atij kuptime e sfumatura që vijnë nga përvoja dhe përjetimet personale.

Së fundmi, do të shtoja se Dan është një njeri dhe poet jashtë kornizave, në kërkim të idealit poetik që duket se me këtë vëllim e ka mbërritur. Si një i zhgënjyer nga aftësia e njeriut për ta ruajtur njeriun brenda vetes, sidomos kur në emër të integritetit të tij është derdhur gjak e janë shkretuar jetë, ai na jep një model të përkorë të sublimimit të jetës përmes artit. Sikur jeta të mjaftonte, ndoshta ai nuk do t'i avitej kaq pranë honeve të thepisura të krijimit. Ndoshta. Sepse ai mbetet njeriu që luftoi për njeriun. Ai është së pari njeriu dhe pastaj poeti Dan Ibrahim.

MBI KOMEDITË E ZHDUKURA TË SANTORIT

Nga Prof. Dr. Klara Kodra

Vitet e fundit, në saje të zbulimeve të reja të studiuesve arbëreshë dhe të ndihmesës nga studiuesit e Shqipërisë, një autor i konsideruar për një kohë të gjatë si minor, meqenëse njihej në thelb vetëm me një përmbledhje vjershash lirike dhe një dramë (edhe ato të pastudiuara thellë) iu imponua gjithnjë e më tepër vëmendjes së shkencës letrare.

Ai u shfaq si nismëtar gjinish dhe llojesh të reja në letërsinë arbëreshe dhe shqiptare, konkretisht si tragjediani i parë, lëvruesi i parë i melodramës, komediografi i parë, autori i parë satirik, romancieri i parë, një fabulist tepër origjinal.

Pra, nga autor periferik, siç ishte quajtur, u spostua gjithnjë e më afër qendrës, duke dëshmuar se ua kalonte në vlerë estetike disa shkrimtarëve italianë dhe kalabrezë bashkëkohës, si edhe shkrimtarëve të atdheut të origjinës që e pasuan në llojet dhe gjinitë që themeloi.

Nga një letër drejtuar De Radës që ndodhet në Arkivin e Shtetit mësojmë që Santori ka qenë edhe autor komedish të tjera, përveç atyre të dyjave të zbuluara së fundi (“Kalogrea karroqare” dhe “Polikarpi”) për të cilat kemi folur në monografinë tonë të botuar tani vonë “Santori poet dhe dramaturg” (Tiranë, QPSA, 2020).

Letra në fjalë ndodhet në AQSH, Fondi 24, Dosja 54/9, fl. 23. Është shkruar në Shën Katerinë më 20 gusht 1869.

Ajo u botua për herë të parë nga studiuesja e njohur santoriane Merita Sauku Bruci që më 2012 (konkretisht te “Studime Filologjike”, 1-2, 2012) në artikullin tepër interesant “Evolucioni i sistemit alfabetik të F.A.Santorit, çelës për përcaktimin e kohës së hartimit të veprave të tij”.

Teksti i kësaj letre është ky (e kemi përkthyer nga origjinali italisht):

“Tani po hedh në të pastër (komeditë - shën. K.K.) që t’jua dërgoj juve dorëshkrimet. Do të vihen në skenë në vendlindjen e të lartpërmendurit mik (një mik i përbashkët arbëresh - K.K.), ku ka një teatër, një shoqëri mediokre diletantësh. Po të kenë sukses mendoj se do të bëhem komediograf në pleqëri. S’e besoja se kisha fuqi sado të vogël në këtë zhanër, po këto krijime të befasishme dhe të shpejta më thanë të kundërtën, aq më tepër se kam arritur t’u jap mishërim, veprim dhe unitet dramatik ca fakteve të vogla të parëndësishme dhe qesharake. Titujt e tyre janë “Cubi, vengërosh i remë”, “Hajduti mik apo kryepriifti i fshatit”, “Qilarxhiu”, “Mashtrulesi i mashtruar”, “Zilqiqari ose i pasuri i varfëruar”.

Mos besoni se janë në vargje, janë në prozë.

Po qe se Zoti do të më japë ca kohë të qeta, do të mund ta provoj veten dhe në vargje italisht ose arbërisht”.

Cilat përfundime mund të nxjerrim nga kjo letër?

Së pari, që komeditë e zhdukura nuk kanë mbetur projekte, madje që me siguri ato ishin të përfunduara në gusht 1869 (një nga periudhat më frytdhënëse në krijimtarinë e këtij autori) dhe Santori po i hidhte në të pastër.

Së dyti, që autori kishte vendosur të ndërmernte lëvrimin e një lloji të ri, komedisë. Ai i shihte komeditë si të realizuara dhe kishte besim, pas një stepjeje të fillimit, në aftësitë e veta krijuese.



Mandej shohim diçka edhe më të rëndësishme: Santori kishte vendosur t'i shfaqte në skenë, qoftë edhe në një shoqëri diletantësh. Nuk e dimë në se ky projekt u realizua, me gjasë jo, po autori shpreh qartë dëshirën për të komunikuar me publikun arbëresh.

Këto komedi duhet të jenë shkruar para “Kalogresë karroqare” dhe “Polikarpit”, meqenëse siç thotë Santori, janë në prozë, jo në vargje si dy të tjerat dhe ai pohon se do t’u drejtohet vargjeve më vonë po të ketë qetësi shpirtërore dhe frymëzim. Ndryshe nga dy komeditë e zbuluara, janë të përfunduara.

Temat që trajtohen aty, po të gjykojmë nga titujt, janë tema e cubërisë, tema e kopracisë, tema e vjedhjes dhe hipokrizisë, tema e demaskimit të klerikëve pijanecë që nuk i qëndrojnë besnikë detyrës së vet fetare, po janë skllëvër të veseve të tyre, tema e mashtrulesit të mashtruar, e pasanikut të varfëruar, tema e zilisë, të gjitha tema këto, sociale dhe etike që i ndeshim edhe në “romancetat”, satirat dhe fabulat, madje edhe në romanet, pra, tema që rikthehen në forma të ndryshme në krijimtarinë e Santorit, në plan dramatik ose komik.

Nga titujt e lartpërmendur mund të supozojmë gjithashtu se është fjala për komedi karakteresh ku demaskohet protagonist. Në fakt kështu ndodh te “Kalogrea karroqare” dhe “Polikarpi”. Mund të jetë fjala edhe për komedi zakonesh meqenëse pasqyrimi i zakoneve arbëreshe, madje etnografizmi përbën një konstante në krijimtarinë e Santorit.

Lëvrimi në prozë mund të lidhet me dëshirën për të komunikuar me një publik sa më të gjerë.

Autori mund të jetë frymëzuar nga realiteti i fshatit siç pohon edhe vetë, pra nga fakte reale siç ndodh edhe te “Emira”, Santori nuk kopjonte realitetin, po shndërronte të zakonshmen në artistike dhe ishte i vetëdijshëm për këtë.

Në monografinë tonë të lartcituar e kemi lënë jashtë çështjen e këtyre komedive, meqenëse është fjala për tekste të zhdukura që gjer më sot s’janë gjetur. Mbase kemi vepruar drejt, mbase jo.

Po të gjenden në bazë kërkimesh të mëtejshme (në arkivat private të arbëreshëve në Picilje, vendlindjen e autorit, në Shën Japk, fshatin ku vdiq, madje edhe në Bibliotekën Mbretërore të Napolit, vend ku ai botoi ndonjë vepër) lind problemi i krahasimit të tyre me komeditë tashmë të njohura në vargje, krahasim nga pikëpamja e problematikës, e vlerës artistike, e vendit që zenë ato në tërë dramaturgjinë e Santorit.

Ato do të mund të hidhnin më tepër dritë mbi Santorin komediograf.

Muzika e Mozartit të mahnit. Shpesh, emri i tij është sinonim me atë të një gjeniu muzikor dhe me gjasë, është kompozitori klasik më i njohur ndonjëherë. Prodhimtaria e tij muzikale dhe jeta e jashtëzakonshme, duke përfshirë dhe aftësinë muzikore, kanë qenë objekt i shumë studimeve, librave, dokumentarëve dhe filmave. Fëmijët gjenialë të muzikës klasike nuk janë të paktë: Bethoven, Brahms, Saint-Saëns janë tri fëmijë gjeni të tjerë të njohur. Jeta veçanërisht e shkurtër dhe e re e Mozartit ka qenë po aq “rock’n’roll” sa ajo e Majkëll Xheksonit, i cili ndonëse në botë tjetër muzikore, ka mjaft ngjashmëri me kompozitorin austriak. Në moshën kur fëmijët ende mësojnë si të shkruajnë e lexojnë, Mozarti ishte duke bërë turne dhe dihet se para moshës 10 vjeçare, kishte kompozuar më tepër se mjaft kompozitorë gjatë jetës së tyre, përfshi këtu dhe simfonitë e tij të para.

E gjithë kjo e bën atë të admirueshëm për të tërë, veçanërisht për ata që nuk janë muzikantë, tek të cilët talenti i tij mbetet një mister, gati hyjnor. Për muzikantët ama, për ata që e kuptojnë gjuhën e muzikës, ai mbetet goxha magjepsës, e më pak hyjnor. Por atëherë, çfarë e bën Mozartin kaq tërheqës tri shekuj pas vdekjes, dhe më shumë se kompozitorë të tjerë të suksesshëm?

Shumë aspekte të jetës së Mozartit kanë kontribuar në formësimin e legjendës mbi personan e tij, si fillim me emrin: Johannes Chrysostomus Wolfgangus Theophilus Mozart, njohur ndryshe si Wolfgang Amadeus Mozart, Amadeus, mik i Zotit, ai që e do Zotin.

Së dyti është aspekti i një fëmije gjeni; i ati i tij, kompozitor, muzikant dhe mësues, ia dalloi talentin Mozartit dhe së motrës qysh herët në fëmijërinë e tyre, dhe shpejt i shndërroi të dy në muzikantë madhështorë, duke i futur që të rinj në një jetë me praktika muzikore, turne dhe kompozime. Thuhet se kompozimin e parë Mozarti e bëri kur ishte katër vjeç, dhe deri në moshën tetë vjeçare kish’ shkruar simfoninë e tij të parë.

Gjithsej, Mozarti kompozoi mbi gjashtëqind punë në tridhjetë e pesë vite jetë. Edhe vdekja e tij ka qenë shpesh e mitizuar, veçanërisht në kontekstin e punës së tij të fundit; një rekuem, një muzikë liturgjike për të vdekurit, e pambaruar dhe e porositur në fshehtësi.

Pastaj nga ana tjetër, sigurisht që është Mozartit me personalitetin e tij ekscentrik; me (atë që do të quhej sindroma e Piter Panit) sjelljen e tij fëmijërore dhe gati trazovaçe, në kontrast me muzikën e tij hyjnore dhe që është portretizuar kaq shkëlqyer në filmin “Amadeus” nga Milos Forman.

Fama e Mozartit u theksua edhe nga pasardhësi i vet, vetë Bethoven, një tjetër gjeni muzikor, me adhurimin dhe mbështetjen për muzikën e tij. Kompozitori gjerman pesëmbëdhjetë vite më i ri se Mozart, ndoqi hapat e tij...

Megjithatë, kur dëgjojmë me vëmendje muzikën e Mozartit, mbresat janë më se të ndryshme. Po, është muzikë e shkëlqyer, e kompozuar në mënyrë fantastike, e ekuilibruar, elegante, reflekton personalitetin e vetë kompozitorit dhe të kohës që ka jetuar, por në krahasim me gjeni të tjerë të akademisë muzikore, si për shembull Bethoven sërish, është shumë e thjeshtë, gati përsëritëse, me strukturë të ngjashme dhe me ide e mjete muzikore të ndërfutura përmes pjesëve.

Përfundimi është i thjeshtë, ndonëse gjenial. Mozarti nuk mund të shihet si ai që krijoi rregullat, siç bëri Bach, apo një revolucionar si Bethoven. Thënë ndryshe, Mozarti nuk shpiku apo rishpiku rrotën; ai e vuri në punë dhe e drejtoi atë, dhe e ka bërë pa diskutim shkëlqyeshëm. Nëse duhet shembulli i një kompozitori që përdori rregullat dhe traditën muzikore të kohës siç duhej, ai është shembulli vetë.

PSE JEMI ENDE KAO TË MARROSUR PAS MUZIKËS SË MOZARTIT? ÇFARË KA MOZARTI?

Nga Doug Thomas

Përktheu Jola Tasellari



Kush dëshiron të kuptojë çfarë është muzika klasike, ajo e periudhës klasike, atëherë duhet të dëgjojë Mozartin dhe vetëm Mozartin.

Përgjatë paragrafëve është e pamundur për të mos e vlerësuar rolin e Mozartit në zhvillimin e zhanrit të operës përmes sjelljes së subjektit dhe temave të njerëzve të thjeshtë dhe shoqërisë, larg mitologjisë dhe njeriut urban të koncerteve, përmes gjetjes së ekuilibrit ideal mes orkestrës dhe solistit, brenda trajtës së sonatës.

Pra, pse është muzika e Mozartit kaq e famshme? Epo, për të njëjtat arsye që është e famshme edhe muzika e Bob Dilanit; është e thjeshtë, e kuptueshme, e arritshme, e njohur dhe trajton ide që i prekin të gjithë, për shembull operat e tij. Ajo nuk synon progresin muzikor dhe risitë duke e nxjerrë dëgjuesin nga zona e vet e rehatisë. Është melodioze dhe melodija është çelësi i muzikës simfonike. Së fundmi, ka interes muzikor. Pas kësaj thjeshtësie të dukshme, Mozarti do ta stërpikte muzikën e tij me ca befasi muzikore e kthesa. Ai është më se i njohur për përdorimin e teknikës së kromatizmit në kohën kur kjo ende konsiderohej si disonancë, dhe vetëm dy shekuj më parë, Charlie Parker dhe Dizzy Gillespie, e përdorën si themelin e krijimit të xhazit bebop!

Në pritjet mondane në Paris nuk ishte e lehtë të kuptoje që me herë të parë se sa nga të pranishmit hynin me ftesë dhe sa ia dilnin të hynin pa ftesë.

Me kalimin e kohës, falë ngjashmërisë së marifeteve të hyrjes pa ftesë, apo me ftesë fallco, me fare pak vëmendje, ti mund të kuptoje se bëhej fjalë gati për një komunitet të qëndrueshëm, përbërë kryesisht nga aristokratë apo personalitete të rënë vafti, ish- nëpunës dalë në pension, apo gjithfarëlloj hallexhinjsh, të cilët, përveç ndjenjës së përjetshme njerëzore për protagonizëm që të ofron prania në qarqet mondane të kryeqytetit të dritave, kanë njëkohësisht mundësinë të ushqehen me bollëk e me cilësi.

Por pavarësisht ngjashmërisë së taktikave për hyrje pa ftesë, dukej qartë se ky komunitet mondan ishte i përçarë. Kjo buronte thjesht nga konkurrenca për të hyrë në pritje.

E përmbajtur në dukje, një konkurrencë jo më pak e ashpër niste që para hyrjes së jashtme të

pritjes, pra aty ku bëhej dhe kontrolli i ftesave, ku një turmë modeste mondanësh hallexhinj, d.m.th.pa ftesë, bëjnë sikur presin dikë, por në të vërtetë rrinë aty për t’iu ngjitur, si rastësisht, dikujt me ftesë. Modalitetet e ngjitjes dikujt me ftesë ishin pak a shumë të njëjta: ai, mondani pa ftesë pra, afishonte në fytyrë një buzëqeshje të çiltër, i afrohej krejt spontanisht dikujt që mbante ftesë në dorë dhe, mu pranë hyrjes ku kontrolloheshin ftesat, i drejtonte bashkudhëtarit me ftesë ndonjë pyetje koti, bie fjala:«*bah, pa të shohim se në ç’krah do e kenë vendosur garderobën kësaj radhe...*», dhe kur i ftuari mund të përgjigjet me mirësjellje se «*besoj do jetë në krahun e djathtë*», atëherë mondani pa ftesë lëshonte një të

qeshur me zë të lartë dhe thotë, «*bah, sinqerisht unë po mendoja se do ishte në të majtën*», duke mos i lënë kështu asnjë dyshim rojave në hyrje se të dy zotërijtë kishin ardhur bashkë në këtë pritje mondane dhe s’ka pse t’u kërkohej të dyve ftesa, pasi në hyrjet e pritjeve mondane ka aq shumë njerëz sa që mondani ka kohën e mjaftueshme të verë buzën në gaz dhe të lëshojë pyetjen e tij të kotë mu pranë kontrollorit të ftesave.

Me individët pa ftesë të seksit femër, ndodhte ndryshe,ato jo vetëm toleroheshin nga konkurrentët për të shkelur radhën, porse edhe pa këtë privilegj, rojat e pritjeve e respektojnë zakonisht seksin e dobët.

Por ndodhte që, për të eliminuar krejtësisht konkurrencën, ndokush bënte edhe hile.

Me qëllim që t’i shmangej radhës së vendosur heshturazi në komunitet, hileqari avanconte dhjetra metra para hyrjes, për t’iu ngjitur si rastësisht cilitdo individ të veshur shik, përfshirë edhe atyre që s’mbajnë ftesë në dorë. Përveç pabesisë ndaj shokëve të tij, pra të shkeljes së radhës, kjo mënyrë veprimi mbarte në vetvete edhe rrezikun që ti mund t’i ngjiteshe dikujt kot, pra, që nuk kishte asnjë lidhje me pritjen dhe qëllonte t’i binte aty rruga rastësisht. Në këto raste, mondanit hileqar i dilte mundimi huq.

Dhe, së fundi, duhet thënë se kishte edhe një tjetër takëm hallexhinjsh që nuk e duronin dot hipokrizinë, d.m.th. ngjitjen gjoja spontane mbas të ftuarve, por, në mënyrë të hapur e të sinqertë, atyre që dilnin shpejt nga pritja, i pyesnin se mos rastësisht, e kishin ftesën me vete.

Kjo mënyrë e drejtëpërdrejtë i prekte ata që e kishin ende ftesën në xhep dhe pranorin me mirësjellje. Mondani hallexhi, me të marrë ftesën në dorë, merrte pamje dinjitoze dhe hynte në pritje siç ka hije, gjë që i jepte atij më pas edhe sigurinë për të hyrë krejt i barabartë në bisedë me diplomatë apo personalitete të larta.

Është e tepërt të thuhet që kjo konkurrencë fashitej krejtësisht kur bëhej fjalë për ndonjë të moshuar, që mezi mbahej në këmbë dhe që dukej sheshit se ishte i sëmurë. Në të tilla raste, të moshuarit i lihej hapësira e nevojshme, d.m.th. lejohej nga grupi të hyjë pa radhë e, me t’u shfaqur dikush me ftesë në dorë, ai të kishte mundësi t’i ngjitej menjëherë mbrapa e të hynte spontanisht në bisedë me të.

Këtë kontigjent e hasa që në pritjen time të parë në një ambasadë latino- amerikane, në hyrjen e së cilës m’u afrua një grua e moshuar kockë e lëkurë, dhe me një fytyrë mbuluar nga një tepri kremërash mu drejtua me një zë të njomë:

Botuar në *Le Monde Diplomatique*

Përpyjekjet e mundimshme të hyrjes pa ftesë në pritjet mondane në Paris

Tregim nga Ylljet Aliçka



- Zotëri, më falni, por unë do desha të hyj në pritje në shoqërinë tuaj, pasi... pasi kam harruar ftesën time në shtëpi.

- Patjetër zonjë, - pranova unë.

Por, papritmas, aty pranë kërceu një tjetër grua e moshuar:

- Bah, zotëri, zonjëza po shfrytëzon pa skrupull mungesën tuaj të përvojës në fushën e mashtrimit me ftesa. Çfarë harrese! Zhënevievë, pse s’thua të vërtetën?! Po kush i dërgon asaj ftesë, zotëri?!

Zonja, që sapo kishte hyrë në shoqërinë time, ia ktheu aty për aty:

- Mjaft tani, Bernadetë, nuk të takon ty të flasësh në këtë mënyrë. Unë thjesht po kërkoj një gjest mirësjelljeje nga zotëria dhe ti s’ke pse përzihesh.

Tha kështu dhe më futi natyrshëm krahun e saj të hollë.Hymë brenda dhe unë nuk e mora vesh nëse zonja me emrin Zhënevievë fliste me vete, apo e kishte me mua tek mërmëriste:

- Zot, sot ka humbur krejt mirësjellja... Në kohën tonë nuk ndodhte kurrësi kjo gjë... - thoshte ajo dhe e revoltuar tundte kokën e saj të vogël.

Zonja nuk priti të miratoja ato që thoshte, por sapo hymë brenda, shkëputi krahun nga mua dhe pa asnjë hezitim u hodh e babëzitur në drejtim të tavolinave.

Në dalje Zhënevieva mu afrua përsëri dhe pasi më futi natyrshëm krahun më prezantoi me një burrë të shkurtër, i cili më buzëqeshi ngrohtë dhe tha:

- Zotëri, le të prezantohemi, unë jam gazetar në profesion të lirë, dhe sot kam harruar...

- Ftesën – kërceu e moshuara.

- Pikërisht - tha, gjithnjë i qeshur, - pra, ndofta e keni ende me vete dhe...

Nuk e lashë të mbaronte, i dhashë ftesën

time, ndërsa ai më falenderoi duke u përkulur thellësisht dhe më la në dorë një kartëvizitë, ku shkruhej emri “Frank - gazetar i lire”.

Franku më telefonoi pas dy ditësh:

- Siç duhet të jeni në dijeni, sot e ka Spanja.

Do vini besoj?

- Po, i thashë.

- Shihemi para pritjes dhe shkojmë bashkë, - tha ai krejt natyrshëm.

- Ftesa është personale - iu përgjegja menjëherë.

- S’ka problem, - tha, - edhe po më kthyen unë nuk kundërshtoj, dal vetë. Por e kam, si të themi, fiksime këtë ftesë. Dhe a e dini përse?

- Jo, - i thashë.

- Jam i detyruar t’ju them një intimitet, dua të kapërcej, si të thuash, rekordin e vjetshëm, ku munda të marr pjesë në 92 pritje.

- Po këtë vit sa keni kapur? – u bëra kureshtar.

- Aty te 72- shi, por ka ende kohë, deri në fund të vitit janë një sërë pritjesh ambasdash të vogla, të cilat mezi presin t’u shkojnë njerëz, pasi, të flasim hapur, nuk është se i përfill njeri. Veçse, për hir të së vërtetës, duhet pranuar se aty ka më shumë bollëk.

U kujtova për një tjetër pritje të nesërmen në UNESCO, ku mund t’i jepja një ftesë, pasi kisha dy të tilla.

- Bah! - tha Franku, - UNESCO ka rënë mjaft.Ka kohë që aty s’ia vlen mundimi i rrugës. Si është, tek apo çift?

I thashë çift dhe ai psherëtiu i lehtësuar. Të nesërmen Franku më priste para pritjes së UNESCO- s në krah të një mesogruaje, të cilën ai ma prezantoi si një mikeshë të tij, dhe me të marrë ftesën u fut brenda duke e mbajtur atë në mënyrë demonstrative.

- Oh, po ky është kulmi, - m’u afrua mikeshja ime e moshuar, - ky xhuxh, veçse po

na hap probleme duke na sjellë çdo natë nga një zonjë, me shpresë se do gjejë grua duke e joshur me ftesa kallpe. Ka mbledhur në shtëpi një koleksion të tërë ftesash nga vitet e kaluara, - shpjegoi zonja, - dhe hyn me to në dorë nëpër pritje festash, duke fshehur si rastësisht atë pjesë të ftesës, ku duket viti dhe lë t’I duket vetëm pjesën, ku duket flamuri kombëtar I vendit përkatës. Natyrisht që gratë nuk e dinë këtë marifet dhe pranojnë shoqërinë e këtij buburreci, i cili bën karshillëk, sikur bën pjesë në listat e të ftuarve të vërtetë. Për ne që e dimë të vërtetën, ai pretendon se vjen nëpër pritje mondane, për shkak se nuk e duron dot vetminë. Por të gjithë ne e dimë se ai thjesht kërkon të gjejë grua, duke dashur kësaj t’u dëshmojë atyre klasin e tij të lartë. Veçse gratë ia pijnë menjëherë lëngun, sapo futen në pritje e, pasi dënden mirë, nisin e hargalisen me ndonjë mashkull simpatik, kurse Franku na bën be e rrufe se nuk do i ftojë më.

Në pritje Franku m’u afrua dhe më prezantoi një bullafiq, i cili, pas një bisede jo më të gjatë se dy minuta, mori një pamje konspirative dhe pyeti me zë të ulët:

- Zotëri, përfitoj nga rasti për t’ju pyetur nëse vendi juaj do ishte i interesuar për të blerë me çmim të arsyeshëm, për të mos thënë falas, disa armë të sofistikuara.

- Jo, faleminderit, - i thashë.

- Gjithsesi, nëse nuk jeni kundër, i shkëmbejmë kartëvizitat, nuk i dihet, - tha, - më vonë mund të ndryshoni mendim. Mori kartëvizitën dhe u largua me po atë pamje konspirative.

- Bah, tha Franku, - me t’u larguar zotëria, - s’hoqi që s’hoqi dorë nga ky marifet, unë I bëj nder e prezantoj me Ju, ai rropatet të lerë përshtypjen se është i shërbimeve të fshehta dhe të sigurojë ftesa. I ka dalë boja, të gjithë e dinë se nuk ia var njeri, as shërbimet e fshehta, as ato jo të fshehta. Ç’nuk i pjell mendja qenies njerëzore për të kapur një ftesë! - psherëtiu Franku.

Frankun nuk e pashë nëpër pritje për një kohë të gjatë.

Gati gjashtë muaj më pas m’u shfaq para hyrjes së një pritjeje kishtare. Ishte i vetmuar, me fytyrë të zbehtë. Më qeshi me dashamirësi, më futi krahun dhe ne hymë në pritje si dy miq të vjetër. Me të hyrë brenda, Franku i hodhi një sy të shpejtë tavolinave dhe, pasi më tha një falemnderit të thatë, u drejtua menjëherë nga tryeza me ushqime. Hante i uritur si

një urith ndër pjatat e pakta dhe kthente me shumicë gotat me shampanjë.

Përballë zellit të tij të tepruar për alkool, famullitari i kishës që shërbente në pritje, tregoi kujdes të mos nxirrte më nga sirtaret shishe shampanje,

- Më vjen keq, shampanja mbaroi! Shpalli famulltari.

Franku pranoi përunjësisht dhe u largua pa folur.

Të nesërmen mbrëma më telefonoi zonjëza e moshuar. Pasi më dha lajmin e hidhur se Franku kish ndërruar jetë dhe se kështu e ka jeta, më kërkoi mos kisha ndonjë ftesë për pritjen e portugezit.

- Si na la Franku? Pse? - u befasova unë.

- Ndërroi jetë, pa njeri te koka. Megjithë ato favore që u kishte bërë grave, asnjëra për bé s’iu ndodh pranë... Iu preftë shpirti asaj krijese të vetmuar! E pra, të thuash se i kishte munguar trajtimi i mirë.

- Ç’trajtim?

- D.m.th. trajtimi ushqimor cilësor... E kam fjalën, nga pritja në pritje. Veç meje në varrim nuk kishte as një nga gjoja miqujtë e pritjeve mondane apo atyre bishtdredhurave që ai I kishte futur nëpër pritje me shpresë se do martohej një ditë.

Para hyrjes së pritjes së portugezit zonjëza më kërkoi ftesën dhe pasi ia dha dikujt, më mori për krahun dhe nuk ma shqiti, derisa kaluam hyrjen ndjekur nga vështrimet xheloze të grupit kundërshtar.

Me të hyrë brenda, ajo mori shprehjen e asaj që revoltohet thellësisht me disa njerëz dhe më pëshpëriti në vesh: Bah çqenie të çuditshme!

- Kush? - e pyeta.

- Ata tek hyrja, presin gjithë ditën para pritjeve të ambasadave, me shpresë të njohin dikë që do t’i futë brenda, dhe kur nuk vjen njeri kthehen në shtëpitë e tyre, për të verifikuar festën kombëtare të radhës.

Tha kështu dhe tundte kokën e habitur me natyrën njerëzore.

GRATAÇIELA TË NJU JORKUT

grataçiela të nju jorkut
poshtë jush lëvrinë si mizat e dheut
njerëzit e kasolleve dhe barakave
që vijnë nga e gjithë bota
vij dhe unë nga një shtëpi përdhese prej
qerpiçi
që e fuste shiun brenda
dhe e mblidhte nëna
në legenë e tenxhere që i vinte mbi
shtretër e dysheme
vijnë gjysh stergjyshërit tuaj, grataçiela
se në themelet tuaja tendat e indianëve
lekurëkuq u ngritën
vigvamet, kasollet prej balte e kallami
prandaj erdha dhe unë, që nëna t'i thoshte
plaç varfërisë!
po s'ma shpëtove dot, ajo kishte shpresë se
do ta shëronin mjekët amerikanë,
vdiq pa ju parë
i merreshin mendtë kur ngrinte sytë lart
dhe s'i çonte dot gjer në majë
se i vinte për të vjellë
do dalim, nënë, të shohim manhattanin?
jo, bir, s'kam sy
s'jam fajkua apo skifter që t'i arrij ato kulla
të larta
nëna i do, po zemrën e ka te ajo shtëpi
përdhese prej qerpiçi ku ju linda
te ai varr i babait tuaj që mezi pres ta
përqafoj
dhe të kërcejmë tango si dikur
në lulishtet e verës!

grataçiela të nju jorkut!
kapelen e saj të rinisë me pendë zogjsh
po ua vë mbi kokë!
të mos i merren mendtë
të mos i vijë për të vjellë
të më duket nëna madhështore.

NATA AMERIKANE

dhe nata e futi qytetin në një thes të zi dhe
më la vetëm fillikat
ato vende ku linim takimet s'i kam
as makinën që e lashë nën drurët e parkut
s'e kam
vetveten shoh se kam sy të brendshëm
dua t'i bëj sy të jashtëm por diçka
s'funksionon
dhe pylli i vogël pas dritares s'është më
sytë e mi të papërsosur s'shohin në terr
amerika e teknologjisë duhet të bëjë diçka
patjetër
primitiv jam nga sytë
amerikë, ktheji sytë nga nata që e futi
qytetin në një thes të zi
e hodhi mbi shpinë dhe
iku
s'është plehrë nju jorku, amerikë
bëj diçka
krijo sy teknologjikë
po amerika s'është zoti
dhe ajo në zot
beson!

nata kthehet në agim dhe dorëzon nju
jorkun

KËRMILLI DHE AMERIKA

i erdhi keq një kërmilli
për amerikën
që s'merrte frymë nga vrapimi
e mori me vete
në pyllin e budës
te lutej
amerika
qesh

fillon festa!

AEROPORT

një aeroport gjigant dua të jem
të shoh pritjet
dhe lamtumirat
ndarjet dhe bashkimet e syve
se zemrat fshihen
një aeroport gjigant
të pres avionët e linjave
t'i shoh të gjitha ngjyrat e racave
fustanin dhe flokët me rica të afrikanit

GRATAÇIELA
TË NJU JORKUT

Cikël me poezi nga Roland Gjoza



sytë me bisht të kinezkave të holla
gajden e irlandezit dhe fustanellën e tij
pelerinën e kuqe të tibetianit me flokë të
lidhur bisht
dhe dai lamën të shoqëruar nga rojat e
sigurisë
dua të shoh vajzat e bukura dhe gratë më
të bukura se vajzat
kushedi shoh dhe veten time kur isha i ri
dhe ëndërroja të shkoja në amerikë
në vendin e drajzerit dhe uitmanit, emily
dickinsonit dhe bukowskit
një aeroport gjigant dua të jem
avionët kane diçka prej dashurisë së
madhe që bashkon tokën me qiellin
kushedi shoh nënën që zbret prej andej
dhe ma bën me dorë
ketu ndalem
s'jam më aeroport
po thjesht një roland i mbytur në lotë

FUQIA E DASHURISË

edhe dita më e keqe e ka një diell të vogël
nën qepallat e një gruaje të re që fle
edhe një udhëtim me tren manhattan
forest hills
kur mërzia të është bërë perandori
e ka një mundësi të vogël shprese
vetëm kaq të mendosh se në të gjithë
kopshitet
ka lulëzuar manushaqja e zezë midis
barishteve të egra
dhe kur një vajzë e bukur seksi futet në
vagon me një tufë lule
tingujt e shopenit të kujtohen dhe harron
melankolinë
edhe kur s'ke gjë për të ngrënë
dhe në shtëpi të presin lugët dhe pirunët
në sirtar
dhe pjatat e zbrazëta mbi njëra tjetrën
ke librat e tu që ende kanë zjarrin që s'fiket
për ty

2

të kam dashur më shumë se veten
në rininë e fortë si rrufeja
që i dogji ditët tona
me bukuri
të kam dashur, por më shumë të dua tani
që s'i shqiptojmë mirë fjalët se kemi vënë
proteza
dhe puthjet ngjiten në gropat e faqeve
s'ka më netë të zjarra
po zemra ende nxjerr flakë
të dua nuk shqiptohet
po ndjehet më e fuqishme në prekjet e
vogla

pa mish
po me kocka
në sëmundjet
ilaçet që harrohen
në shëmtinë që këmbehet me bukurinë
në kujtime
të dua
çmendurisht të dua
sepse e di që shpejt do të ndahemi
dhe lutem të shkoj i pari
dhe ti të mbetesh edhe për shumë vjet
harromë
aq shumë të dua
sa zotit i lutem
sa më shpejt
të më harrosh mua

3

jemi dy qenie të çuditshme prej libri
që u censurua
i fshehëm mëkatet
gëzimet
dhe urrejtjet
askush nuk i mori vesh çastet tona intime
një jetë plot gabime
një jetë që e shamë
një jetë që e dashuruam
një jetë që e mallkuam
dhe tani erdhi fundi
më tepër se kurrë
jemi të bashkuar
dy qenie të shëmtuara
që çuditërisht u afruam
kapemi për dore
shtrëngohemi
frika na ka dashuruar
s'puthemi
s'bëjmë seks
s'themi të dua
po flemë të përqaftuar
frika na ka dashuruar

NË NJU JORK NDODHI KJO

hapat e saj
apo hapat e hënës në times square
bethoveni po kalonte, ende s'e kishte
ngritur kapakun e pianos
në krah mbante gruan time nuse të re
maestro, i them, ç'po ndodh?
erdha të bëj dhe një herë dhëndër
po unë jam plak tani dhe ajo grua nuse
është shumë e re
si atëhere kur ktheheshim nga parisi
pas muajit të mjalitit
tani je në nju jork ku ndodh gjithçka
tha ai
ngriti kapakun e pianos, sikur ngriti

apokalipsin dhe zbuloi krijimin
gruaja ime e re dhe unë i ri
nuk vinim kurorë në tiranë po në
katedralen e shen patrikut në avenjunë
e gjashtë
ngjitur me rockefeller center
natyrisht ishte një ëndërr
u ngrita dhe lexova letrën që gruaja më
kishte ngjitur te frigoriferi
2 kg qepë, rrepka, sallatë
mos harro të marrësh vajzën nga shkolla
dhe një zemër e kuqe e bërë me buzë
në fund të letrës
më buzëqeshte.

SHOH SI IKËN DITA
NGA FYTYRA JOTE

shoh si ikën dita nga fytyra jote
ngjyrat, shndritjet, nuancat e holla
një rrudhëz aty, një rrudhëz këtu
në vendet ku të kam puthur
ndërroi dhe fjalori i ëmbël i emocioneve
me një fjalor të arsyeshem
zemra u shkëput nga zona e mesdheut
dhe po shkon drejt polit të veriut
aventura dikur aq e bukur
po quhet e ndaluar
eja, e dashur, të hamë një darkë te Belavy
ajo bën jo me gisht
eja, e dashur, të pijmë kafe jashtë
te kafenetë e lagjes metropolitan, te
italiani
ajo s'flet
më vështroi e menduar
shoh si po vjen muzgu ngadalë
muzgu blu
dhe na mbulon të dyve

PËRSËRIS GJESTE RINIE

përsëris gjeste rinie dhe s'e mbledh
mendjen
kur ti më thua; je i lojtur?
kurmi yt s'është më i freskët, po i
përjetshëm ka mbetur
për këtë budalla që të do akoma
për elizën e bethovenit ka plakje? i them
me përkëdhelje
ti je eliza
dhe nëse u shpik atomi
dhe bomba atomike u shpik, këtë e
ndihmoi dashuria
ti përsërit; ke lojtur?
po unë kaq dua
që ti të qeshësh me budallallëqet e mia
përsëris gjeste rinie

PLATONI

nga platoni erdhëm te frojdi
dy kundërshtarë të fortë
po më i fortë se ata ishte marks
që e mundi platonin me kapitalin
dhe frojdi mundi platonin me seksin
platon, më ndje
ndonëse dashurova në kohën tënde
si një naiv i pandreqshëm
frojdin doja
po s'më linte marks me kapitalin
tani ngjis shkallët në muzg, për te shkuar
në shtrat
të rinjtë dalin të bëjnë seks në klubet e
natës
më ndjek nëpër shkallë platoni plak
marks me pret te biblioteka e vjetër
s'i doli profecia e revolucionit proletar
pret të më hapë një debat për mbivlerën
teorinë e punës së papaguar
ai të drejtë ka
po më të drejtë ka frojdi
platoni hap dritaren dhe hidhet nga kati i
tetëdhjetë e shtatë
unë pi një mini aspirinë
dhe bie të fle
me një keqardhje të thellë per platonin
plak

KJO E DIELË S'DUHET
TË VINTE PA TY

kjo e dielë s'duhet të vinte pa ty
kjo e dielë kaq blu
nju jorku nuk është përgatitur për ndjenja

të mëdha
miliarderët
s'kujtohen për lule

mund të vinte e hëna kur shkoje në shkollë
e para
mund të vinte e marta kur blije bukën dhe
një shishe qumësht
unë t'i ndiqja lëvizjet e ti më ndieje me
hundë
po ishe kaq e statujtë
sa statujat e vërteta më dukeshin të gjalla
e mërkuara të shkëpuste prej buzëve
refrenin e një kënge të xhani morandit
occhi di ragazza
dhe bëheshe më e bukur
sa herë shikoja koncertet e verës italiane
në netët blu mediterrane
në romë, venecia, bari
i kisha zili këngëtarët
televizorëve tanë u vinin zhurmues
që asgjë të mos shikonim nga bota
perëndimore
po kishim një kanoçe që e fshihnim
llamba magjike e aladinit
natën lëviznim antenën të shikonim
telenorbën
që shfaqte filma me skena seksuale
e enjtja ishte braktisja e orës se mësimi
për të parë martesë italiane
me sofia loren dhe marcelo mastrojanin
të mos ishte italia çdo të bënim?
padyshim që do të çmendeshim
kudo daci bao dhe aksione revolucionare!
e premtja ishte me shi, kështu më kujtohet
e premtja e zezë, thoshte nëna ime fetare
e shtuna e rrëmbyer, se e nesërmja do të
ishte pushim
e diela vinte për të dy
në gjashtë te sahati i madh
ajo tundëte kokën
as jo as po
s'vinte
nisej po s'mbërrinte
s'e linin nëna dhe babai
u desh
e diela e trembëdhjetë
ky numër ters
që ajo të më thoshte duke qarë
mos më lërë shenjë
dhe ne të dy te qeshnim

kjo e dielë duhet të vinte me ty
prej kohës së xhani morandit
me të famshmen occhi di ragazza
që dhe nju jorku të qeshte i lumtur
dhe miliarderët të dhuronin lule!

SA TË BUKURA ISHIT

sa të bukura ishit! ato të gjimnazit më të
bukura,
po edhe të fakultetit, veçse prej provimeve,
jetës në konvikte
ndonjë rrudhë e imtë, paralajmëronte
prishjen, me dhembje shenjtërie
kishit emra të bukur, po dhe të shëmtuarit,
prej puthjeve, u bënë të bukur
ishit të drojtura në fillim, se vinit nga
provinca të largëta
dhe ende në vesh kishit zërin e ëmbël të
nënës; kujdes, shpirt!
zërin e babit që ju shponte timpanin; ruani
nderin, mos na turpëroni!
po veshët nga dylli u mbyllën prej
puthjeve, fjalëve; të dua, në errësirë
më i shtrenjtë se nëna dhe babai u bë i
dashuri i ri
dhe kjo në fillim ishte e tmerrshme, aq sa e
ndjetë si një krim
pastaj u mësuar me mëkatin, gënjetet ashtu
si pafajësisht
ikën vitet si trena ekspres dhe tani
pothuajse e keni harruar rininë
veçse çaste të shkëputura kujtoni se jeni
bërë vetë nëna me vajza të rritura
dhe përsëritni fjalët e ëmbla të nënës tuaj;
kujdes, shpirt!
hapni albumet kur mbeteni vetëm dhe
shikoni fotografitë
dhe lotët që ju shkasin janë lotët e nënave,
që s'i ndjetë atëherë
dhe psherëtimat e dhimbshme janë
psherëtimat e tyre, që nuk ua vutë
veshin

Pasthënia e vëllimit të ri poetik të Entela Tabakut, “Qeramikiana”

NJË RISI E BUKUR POETIKE NË HARTËN E LETËRSISË SHQIPE

Nga Ndue Ukaj

Arti ndodh dhe zor të gjendet ndonjë shpjegim si dhe përse. Këtë të vërtetë e pohon edhe shkrimtari e letrari i im i pëlqyer, Jorge Luis Borges, kur flet për enigmën e poezisë. Dhe këtë të vërtetë letrare - nëse gjakojmë të vërteta në art - na dëfton enigma e poezisë. Në këtë rast, poezia e Entela Tabakut dhe libri me poezi “Qeramikiana.” Një përmbledhje e strukturuar, ku gjuha e tingujt janë të mishëruara në sinkroni me mendimin e fjalën e zgjedhur dhe krijojnë një hartë poetike unike. Dhe poezia e Entelës rrjedh prajshëm, është rrjedhë e natyrshme e ndjesive të thella poetike dhe shqetësimeve intelektuale: poezia ka tension, por i ik retorikës, kritikon, por kurrë nuk banalizohet, ka mendim të thellë, por nuk moralizon, ka kritikë, por nuk shpërfytyrohet. Kjo poezi ofron peizazhe të bukura ku lexuesi hedh sytë e i prehet shpirti si në një zbardhje drite ose perëndim të bukur dielli, hap shtigje e rrugë, dëshmon, shtron pyetje, flet për ndjesi të thella e përsiatje rreth temave ekzistenciale njerëzore.

Poezitë e kësaj përmbledhje i shquan një forcë shprehëse autentike: në gjuhë dhe në zgjedhjen estetike origjinale. Poetja e ndërton universin letrar me gjëra të përditshme, siç është jeta, larg abstraksioneve e gjakimeve abstraksioniste. Dhe shkruan një poezi të jetës së thjeshtë që është jeta e vërtetë e poezisë. Poezia e saj shkruhet në mëngjeset e bukura kur jeta ia vesh fustanin, në mbrëmje të errëta kur mendon për fjalën, kur dita bëhet natë e nata ditë, kur ndodh t'i dalë gjumi e të mendojë për gjëra të shkuara, në nëntor kur ndien se po hyn në dimër, kur gjurmon jetën me gishtërinjtë e hollë dhe në kënde, shkund pluhurin e kohëve dhe flet për të vërteta të amshueshme. E tillë është kjo poezi edhe kur guxon të godasë arketipat e legjendave të moçme dhe t'u jap trajtë e semantikë të re: Rozafës, Doruntinës, Liza Elez Alisë; kur tregon se asgjë nuk është e re në këtë botë, flet për fjalët e vjetra që marrin gjithmonë kuptim të ri, për gramatikën e kohës e të jetës, për jetën

matanë vatrës, ulërimën në dritaren e së bijës, për zgjimin e mrekullueshëm, kur tregon se gruaja nuk është hyjni, kur vendi amë bahet lëmsh e deri te poezia e fundit “Poezia nuk i ka të gjitha përgjigjet”, që duket sikur e rrumbullakon rrugëtimin poetik dhe njëherësh jep përgjigje për krejt natyrën e këtij libri poetik të shtrirë në kohë e hapësira të ndryshme. Si e tillë, kjo poezi bëhet njëloj përgjigje e vetëdijshme për filozofinë e poezisë dhe për krejt atë çka shkruan poetja.

Poezia e Entelës karakterizohet nga një forcë e kontrastit e shtrirë në fushën e mendimit e të figurës dhe kjo përftohet përmes gradacionit poetik e shqetësimit intelektual, në ide e figuracion. Kështu, ajo e ruan traditën moderniste të poezisë si shprehje e lartësive shpirtëror dhe e gjakimeve intelektuale. Ajo flet me ankth për harresën, fjalët e vjetra, rrjedhën e natyrshme të fëmijëve dhe perëndimet e bukura nordike, dhe kudo, gufon dashuria për të bukurën, të madhërishëm e sublimen. Poetja zhbiron thella temat ekzistenciale të kohës së saj e të botës në të cilën vërtit ajo dhe njeriu i kohës, dhe nëpër trajektoret e poezisë ajo flet për vete e për të tjerët, për fatet e saj e të breznive të harkut të saj kohor, por pa u ndalë kurrë në një kohë, sepse arti nuk ndalet në një kohë, ndonëse është, si të thuash, produkt i një kohe.

Poezia është bijë e dritës. Kjo shprehje më erdhi në mend porsa mbarova së lexuari këtë përmbledhje poetike. Më duket se kam lexuar diku, por s'e kujtoj tani. Mund ta ketë thënë Roberto Bolano. Më vjen në mendje dhe në krejt përfytyrimin tim si një gurgullim fjalësh të zgjedhura, si një vegim lartësish që vjen në momente frymëzimi e gëzimi që të sjell poezia e bukur. Dhe me mendje e me zemër them: kjo poezi është një tryezë përplot ushqim shpirtëror, është një tryezë e fjalëve të zgjedhura, shoqëruar me tingujt e një zemre që ka çka të thotë dhe di si të shprehet. Dhe kjo është e mrekullueshme, sepse poetët zotërojnë një forcë të çuditshme, në punën e tyre shpalosin të fshehtat e zemrës e mendjes, tingujt e shpirtit, rrëfehen, tregojnë gjakimet, ëndrrat, ndjesitë, humbjet, trishtimin, pra përvojat e tyre i bëjnë publike.

Për mua kjo është forca madhështore e poezisë.

Poezia e Entelës ka plot gjallëri, melodi e tinguj, ka mesazhe e emocione, kujtime e imazhe, pra ka tërësinë e një jete ekzistenciale dhe këto poetja i transmeton me gjallëri, imazhe të bukura, figura të goditura dhe mendime të thella, prandaj ky libër është një risi e bukur poetike në hartën e letërsisë shqipe. Është një poezi që këshillon, ndonjëherë qorton, si në vargjet:

*tash që po e harrojmë të kaluemen
a e vëren si përsëritet?*

A ekziston një mënyrë e mirë - më e mira ose më vlefshmja - siç këshillojnë studiuesit letrarë, si E. D. Hirsch, për të lexuar e interpretuar një poezi a një vepër?

Sa herë jam përballë një dileme të tillë, e rilexoj poezinë... dhe them, ç' kuptim ka të tregosh se një poezi është e bukur, kur zor është të thuash diçka më të bukur se ekzistenca e saj. Megjithatë, gëzimi duhet ndarë me tjerët dhe gëzimi që të ofron një libër duhet t'ua këshillosh të tjerëve, lexuesve.

Arti i hap lexuesit horizonte të reja drite dhe e pasuron shpirtërisht. Kjo është madhështore, e në këtë drejtim poezia është një thirrje dhe dikush ka thënë “një mënyrë shëlbimi”, mendim të cilin ia përqafoj ngrohtësisht dhe të cilin ia atribuoj me vetëdije letrare kësaj poezie.

Prishtinë, shkurt, 2023

ENTELA TABAKU

qeramikiana



OnufriPoezi

Kisha mbaruar ditën e punës, kur sapo khyja në shtëpi, më telefonuan nga paradhoma e Presidentit. Një njoftim të atillë as kisha marrë më parë, as kisha pritur. Zoti President më ftonte për darkë.

Megjithatë, ato pak hollësi që m'u dhanë, më vunë menjëherë në mendime. Ç'ishte ajo darkë në 18:30 dhe përse do të hahej në Dhomën e Këshillimit?! Duke i kërkuar sqarime një miku të brendshëm, arrita ta mirëkuptoja orën e pazakontë, Presidenti do ta hante darkën e dytë me përfaqësues të rëndësishëm, që kishin ardhur nga Italia. Ndoshta prandaj isha paralajmëruar, njëzet e pesë minuta kokë më kokë me mua.

Mirëpo përse te Dhoma e Këshillimit?

Pa gjetur ndonjë ndihmë, këtu ngecja. Siç ma kishte zënë veshi, ajo ndodhej në suitën presidenciale, në katin më të lartë të Kullës Damo. Madje ndryshe njëhej edhe si Dhoma Damo. Në pozitën e zëdhënësit të shtypit, unë e takoja Presidentin herë pas here, por gjithnjë kur më thërriste në zyrën e tij. Flitej se mes shefave të sektorëve dhe këshilltarëve kishte nga ata, që e kishin provuar atë dhomë. Por duke bërë të paditurin, asnjërit s'i shpëtonte gjysmë fjale nga goja. Gjithsesi, ndryshimet që ndodhnin në strukturën e kompanisë, thuajse pa vetëdije, ne i lidhnim me atë dhomë. Sidomos rritjet në përgjegjësi, pavarësisht se ai që gradohej, kurrësi nuk e pranonte: "Ç'është kjo pandehmë, unë darkë me Presidentin?! Dhe pikërisht në Dhomën e Këshillimit?!" E teksa mohonte me fjalë e me gjepte, si të trembej mos po e tradhtonte veten nga acarimi i tepërt, e gradonte mirë zjarrminë e kundërshtimit.

E themeluar dy dekada më parë nga një emigrant, që kishte kaluar nëntë vjet në ishujt e Greqisë dhe të Italisë, Kompania Damo ishte bërë e famshme. Me gjithë kureshtjen, vonë do ta mësoja se përse mbante atë emër. Por qysh në fillim mora vesh se nuk kishte ndonjë lidhje me statusin familjar të Presidentit, madje as me të stërgjyshërve të tij. Sidoqoftë, ekspansiv në interesat e biznesit, themeluesi e kishte zgjeruar aktivitetin duke u shtrirë në ndërtim, turizëm dhe eksport-import. Por, ndërkaq, edhe duke u dhënë shumicës së akseseve ngjyrimin e logosit të kompanisë. Me një fjalë, Damo këtej, Damo andej, Damo në të gjitha reklamata televizive. Mua më tingëllonte sikur Presidenti donte të shpallte në vazhdimësi një kumt prej orakulli. Në zyrën e tij, në murin pas kolltukut, kisha parë shpesh një mozaik të kompozuar me kartëmonedha dhrahmi dhe lireta të dikurshme. Ishte shenjë nderimi për rrugën nga e kishte nisur, çka i kujtonte gjithashtu majat ku ishte ngjitur. Ndoshta kështu shpjegohej edhe pasioni i tij për antikitetin grek e romak, por dhe qytetërimin e asaj kohe në përgjithësi.

Para një sprove të tillë më kishte vënë edhe mua, kur më thirri në testin e punësimit. Me keqardhje e them se, megjithëse tashmë kisha përvojë pune, në atë testim m'u zgjuan ethet e provimeve universitare. "Do t'i pikasë bosi emocionet në sytë e mi?", thosha me vete. Në moshën e adoleshencës nëna pati vërejtur një dallim ngjyrash. Ajo kishte vërejtur se syrin e majtë e kisha disi në të kaltër, ndërsa të djathtin disi në të gjelbër. Kur deshi të dinte përse kjo veçori, unë nuk kisha ndonjë përgjigje. Im atë kishte ndërruar jetë herët dhe kurrësi, qoftë me shaka, nuk mund ta provokojë nënën nëse bashkëshorti i saj kishte qenë a s'kishte qenë edhe babai im biologjik.

Në fakt, testimi u përqendrua tek aftësitë e mia të kujtesës dhe të shqiptimit. M'u kërkuar që çfarëdo të thoshte parafolësi, ta përsërisja menjëherë pas tij. Je gati, djalosh? Gati jam, zotëri. Atëherë Presidenti tha:

- Shammuramat e Shamshiadatit.

- Shamshiadat i Shammuramatit, - iu përgjigja, duke bërë edhe lidhjen e kundërt bashkëshortore.

Ai mbeti i kënaqur. Megjithatë, kur më pyeti se për cilin Shammuramat të Babilonisë ishte fjala, nuk qeshë në gjëndje t'i thoja për Shammuramatit V. Por kjo s'e pengoi të më punësonte me një pagë sa trefishi i asaj, që merrja deri atëherë si gazetar. Veçse më paralajmëroi, gjatë sezonit turistik të verës mund të ngarkohesha edhe me detyra të tjera.



*

Po mbaronte njëri nga sezonet verore, kur u ftova për darkë. Që nga maji kisha kryer gjithashtu detyrën e Sheft të Dekorit, Harmonisë dhe Paqes Shpirtërore për tri resortet bregdetare. Sapo mbushej muaji nga inspektimi i fundit në resortin më luksoz, natyrisht dhe më të shtrenjtin. Në krahësim me Damo 1 apo Damo 3, në Damo 2 nuk kisha pritur të gjeja probleme. Dhe vërtet nuk gjeta. Por ndodhi një incident, që më futi rastësisht në valle.

Një qytetar kokëfortë, nga ata që e kërkojnë sherrin vetë, kishte hyrë pa leje në plazhin privat. Ndonëse iu tha të largohej, si të ishte shurdh i lindur, mbasi liroi zhezhlongun që kishte zënë, u shtri në rërë pa e bërë qejfin qeder. Atëherë rojat tona iu hodhën përsipër, ia lidhën duart prapa dhe, si i dhanë ca goditje me shkopinj gome, e tërhoqën zvarrë deri jashtë kufirit të resortit.

Mjaftuan fotot e vidiot e pushuesve, që mediat sociale ta shpërndanin lajmin (skandalin, sipas tyre) menjëherë. Ato pashë edhe unë, prandaj zbrita në holl. Të pakënaqur me shpjegimet që kishte dhënë Shefi i Sigurisë së Territorit dhe Pasurisë Materiale, teksa dilja nga ashensori, m'u vërsul një tufë gazetarësh. Nuk kisha si t'u shmangesha, sepse ne kishim njohje. Për të mos i ndërsyer mediat më keq, qëndrimi më i përshtatshëm m'u duk ekuilibrimi. Kështu, pranova se situata mund të ishte zgjidhur edhe ndryshe. Si ndryshe, si ndryshe?, shpërtheu e njëjta pyetje. Pa përdorur forcë të tepruar, i rashë shkurt.

Mirëpo gazetarët do ta tepronin edhe vetë. Nga e gjithë intervista ime, këtë pohim zgjodhën për të theksuar, duke zëvendësuar fjalët "përdorim i forcës" me "ushtrim i dhunës".

Derisa të shkoja në darkën misterioze, e gjithë përvoja ime në kompani m'u vërtit nëpër mend. Doja të gjeja pikat më të dobëta. Dhe kisha të tilla. M'u kujtua se, para disa kohësh, ai miku i brendshëm më kishte thënë: Si shpjegohet që herë-herë të dy sytë e tu marrin ngjyrën gri, duke u bërë të mprehtë e të padepërtueshëm? Por kësaj radhe ishte koha ime për të pyetur, ke ti ndonjë mendim? Dhe ai ishte përgjigjur, kam përshtypjen se në një gjëndje të tillë e gjithë qenia jote përjeton ndonjë alarm dhe i bën thirrje logjikës antiemocionale. Sa për pikat e dobëta tashmë po më dukeshin të harruara, duke përfshirë edhe incidentin e resortit. Kishin kaluar katër javë pa ndonjë vërejtje dhe unë isha i bindur se, me një telefonatë, Presidenti e kishte bërë nul denoncimin e të dëmtuarit në polici.

Pastaj nisa të mendoja për pikat e mia të forta. Më doli se këto zotëronin. Mos isha ftuar për ndonjë rritje në përgjegjësi? Drejtori i marrëdhënieve me jashtë, thua se donte të zhdukej, nuk po kthehej nga Milano dhe bordi i kompanisë do të emëronte drejtorin e ri. Me sa kisha kuptuar,

me aq kapitale sa kishin aksionerët e tjerë, mbledhjet e bordit mbeteshin formale, pasi vendimet i merrte Presidenti, si aksioneri kontrollues absolut. Kujtoj se kjo ndjesi, pra përkedhelja e sedrës dhe njëfarë shprese, më ndoqi rrugës për në Kullën Damo.

*

Kur hyra në Dhomën e Këshillimit, nuk më kujtohet nëse Presidenti lëvizi ndopak nga vendi, apo vetëm më dha shenjë për karrigen time. Aty gjeta gjithashtu dy zotërinj, praninë e të cilëve s'e shpjegova dot menjëherë. Ndodheshin pas ndonjë takimi pune, apo ishin ftuar kastile duke e ndryshuar protokollin e darkës? (Diç kuptova, kur atyreve nuk do t'u shërbehej ushqim, përveçse shampanjë.) Ishin aksionerë të parëndësishëm, por duke pasur të dy bashkë 11 përqind, përpikeshin nganjëherë t'i bënin presion kryeaksionerit.

Në karrigen që më tregoi, në një tryezë që krijonte hapësirë të arsyeshme, i binte që Presidentin ta kisha përballë. Nuk e di përse, së pari më ra në sy tavani me gdhendje druri përqark dhe tre llambadarët në një rresht, nga të cilët ishin ndezur dy anësorët. Atë të mesit, më të madhin, e kisha pingul sipër meje. Ishte llambadar me degëzime të shkallëzuara, që dilnin tek e tek nga boshti i rëndë, i cili përfundonte me një bronzinë në formë koni, por me majën poshtë. Pak orendi të tjera më janë fiksuar, me përjashtim të minibusteve mbi ekspozitorët prej qelqi. Asnjë pëlhurë me penel, gjithçka tridimensionale dhe e prekshme. Disa nga bustet arrita t'i njihja, sepse Histori kisha studiuar në universitet, duke u specializuar më vonë për gazetari. Mbasi pikasa një Eros mes denaidave, kalimthi po pyesja veten se kujt i përkiste portreti i atij burri, që ishte vënë mes Hermesit të grekëve dhe Marsit të romakëve. Për çudi, duke kapur mëdyshjet e mia, në këtë çast e nisi bisedën edhe Presidenti.

- Nuk besoj se e njohe mbretin Dionis të Sirakuzës, - m'u drejtua. - Sigurisht, është vetëm një përfytyrim i tij.

Pastaj heshti, derisa i dha fund pjatës së vetme me pesë-gjashtë lugë brumë zarzavatesh. Për shkak të kohës së kufizuar, mua m'u shërbyen njëherësh supa dhe pjatanca e biftekut. Me të lënë picetën, Presidenti mori në dorë një telekomandë, që e kishte mbajtur më të djathtë. Pandeja se me atë pult do të ndizte monitorin e madh, për të më demonstruar ndonjë video, që lidhej me ftesën time. Por monitorin nuk e ndezi, sepse veprimi ndoshta kishte qenë instinktiv.

- Pak e nga pak, mbreti Dionis ra në hall me ziliqarët, që i kishte brenda oborrit, - e rimori fjalën. - Këta mëtonjës hanin bukën e tij, por donin t'ia merrnin pushtetin. Prandaj, në vend të punonin për të mirën e monorakut, bashkëpunonin me kundërshtarët. E ç'bëri ahëre Dionisi? - e

ngrohu paksa tonin Presidenti. - Dionisi i ftoi oborrtarët në gosti. Po cilin uli përkrah vetes? Uli Damokleun, oborrtarin më të bindur. Me porosi të mbretit, sipër kokës së këtij njeriu ishte lidhur një shpatë, që rrinte pezull. Dhe dihet tashmë çfarë e mbante shpatën. Vetëm një qime nga bishti i kalit. Le t'u hynin drithmat rebelëve, le ta shihnin me sy se ç'fije e hollë e ndante kokën e tyre nga pushteti i mbretit. Sepse mjaftonte...

Me pultin në dorë, Presidenti e preu fjalën. Me gjasë, kishte shtypur ndonjë buton, pasi ndërkaq dëgjova kërkëllimën që mbante varur llambadarin. Duke dalë nga vrima e rozetës, zinxhiri u zgjat dhe, befas, atë katananë me bronzinën si majë hushte tani e kisha më afër.

Ndoshta si unë, edhe dy zotërinjtë ndodheshin për herë të parë Dhomën e Këshillimit, sepse të tre reaguam të trembur. Duke tërhequr karriget mbrapa, secilit na shpëtoi një britmë e mbytur. Nuk kisha mundësi ta shihja veten, por pashë se në fytyrat e tyre s'po hiqej shfytyrimi. Ndoshta mendonin se, po të kishte rënë llambadari mbi mua, si zor t'u shpëtonin brirëve të tij edhe kokat e tyre.

Heshtje tjetër nuk pati, pasi Presidenti foli sërish. Ai u kërkoj ndjesë zotërinjve, ngaqë mbledhjen e bordit të ngushtë e kishte mbajtur në atë mjedis privat. Pastaj shtoi:

- Por tashmë, meqë e kemi marrë vendimin që ju propozova, mund të largoheni.

Dhe sapo mbetëm vetëm, më foli në emër:

- Pa kujtohu, Enkel Hakani, si u shprehe në atë intervistën tënde?! Ti the se ishte përdorur forcë e tepruar, kur situata mund të zgjidhej ndryshe. Po ahëre, përse nuk e zgjidhe ndryshe?! Si Shef i Dekorit, Harmonisë dhe Paqes Shpirtërore ti ishe pikërisht në pozitën për ta zgjidhur. Mirëpo, kur llape para gazetarëve, nuk mendove se po rëndojë Shefin e Sigurisë së Territorit. Përse nuk funksionoi harmonia mes jush?! Si e harrove ashtu interesin global të kompanisë?! Po kujdesin për paqen time shpirtërore në ç'djall e çove?! Ti shkëlmove të gjitha përgjegjësitë e tua, Enkel Hakani!..

Përballë këtij sulmi të furishëm, si të mos e kisha pësuar pak më parë, zinxhiri më gjeti përsëri të papërgatitur. Dhe kësaj here krëkëllima ishte më e fortë, sepse zinxhiri u lëshua vrullshëm. Sa e ndanin tani majën e bronzinës nga koka ime, një apo dy pëllëmbë?!... Mos jam përfshirë nga emocionet, më shkoi nëpër mend, ç'ngjyrë kanë marrë sytë e mi, e ka pikasur Presidenti alarmin tim?

Isha ende në këtë pështjellim, kur dëgjova zërin e tij:

- Në rrëzën e degëzimit nga ana jote është vendimi. Pres ta lexosh.

Zgjata krahun dhe e shqita pusullën. Aty shkruhej: "Vërejtje e rëndë me paralajmërim për pushim nga puna." E ndjeva se kisha arritur ta përmbaja veten. Nuk fola as në çast, as ndërsa nxirrja nga xhepi stilolapsin. E ktheva pusullën së prapthi dhe hodha një shënim, të cilin e nënshkrova.

Të nesërmen, në blogun e kompanisë u njoftua pushimi im nga puna. Gazetarët më telefonuan menjëherë. I thirra në konferencë shtypi dhe, për fat të mirë, kolegët e dikurshëm nuk më lanë në baltë. Atyre u zbulova të vërtetën e shënimit, që kisha nënshkruar të mbrëmshmen. Për të mos cënuar privatësinë e pronarit, nuk pohova se e kisha zbuluar origjinën e emrit të kompanisë. As fola për llambadarin me zinxhir, por u përqendrova te Dionisi i Sirakuzës. E rikrijova me hollësi gostinë, ku mbreti ftoi oborrtarët e tij. Duke u ndalur te përdorimi që i bëri oborrtarit më besnik, i qëndisa nga vetja ca përshkrime situatës me shpatën pezull, atë shpatën me majë të mprehtë që qëndronte varur në një qime kali. Pastaj pyeta ballazi:

- E çfarë do të bënte oborrtari i gjorë, nëse mbreti shtronte një gosti të dytë?

Mediat u përgjigjën me tituj të ndryshëm. Por mua më ka mbetur në mend ai i gazetës më të madhe: "Damokleu jep dorëheqjen".

Tiranë, korrik 2020

Migjeni nuk pati shumë kohë të qeshë. Të qajë, nuk pati fare kohë. Dhe kjo është arsyeja që vepra e tij vazhdon të shtrihet në pakohësi. Më së miri kjo tregon se vepra e tij ka lindur pa ekzistencën e hidhërimit dhe pa ekzistencën e gëzimit, si diçka planetare. Ndryshe, nuk ka përse të trembë dhe të tronditë me veprën e tij, mes për mes një konsolidimi të parë të shoqërisë shqiptare të viteve '30, të ripërtërirë edhe njëherë nga e para pothuajse pas një shekulli. Dhe si gjithçka planetare, kjo vepër vetëm ka lëshuar dritën e saj krijuese, të parën në letërsinë shqipe si shenjë e re për shekullin e njëzetë. Shkodra e lindi si poet e prozator dhe Korça i botoi “Vargjet e lira”; të një ndërtimi të parë qytetar, kur ai ishte vetëm një 26 vjeçar. Nuk ka ndonjë të dhënë nëse e ka parë ndonjëherë direkt në sy, Fishtë, i cili, kur u botuan “Vargjet e lira” ishte 65 vjeçar, të dy kanë jetuar në të njëjtin qytet, në Shkodër.

“Tremb” dhe “trondit” nuk janë aq larg në kuptimësi, si në krijimtarinë e Gjergj Fishtës, edhe në atë të Migjenit. Fishta mund të ketë edhe meritën e përmbysjes së një sistemi, qoftë nëpërmjet mungesës së imponuar për gati një gjysmëshekulli nëpër tekstet shkollore.

Në krijimtarinë e Migjenit, pothuaj, nuk ka ëndrra, dhe kjo tremb. Le të kujtojmë këtu “Poemën e mjerimit”, që deri te një shpërbërje trupore të kujton rrathët e ferrit. Arti i Fishtës me veprën e tij madhore “Lahuta e Malësisë”, në rrugën e eposit verior, shkëputet nga forca tronditëse e jetës së përditshme për të krijuar një aventurë lirie, gati kalorsiake, si thyerje e zinxhirëve të një dite të robëruar.

Ai shekull, që për Migjenin e lindur 40 vjet pas Fishtës mbetet i ri, bëhet i zi për Fishtë në muzgun e moshës dhe të lavdisë së tij të prajshme. Të dy kthehen në një prag të vetëm artistik për shqiptarët që ndodhen para tragjeditë të reja botërore.

Kritika letrare, për absurd, nuk i ka vendosur asnjëherë pranë e pranë këta dy autorë, të paktën për kohën kur kanë jetuar, dhe ende i vendos skajeve të kundërta ku duhet të përjashtojnë njëri-tjetrin. Të dy i takojnë një areali të përthyer shqiptar dhe njëkohësisht truallit po aq të rrëshqitshëm të të gjithë botës së viteve '30, si dhe dritëhijeve herë aventuriere, herë sflitëse deri në asht të Malësisë shqiptare. Dhe që atëhere dhe deri sot, figura e Migjenit, ndoshta do të duket gjithnjë si një fantomë që rri në një fotografi të përbashkët të Koliqit, Fishtës, Asdrenit dhe Lasgush Poradecit, që në ditët tona duket sikur sa janë çliruar prej censurës së rreth 50 vjetëve. Migjeni ,me mushkëritë plot plagë, largohet nga jeta në vitin 1938, pa mbushur mirë 28 vjetët. Fishtës, në kulmin e pjekurisë së moshës 69-vjeçare i jepet lamtumira e fundit në vitin 1940, pasi i dhuroi letërsisë shqipe një përthyerje të madhe dramatike, që nga eposi, që në zbërthimin poetik i drejtohet edhe konflikteve ballkanike, deri në sarkazëm të një realiteti plot zhgënjime. Jeta, si në një ortek, kurorëzohet në veprën e tij me gjuhën e kontrasteve befasuese dhe oshilacioneve të thella gjuhësore që nisen nga lartësitë e mëdha deri te e folmja e përditshme, e cila, që në kohën e Shekspirit, e zbret gjuhën në thjeshtësitë më banale, duke u lëvriur prej botës sipërane në estetikën e së ultës, derisa në botën e Fishtës edhe bora shkrin “për të tretun qelbësinën”. Dhe kështu deri sot, krahas heroikes Fishta citohet drejtpërdrejt edhe për pakënaqësitë e veshura me një vel të përgjithshëm.

Pjesë e librit në botim “Njeriu si një tjetër”

TREMB DHE TRONDIT

Nga Natasha Lako

Po të perifrazojmë titullin e veprës së Eliade-s, “E shenjta dhe profania”, Migjeni e shenjtëron njeriun e pafuqishëm, njeriun e skamjes qoftë të shpërbërë, edhe kur është brenda tragjizmit të vet, njësoj si në skenat e ferrit. Por shkrimtari i realizmit të thertë nuk e dërgon atje për ta dënuar, por për ta ngritur sa më lart. Dhe në kontravers, njeriu, brenda këtij ferri, përsëri mbetet i shenjtë. Ky është humanizmi migjenian që jeton në një botë të nderë pa anë e fund në ankthin e vet ekzistencial.

Migjeni asnjëherë nuk i vë gishtin profanëve, si do të bënte Fishta. Fishta mbetet përfaqësues dhe zëdhënës, madje, plot përgjegjësi dhe ndjeshmëri të lartë i një fati më të përbashkët kombëtar, epik në ndërtimin e një atdheu dhe lirik në burimet e pafundme gjuhësore, me kundërvënien të vazhdueshme ndaj aksiomës të zgjuar për mexhiten.

Migjeni është i vetëdijshëm për këngën e tij skandaloze që shprish çdo kufi artistik, që për herë të parë të lindë poezia dhe proza e botës së qytetit, ku njeriu shpesh nuk ka si mbrojtje, si deri

atëherë në letërsinë shqipe, as dritën e hënës, as fyellin e bariut, as jetën buklike. Qyteti ka përballë njeriun dhe gjithçka.

Pasi qyteti ka edhe asgjënë, si në prozën “Mollë e ndalueme”. Dhe në qoftë se romantizmi, si vazhdues i iluminizmit të Rilindjes, krijoi atdheun si pjesë të lirisë njerëzore, Migjeni me realizmin e tij therës mbështetet te bota individuale njerëzore, mes një turme të plotë dhe tragjike. Pikëtakimi i tij më i madh me lexuesin bëhet si fat personal që e ndien gjithkush, duke pohuar ekzistencën e njeriut që jeton, vuan, sfidon, triumfon ose humbet, i kurorëzuar nga vetmia e tij sublime, gati universale, shpesh, si një triumf. Gjë që letërsia shqipe e ka të vështirë ta bëjë edhe sot, kur njeriu nuk shkëputet dot nga fatet kolektive.

Është kjo jetë qyteti, që për Fishtën sjell zvetënimin, por për Migjenin edhe tragjiken. Migjeni bëhet paralajmërues i ardhjes së fashizmit me dy skicat e tij poetike, “Urimi për Vit të Ri,1937” vetëm një vit para vdekjes dhe “Të korrat”, ku edhe për lexuesin e sotëm tanket nuk do



të gjendeshin vetëm në të korrat e vitit 1936, kur u ndalua edhe vepra e tij.

Këto dy proza poetike Migjenin e vendosin shumë pranë Orwell, që në esenë e tij “Mbi nacionalizmin” trajton dhunën verbale që kishte filluar të mbulonte horizontet, si shenjë e tragjedisë që po përgatitej.

Dhe pakëta dyshkrimtarë, figuracionet e të cilëve shpesh komentohej sikur të jenë në një botë pa përmbajtje, letërsia shqipe që pas romantizmit, kalon edhe në sprovën e klasicizmit fishtian, nuk do të kishte pranuar gjithë proceset e veta të periudhave europiane të viteve '30.

Por vepra e tyre i ka bashkuar njëherë e përgjithmonë dhe i ka lidhur si dy anë të një medaljeje, qoftë në një poezi të vetme.

Dhe kjo ndodh kur Fishta krijon, si në vaje malësorësh në një mbrëmje kur shuhet natyra, këngën e vajit për një djalosh të ri të vvarë nga gjakmarrja dhe shkruan poezinë “Një lule vjeshte”, ku me filigramë të shqipes si një rrymë përroi ngre një shatore.

Dhe Fishta jep jo vetëm bekimin e vet, kur edhe yjet vështrojnë si “sy Zotit”:

*Oh! sá e sá herë, kur n'mbrame shuen natyra,
E tjetër s'ndihet, veç se rryma e prronit,
.....*

*Dal në dritsore me kundrue shatorren!
Qi i Lumi t'kthielltë ia vuni rruzullimit,*

*E kqyri hyjt, qi, thue, se njaq sý Zotit
Flakojn mbi dhé — kushdi, për me felgrue
Nierin, qi egrue mâ fort prej mnerës s'territ*

Përbluen punë t'mbrapshta: — e atë botë mendoj për ty.

Gjuha e Fishtës e bën më brejtëse këtë poezi plot dhimbje për djaloshin e pafajshëm të vvarë prej tmerrës s'territ aq egërsisht, por edhe vrasësit të egër, dhe, njëkohësisht, duke e lënë të paprekshme tablonë e kësaj shtatoreje i duket se i adresohet edhe të Lumit, madje, edhe lexuesit të vet.

Dhe Fishta ka forcë t'i vendosë të gjithë së bashku, si thotë vetë vargu vetvetiu. Pranë kësaj poezie dhimbjeje, si revoltë këlthitëse jo për ligjësitë e hakmarrjes, por për një vocërrak të shujtur prej urisë dhe mjerimit, Migjeni krijon një shtatore tjetër. Është përjetësia ulëritëse e dhimbjes që poeti ndërton te “Bukuria që vret”, ku ushton thirrja kumbuese e gjuhës migjeniane. “Mernie dhe conie në qytet kët shtatore. Vendosnie në ndonji shesh dhe si përmendore kushtonja dikujt, ... ndoshta perëndisë klasike”. Dhe gjithë kjo dhimbje, gjithë kjo klithmë, i bën edhe Migjenin, edhe Fishtën akoma më vetmitarë. Sepse, ndryshe, nuk do t'i dallonim edhe më mot-mot, mes turmës së parë të jetës së qytetit.



Natën sjell në mend emrin tënd, Orija, që je gruaja ime dhe emrat tuaj, Sandra, Xhamila dhe Ali, fëmijët e mi që ju dua. E fillova me emrin tënd dhe me emrin tënd dua ta mbyll, Orija, gruaja ime, sepse ti je ajo që dua më shumë në jetë. Kur u nisa nga Tata, para tre vjetësh duke lënë prapa gjithçka që kam dashur dhe kam njohur që prej fëmijërisë, shtëpinë e tim eti dhe të mëmës, s'kisha asgjë për të marrë me vete. Ne ishim aq të varfër, sa më duhej të ikja. Mora me vete atë që kisha më të çmuar, emrin tënd. Vetëm emrin tënd, Orija. Ai është shumë i ëmbël. Unë e përsëris atë çdo ditë, çdo natë. Emri yt më jep forcë për të punuar. Ai është bekimi im.

Orija, emri yt më turbullon e më mbush me lumturi kur e shqiptoj. Ai ka hyrë aq thellë në shpirtin tim, sa më duket sikur kam lindur me të. Çdo mbrëmje, i lodhur nga kantieri i Giglionit, hyj në dhomën, që gjendet te Rruga e Italisë, bashkë me tunizianin Malik dhe shtrihem. Nuk e dëgjoj më zhurmën e televizorit, s'e shoh dritën e kaltër që fërgëllon nëpër dhomë, as ato figurat e çmendura, të cilave ti, Orija, nuk do t'u përkasësh kurrë. Maliku e ndjek televizorin, derisa e merr gjumi. Ai nuk flet, shikon gjithçka : Çmimin e madh për automobila ; garën e anijeve me vela, uraganin mbi Kenë ; gruan e mrekullueshme, horoskopin, zjarret e dashurisë, Botërorin '90, Supermenin etj. I ndjek këto imazhe me aq vëmendje, sa ndonjëherë kam përshtypjen se do të luajë mendsh.

Unë mbyll sytë ashtu shtrirë pranë dritares dhe më shfaqesh ti, Orija. Maliku nuk të sheh. Vetëm unë të shoh në këtë dhomë të ngushtë, sepse unë e kam emrin tënd të shkruar thellë në zemër dhe pres ditën kur do të kthehem. Emri yt është i shkruar në një frazë tepër të gjatë që s'mbaron kurrë, një frazë që vjen butësisht drejt teje, drejt anës tjetër të botës ku më pret ti. Jam aq larg teje në këtë qytet, në këtë dhomë ! Gjatë dimrit, poshtë tarracës është ftohtë dhe verës të zihet fryma. Shtrojat tona janë thuajse në tokë. Maliku fle pranë derës, unë pranë dritares. Në mes janë shtrojat e Shimanit, vëllait të Malikut. Ka një javë që Shimanin e zuri një mur përforcues në kantierin e Giglionit. Humbi dorën e djathtë. Ai nuk mund të punojë më. Kur të dalë nga spitali do të kthehet në Tunizi, pranë gruas dhe fëmijëve. Ma tha Maliku këtë, pastaj ai vazhdoi të shihte televizor i mbushur me zemërim. Pa dashur, unë mendova se si do të dukej ty, Orija, nëse do të më ndodhte mua kjo gjë ? Nëse do të përfundoja në shtëpi i gjymtuar, çdo të thoshin fëmijët tanë ?

Mua më pëlqen që fle pranë dritares. Mëngjeseve në pranverë mund ta shquaj ç'kohë do të bëjë ditën. Dëgjoj zogjtë që këndojnë. Më duket sikur shoh pakëz dritë nga Tata, dritën që sheh ti, Orija, me sytë e tu.

Edhe emrin Tata kam dëshirë ta shqiptoj. Këtu, ky emër i bën njerëzit të qeshin. Ata nuk e kuptojnë. Unë e them me zë të ulët si për t'u shfajësuar,



J.M.G. Le Clézio

KUJTIMI YT, ORIJJA

Tregim

Përktheu nga frëngjishtja Feride Pappleka

Fituesi i çmimit Nobel për letërsi 2008, Le Clézio (1940) njohu shpejt suksesin me romanin „Procesverbal“ (1963), çmimi Renodot. Deri në mes të viteve '60 vepra e tij dallohet për kërkime formale në ndikimin e Romanit të Ri. Më pas ai pasqyroi origjinat familjare, ndërmori udhëtime të gjata dhe u njoh me kulturën amerindiane. Krijimtaria e kësaj kohe shquhet për trajtimin e temave të dhimbjes, ankthit dhe kaosit urban. Disa romane të tij i lënë një vend të dukshëm onirizmit dhe miteve : « Shkretëtira », « Kërkuesi i arit », « Onitsha », çështjeve ekologjike : « Libri i arratisjeve », « Lufta » ; dhe kulturës indiane : « Gjigantët », « Udhëtime në anën tjetër », « Mondo dhe histori të tjera », « Stina e shirave » si dhe libra me domethënie më vetjake, autobiografike ose familjare : « Afrikani », « Revolucione », « Ylli endacak » etj. Ai ka botuar me dhjetëra libra (romane, tregime, novela, biografi, ese) që janë përkthyer në shumë gjuhë. Le Clézio cilësohet si një nga autorët francezë më të përkthyer në botë. Refleksionet e tij kulturore janë të shumta. Ai vetë citon poetët John Keats dhe W. H. Auden. Pohon se është ndikuar nga J. D. Salinger, nga W. Faulkner dhe Ernest Hemingway.

Në librat e tij shtjellohet problemi modern i përplasjes individ-shoqëri, i dhënë me lirizëm dhe me monolog të brendshëm. Kundërshtimi, kallëzimi i së keqes e i vrazhdësisë së shoqërisë qytetare i veprave të fillimit, shndërrohet në një problem universal dhe vë në pikëpyetje zhvillimin e botës perëndimore për format e reja të shfrytëzimit si prostitucioni, trafiku njerëzor, droga etj. Në veprat e pjekurisë, me një ton shumë vetjak e me vërtetësi, ai përdor metafora prej vizionari për të shprehur para së gjithash, «aventurën e qenies njerëzore».

sepse ky emër u duket i çuditshëm, e bëj që t'i paralajmëoj, se s'mund ta ndryshoj. Sidoqoftë, është emër shumë i ëmbël, emër si yti, Orija, që më jep forcë e jetë. Unë përmend, gjithashtu, emrat që njoh, fshatrat, qendrat tregtare. Ata janë si emrat e familjes sime : Suk, Iletto, Tazar, El Khemia, Aixhe, Imitek. Unë i përsëris me sy mbyllur dhe e ndiej veten pranë teje, Orija, edhe pse trupi im gjendet larg trupit tënd, edhe pse duart e mia nuk mund të të prekin, edhe pse nuk ha dot nga buka që gatuan ti, edhe pse nuk pi dot nga uji që sjell ti.

E shoh buzëqeshjen tënde. Në veshët e mi vjen murmurima e zërit tënd duke i kënduar ninullë vajzës sonë që ende nuk e njoh. Vështroj shkëndijëzën e syve të tu robërues, qepallat e tua të lyera me khol, i marr erë parfumit të flokëve të tu kur i kreh nën diellin e mëngjesit në oborrin e shtëpisë. Të sodis, si atëherë kur zgjatja kokën përmes perdeve të dritares në dhomën e burrave.

Stinët kaluan larg teje, Orija, larg jush, fëmijët e mi. Në dimër bën aq ftohtë kantierëve, sa vetëm kujtimi juaj, kujtimi i zërit dhe i vështimit tënd, Orija, më mbajnë gjallë. Për ty ngre gurë, derdh beton mbi skeletet prej hekuri të ndryshkur, shtrëngoj vidat në rrjetat e tavaneve, patinoj mure. Emri im është Abdelah, emri i tim eti është Rebo, nëna ime quhej Khadija. Padroni Giglion as emrin tim nuk e mban mend. Ose nuk do. Ai më thërret Ahmed. Të gjithë patinuesit quhen Ahmed. Por, ç'rëndësi ka kjo ? Për ty unë ngre lopatën, për ty hedh çimento, për ty gdhend fasada. Ditë pas dite, muaj pas muaji ngre mure, patinoj allçi. Kam ndërtuar aq shumë shtëpi, sa do të mjaftonin për tërë familjet e Tatës ; kam ndërtuar qytete të tëra. Kur të kem grumbulluar aq para, do të kthehem Orija, dhe kurrë më s'do të ndahemi.

Dielli më djeg trupin, të ftohtit më plasarit lëkurën, peshja e lopatave m'i këput gjymtyrët. Por tani u mësova. Kur erdha në këtë qytet para tre vjetësh, isha ende i dobët dhe i druajtur si fëmijë. Mbrëmjeve isha aq i lodhur dhe ndihesha aq i vetmuar, sa shtrihesha përtokë e më dilnin lot nga sytë. Banoja në një fjetore me zezakë dhe tunizianë, sipër një bari. Drita e neoneve krijonte një njollë gjaku mbi dritare. Në rrugë kishte zhurmë makinash. Vinin gjer aty ulërimat e njerëzve të dehur, që grindeshin, të grave që thërrisnin. S'kishte as fëmijë dhe as ëmbëlsi. Atëherë fillova të kujtoj emrin tënd, Orija, dhe emrin e secilit prej fëmijëve, dhe emrin e Tatës.

Ato çaste sillja në mend kujtimin e asaj dite që të takova ty, Orija, gruaja ime, në pemishten e madhe të lumit, ditën e festës kur ti erdhe me kortezhin e vajzave të reja për t'u hedhur polen luleve të hurmave.

Ajri ishte i lehtë, e mbaj mend mirë. Pluhuri i artë pluskonte në ajri. Lugina jehonte nga këngët. Kur kortezhi kaloi para meje, unë të pashë, Orija, shkëndija e vështimit tënd hyri tek unë dhe nuk doli më. E kuptova, ti ishe gruaja ime.

Në dimrin e hirtë e të bardhë të kantierëve, në këtë qytet aq larg nga ti, kujtimi i asaj dite është përherë i pranishëm. Ai më jep forcë, më mban lopatën, ai ngre thasët me çimento dhe allçi. Edhe në të dielat e zbrazëta, në bulevardet e pluhurosura, në tarracat e frikshme, kur jam fillikat, pa fëmijët pranë, i rrethuar me ligësinë e njerëzve që kërkojnë një viktimë, kujtimi i asaj dite në luginën e hurmave nuk më lë vetëm. Të shoh ty, Orija, veshur me fustanin plot hir, me fytyrë dhe duar të mbuluara nga ngjyra e artë e polenit dhe shkëndija e vështimit tënd mbetet përjetësisht në vështimin tim.

... LUC BONDY më kishte kërkuar të bëja një version skenik të *Sëmundjes vdekjeprurëse* për Schaubühne në Berlin. Unë kisha rënë dakord, por i thashë se më parë më duhej të bëja një dramatizim, se duhej ta gdhendja tekstin, që të mund të lexohej, por të mos luhej në skenë. E bëra dramatizimin. Që këtu personazhet kryesorë ishin të heshtur, ishin aktorët ata që tregonin historinë e tyre, çfarë kishin thënë, çfarë u kishte ndodhur.

Të gjitha pasazhet skenike, dhjetë a dymbëdhjetë, ishin në vendin e tyre. Duhej të lexoheshin, sikur edhe dialogjet e personazheve kryesorë. Gruaja në këtë dramatizim tashmë ishte lënë e qetë, mënjanë. I drejtohej burrit, jo gruas. Dy ditë pasi dërgova dramatizimin e *Sëmundjes vdekjeprurëse* në Berlin, ju telefonova atyre me kërkesën që të ma kthenin tekstin sepse nuk mund të qëndroja pas tij. I tregova Yann-it. Atij i tregoj shpesh se çfarë bëj. Sapo e kisha nisur skenarin, e kisha kuptuar që e kisha mashtruar veten. Kisha bërë pikërisht atë që doja ta evitoja. Isha kthyer te *Sëmundja Vdekjeprurëse*, në vetë bazën e tekstit me tre zëra, në formën e tij të caktuar dhe të unifikuar. Isha e zbrazur deri në palcë, isha bërë e kundërta e një shkrimtareje. Isha viktimë e një fati të paracaktuar nga i cili përpiqesha të ikja pa pasur sukses. Fola për këtë me Yann-in. Nuk më besoi. Ai më kishte parë tashmë tek hiqja dorë shpesh nga projektet e mia, tek dorëzohesha.

Dhe pastaj tek vazhdoja. Fillova tri herë me dramatizimin për Berlin, herën e fundit me një daktilografist dhe me orar. Këtë herë i diktoja një dramatizim të përkryer, isha e sigurt për këtë, por në fakt ishte më i keqi nga të gjithë: me frymë pretencioziteti dhe vetëkënaqësie.

Tri herë u përpoqa. Filloja nga *Sëmundja vdekjeprurëse* dhe kthehesha tek ajo. Nuk e kuptoja këtë gjatë procesit të punës. Përsëri isha atje, gjithmonë në të njëjtin vend në libër, e shtyrë drejt tij, e çorientuar. Nuk mund t'i besoja më vetes, isha e humbur. Aq më tepër e kuptova kur ishte koha për rishkrimin përfundimtar. Nuk mund të bëja gjë tjetër veçse të përballesha me këtë zgjidhje të rreme: teatrin. Fola përsëri me Yann-in. I thashë se nuk mundem më. Se mjaft kisha humbur kohë, dhe se po heq dorë nga dramatizimi i këtij teksti. I thashë se kisha zbuluar për herë të fundit se *Sëmundja Vdekjeprurëse* ekzistonte në një dykuptimshmëri të dukshme, saqë duheshin përdorur mjete të tjera për ta trajtuar siç duhet, dhe se nuk mund të bëja asgjë për këtë. Akoma nuk e di se çfarë vështirësie kam përjetuar me këtë tekst. Dhe pastaj ndodhi ajo në Quilleboeuf, nuk e mendoja në atë kohë. Ishte pak pas rifillimit të një libri që do të quhej *L'Homme menti*, të cilin gjithashtu e kisha braktisur. Dhe erdhi një ditë kur u bë nxehtë, edhe mbrëmjeve, netëve. Verë e vërterë qershori. Fillova të shkruaj për verën, për mbrëmjet e ngrohta. Nuk e dija pse, por vazhdoja kështu.

Është vera e vitit 1986. Shkruaj historinë. Gjithë verën, çdo ditë, herë në mbrëmje, herë natën. Është pikërisht koha kur Yann-i kalon në një periudhë bërtitjesh, cirrjesh. Ai merret me shtypjen e tekstit me makinën e shkrimit, dy orë në ditë. Në libër unë jam tetëmbëdhjetë vjeçe, dashuroj një burrë që urren epshin tim, trupin tim. Yann-i shkruan sipas diktimit tim. Ndërsa shkruan, nuk bërtet. Kjo ndodh më pas. Më bërtet, është një burrë që do diçka, por nuk e di çfarë. Dëshiron diçka por nuk e di se çfarë. Kështu që bërtet, për të thënë se nuk e di se çfarë do.

Bërtet edhe për ta kuptuar, që në rrjedhën e fjalëve të tij nga vetja e tij do të vijë një mesazh për atë çfarë dëshiron. Ai



Marguerite Duras

LAVIRJA NË BREGDETIN E NORMANDISË

Tregim

Përktheu: Qerim RAQI

nuk arrin të ndajë individualen e asaj që dëshiron këtë verë nga tërësia e asaj që ka dashur gjithmonë. Unë pothuajse nuk e shoh kurrë, këtë burrë, Yann-in. Nuk është pothuajse kurrë atje, në apartamentin ku jetojmë bashkë, buzë detit. Shëtit. Bën shumë gjiro të ndryshme gjatë ditës. Shkon kodër më kodër. Shkon nëpër hotele të mëdha, duke kërkuar burra të bukur. Edhe nëpër fushat e golfit kërkon. Gjen ca banakierë të bukur. Qëndron ulur në hollin e Hôtel du Golf duke pritur, shikon. Mbrëmjeve thotë: “Ishte bukur të pushoja në Hôtel du Golf, isha i qetë”. Ndonjëherë e zë gjumi në divanet e Hôtel du Golf, por është i veshur mirë, është shumë elegant, Yann-i, me të bardha, kështu që e lënë të flejë. Ai mban gjithmonë një çantë të madhe të vjetër prej pëlhere blu, të cilën e kam qepur unë nëse eventualisht do t’i duhej për të blerë diçka. Në të i lë paratë e tij. Natën shkon te Melody. Pasditeve shkon edhe në Normandi. Në Trouville shkon në Bellevue. Kur vjen në shtëpi, bërtet, më bërtet, kurse unë vazhdoj të shkruaj. Çfarëdo që të them: “Mirëmbërëma”, “Si je?”, “Ke ngrënë darkë?”, “A je lodhur?”, ai bërtet.

Çdo natë, për një muaj, ai dëshiron ta ketë makinën dhe të shkojë në Caen për të takuar miqtë. Unë nuk e lë të marrë makinën sepse kam frikë. Atëherë ai porositi një taksì, bëhet miku i taksistëve, klienti i tyre i preferuar. Ndërsa bërtet, unë vazhdoj të shkruaj. Në fillim ishte e vështirë. Mendoja se ishte e padrejtë që bërtiste. Se nuk ishte në rregull. Dhe ndërsa shkruaja dhe e shihja që po vinte, e dija se do të fillonte të bërtiste, nuk mund të shkruaja më, ose më saktë shkrimi im ndalonte tërësisht. Nuk kishte


më asgjë për të shkruar, dhe shkruaja fjali, fjalë, skica, për ta shtyrë atë të mendonte se nuk e dëgjoja bërtitjen e tij. Kam kaluar javë të tëra duke shkruar në mënyra të ndryshme. Tani besoj se ato shkrime që më dukeshin më jokohorentet, në fakt, ishin më vendimtare për librin e ardhshëm. Por atë botë nuk e kisha idenë për këtë. Nuk ia thoja se bërtitja e tij dhe trajtimi i padrejtë ndaj meje më pengonin të shkruaja. Së shpejti nuk mund të shkruaja më as kur largohej. Prisja britmat e tij, ulërimat e tij, por vazhdoja ta mbushja letrën me fjali të huaja për librin që ishte aty, në proces shkrimi, në një fushë të huaj për të: fiksionin. Në fund u krijua një rregull për të cilin nuk isha më përgjegjëse, unë që i shkruaja fjalët në letër, por për të cilin Yann-i ishte përgjegjës vetë, për çdo shkrim, pa pasur nevojë ta bëjë fare, pa asnjë mendim tjetër përveç atij të shfarosjes totale të gjithçkaje që mund të merret si një inkurajim për të jetuar. Ai dinte aq pak për veten dhe zemërimin e tij si një kafshë, asgjë, as nuk e dinte se po bërtiste. Kështu, një muaj para datës së premtuar të dorëzimit të dorëshkrimit, përfundimisht fillova ta shkruaj librin, domethënë ta gjeja këtë njeri, Yann-in, por diku tjetër nga ku ishte, duke e kërkuar në gjëra të huaja për të dhe librin, për shembull në peizazhet e grykës së Senës. Madje shumë atje. Por edhe në të, në buzëqeshjen e tij, buzëqeshjen e Yann-it, në ecjen e tij, duart e tij, duart e Yann-it. E ndava fare nga fjalët e tij, ai sikur i kishte marrë pa e ditur dhe ishte sëmure prej tyre. Dhe mu në këtë mënyrë e kuptova se ai kishte të drejtë. Se kishte të drejtë që donte diçka në atë masë, çfarëdo qoftë kjo. Sado e tmerrshme të ishte. Ndonjëherë

mendoja se kisha mbaruar, se do të vdisja.

Duke qenë se jam ende e brishtë nga një trajtim që kam bërë katër vite më parë, kam një prirje të besoj se vdekja është këtu, afër jetës sime. Ai donte gjithçka në të njëjtën kohë, donte të shkatërronte librin dhe kishte frikë nga libri. Për disa javë kishte shkruar dy orë në ditë për mua. Skica, episode të ndryshme të veprës. Ai e dinte që libri ekzistonte tashmë. Më tha: “Pse shkruan gjithë ditën ta marrë dreqi, je e braktisur nga të gjithë, je e çmendur, je lavirja e bregdetit të normandisë, një idiote, je për turp”. Më pas ndodhte të qeshnim. Ai kishte frikë mnase se do të vdisja para se të mbaronte libri, ose se do të hiqja dorë nga libri, edhe një herë.

Nuk mendoja më për Quilleboeuf, por sesi më erdhi të shkoja atje. Shkova me miqtë, por nuk e dija pse isha kaq e lidhur me këtë vend të çuditshëm, mendoja se ishte për shkak të lumit të madh që rridhte pranë sheshit ku ishte kafeneja. Mendoja se ishte për shkak të qiellit të verdhë fotogjenik që i ngjante atij në Siam, edhe pse Siami nuk ekzistonte më. Ndonjëherë ai vinte në shtëpi në pesë të mëngjesit, i lumtur. Unë nuk e pyesja më asgjë, nuk flisja më me të, nuk e ngjatetoja. Atëherë ai ishte më i fortë, ishte i tmerrshëm dhe ndonjëherë frikësohesha dhe mendoja se kishte gjithnjë e më shumë të drejtë, por nuk mund ta ndalja më librin, ashtu siç nuk mund ta ndalte as ai dhunën. Nuk e di saktësisht për çfarë bërtiste Yann-i. Unë mendoj se ishte për vetë librin, e drejtë apo e padrejtë, nën çdo përkufizim, pretekst, justifikim, etj. Ishte: për ta bërë këtë, një libër, me çdo kusht. Ishte brenda arsyeses së të arsyeshmës ose e paarsyeshmja brenda të njëjtës arsye. Ishte si një qëllim: ta vriste këtë. E dija. Dija gjithnjë e më shumë për Yann-in. Në fund u shndrrëua në një garë. Të isha më e shpejtë se ai, që libri të përfundonte, përpara se ta pengonte tërësisht. Jetova me këtë gjithë verën. Mbase edhe shpresoja në këtë. U ankohesha njerëzve, por jo për gjënë më të rëndësishme, jo për këtë që po them këtu. Sepse mendoja se nuk mund të më kuptonin. Sepse nuk kishte asgjë në jetën time aq të paligjshme sa historia jonë, e Yann-it dhe e imja. Ishte një histori që nuk kishte vlerë askund tjetër veçse aty, ku ishim ne. Është e pamundur të flasësh për atë se çfarë bënte Yann-i me kohën e tij, me verën e tij, e pamundur. Ai ishte krejtësisht i palexueshëm, i paparashikueshëm. Mund të thuash se nuk kishte asnjë kufi. Shkonte në të gjitha drejtimet, në të gjitha ato hotele, në kërkim të burrave të bukur, banakierëve, banakierëve të gjatë të lindur në vende të largëta, në Argjentinë apo në Kubë. Ai shkonte në të gjitha drejtimet, Yann-i. Të gjitha drejtimet bashkoheshin në të në fund të ditëve, netëve. Bashkoheshin në shpresën e çmendur të një skandali të mundshëm, një universaliteti të padëgjuar për të cilin jeta ime do të kishte qenë në shënjestër. Më në fund, fillonte të bëhej i lexueshëm. Ne kishim përfunduar diku në një vend ku jeta nuk ishte plotësisht e munguar. Merrnim sinjale prej saj, ndonjëherë. Kalonte, jeta, buzë detit. Nganjëherë kalonte nëpër qytet, nëpër autobusët e piketave të policisë së moralit. Edhe vrumbullitja e dallgëve ishte aty, dhe Quilleboeuf-i, që dihej se ishte larg, kudo në të njëjtën kohë, mu si Yann-i. Kur shkrova *Sëmundjen vdekjeprurëse*, nuk mund të shkruaja për Yann-in. Këtë e di së paku. Këtu lexuesit do të thonë: “Çfarë ka ndodhur me të? Asgjë nuk ka ndodhur, sepse asgjë nuk ndodh”. Ndërsa ajo që ndodhi është ajo që ndodhi. Dhe kur nuk ndodh më asgjë, ngjarja mbetet vërtet përtej mundësive të shkrimit dhe leximit.

Karikaturë nga Arben Mexsi



S'KA

poezi nga Faslli Haliti

S'ka më të thellë se cektësia
S'ka më të cekët
Se thellësia
S'ka më të lartë se sipërfaqja
S'ka më të ulët se lartësia
S'ka më të gjerë
Se ngushtësia
S'ka më të ngushtë
Se gjerësia
S'ka më të shkurtër se gjatësia
S'ka më të gjatë
Se shkurtësia
S'ka më fëmijë se plaku

S'ka më plak
Se fëmija
S'ka pasuri më të varfër se varfëria
S'ka varfëri më të pasur
Se pasuria
S'ka pandershmëri më të ndershme se
pandershmëria
S'ka ndershmëri më të pandershme
Se ndershmëria
S'ka besnikëri
Më të pabesë
Se pabesia
S'ka pabesi më të besës se besnikëria...